The United States is a good place to study this topic, because in the United States we know that conflict and division can be overcome. Over 150 years ago, my country almost broke apart in a brutal civil war. However, thanks largely to the courageous and inclusive leadership of President Abraham Lincoln, the United States was able to knit itself back together

and has remained both united and diverse. So, we were able to overcome conflict.

Some people would like to pretend conflict doesn't exist. When studying history, you cannot ignore conflict. However, it is vital that we prevent history from becoming a source of bitterness and division. Rather, we should work to see how we can learn from the conflict of the past. With this knowledge, we can respond by working together to create a more peaceful, harmonious future.

But this is not easy; it is hard work. Everyone involved from all ethnic and religious groups, from all political parties, must work to reach this goal, and must make it a priority. Unfortunately, in Macedonia, all too often I see leaders who seek short-term gain for themselves and their parties in taking advantage of conflict, rather than working to settle conflict. That is a recipe for failure as a country. I hope conferences like this can demonstrate that there is a better way, that leads to a peaceful future for Macedonia, through commitment by all groups and parties to the future of Macedonia as a multi-ethnic democracy where all groups respect each other and work together for a stronger Macedonia.

Again, I would like to welcome you to this event and thank the organizers for their focus on making history accessible to all, so that we can all learn from the past and conflicts of the past, in order to create a better future.

Thank you.

KRISTINE ALTAUSER

Ambasadore e Republikës Federale të Gjermanisë në Shkup

Zonja dhe zotërinj, z. ministër...

Së pari ju falënderoj shumë për ftesën. Ambasadori Pol sapo e ceku se kjo është paraqitja ime e parë publike në vendin tuaj, dhe unë e pranova këtë ftesë me kënaqësi të referoj mbi këtë temë.

Lexova njaft për Memorandumin e Juaj për bashkëpunim të nënshkruar në mars të vitit të kaluar. Folësit paraprak theksuan tanimë rëndësinë e këtij Memorandumi për bashkëpunim. Edhe unë jam kureshtarë të di më tepër për hapat e ndërmarra prej atëherë deri tani. Në një artikull gazetaresk lidhur me ceremoninë e vitit të kaluar unë lexova titullin: “Me historianët filloi urrëjtja, me historianët fillon pajtimi”, gjithashtu.

Sot, po përkujtojmë ndodhinë prej para 100 viteve. Në 28 qershor të vitit 1914, telegrafët po shpërndanin lajmin për vdekjen e dhunshme të trashëgimitarit austriak të fronit në Sarajevë. Pesë javë më pas shpërtheu Lufta e Parë Botërore. Në memorien kolektive gjermane ky eveniment shumë shpesh është i mbuluar nga Lufta e Dytë Botërore dhe krimet kundër njerëzimit që u bënë. Për shumicën e fqinjëve tonë, shtetet në të cilat ndodhën betejat e përgjakshme dhe vrasjet makabre nëpër fronte, Lufta e Parë Botërore mbetet e mishëruar në memorien e tyre. Në Francë sot edhe më tutje ajo quhet “la Grande Guerre” (Lufta e Madhe) dhe Xhorxh Kenan e shpalli atë si “seminal catastrophe” e shekullit 20-të. Në njëqind vjetorin e katastrofës, janë botuar një numër i madh i studimeve të reja të cilat po përpiqen që të bëjnë atë që nuk përfshin gjithçka si gjithëpërfshirëse. Konferenca e Juaj është pjesë e këtij cikli. Urime për ata të cilët pranuan këtë sfidë të organizimit të kësaj konference shkencore sot.

Historia e shpërthimit të luftës para njëqind viteve dhe e prishjes së baraspeshës së ndjeshme të fuqive në Evropë në verën e vitit 1914, është gjithashtu një përrallë e fuqishme për dështimin e elitave, ushtrisë, diplomacisë. Shpërthimi i luftës në vitin 1914 vendosi fundin e një fazë initiale të globalizimit. Ekonomitë dhe kulturat e Evropës ishin aq shumë të ndërlidhura që në atë kohë lufta për shumicën dukej e pamundur, dukej si joracionale dhe kundër interesave të vetë shteteve. Por, gjithsesi ajo përsëri shpërtheu.

Sot, bota jonë është më tepër se kurdoherë e ndërlidhur. Kjo ofron shumë mundësi, krijon një begati dhe ofron liri të reja. Por, gjithsesi bota jonë edhe më tutje është e ndjeshme, përplot me pika fërkuese dhe konflikte të interesave. Politikat e matura të jashtme dhe përpiluesit e diplomacisë janë më të rëndësishëm se kurdo qoftë më herët në këtë botë. Duke pasur vështirime të qarta jo vetëm për interesin vetanak, por gjithashtu edhe të fqinjëve dhe partnerëve, duke vepruar me përgjegjësi dhe duke menduar lidhur me pasojat në nivel më të lartë, mundemi të ruajmë paqen.

Kërkimi i vazhdueshëm i hapësirave të reja për kompromis është parimi thelbësor i diplomacisë. 1914–ta na mundëson një shikim të gjallë në atë se çfarë ndodh kur e injorojmë atë. A thua vallë kriza e korrikut duhej me domosdo të dërgojë deri te katastrofa atëherë?! Me siguri – jo. A thua mund të mos e marrim në konsiderim një gjë të tillë që ndodh sot?! Përgjigja varet vetëm nga ne, që ne të jemi të përgjegjshëm sot dhe të mësojmë nga leksionet e nxjerra nga historia.

Prandaj edhe një herë: Urime për konferencën, fat të mirë në bashkëpunimin e Juaj, dhe për sot shumë diskutime të frytshme. Faleminderit.

КРИСТИНЕ АЛТАУСЕР

Амбасадор на Фефедрална Република Германија во Скопје

Дами и господа, г –дин министер...

Најпрво сакам да ви се заблагодарувам многу за поканата. Амбасадорот Пол само што рече дека ова е мое прво јавно обраќање во вашата земја, и јас ја прифатив оваа покана со задоволство да реферирам на оваа тема. Прочитав многу околу меморандумот за соработка, потпишан во март минатата година. Претходните говорници ја истакнаа важноста на овој меморандум меѓу двете институции, и јас сум љубопитна да знам повеќе во врска со чекорите кои се преземени досега. Во еден напис објавен по повод церемонијата од минатата година, ја прочитав овој наслов "Со историчарите почна омразата, со историчарите ќе почнува помирувањето".

Денеска, 100 години потоа, ние се сеќаваме на настанот, кога на 28 јуни 1914 година, се шири веста за смртта на наследникот на австрискиот трон во Сараево. Пет недели подоцна, избувна Првата светска војна. Во колективната меморија на Германците, овој настан стоеше како сенка до Втората светска војна, кога пак се појавија и злосторства против човештвото. Дури и за многу од нашите соседни земји, оваа војна остана во меморијата, како на пример, во Франција е позната како "Големата војна", а Џорџ Кенон го прогласи како најголема катастрофа на 20 век.

Во 100 годишнината на тој настан, се објавени многу студии до сега. И вашата конференција е дел од тој

циккус. Честитки за сите оние кои се соочуваа со предизвикот за организирање на овој настан.

Историјата на почетокот на Првата светска војна пред 100 години, и нарушувањето на рамнотежата меѓу сојузничките сили во Европа во текот на летото 1914 година, е толку ударно, колку и расказите за падот на елитите, војската, дипломатијата. Избувнувањето на Првата светска војна, му стави крај на една иницијална фаза на глобализацијата. Стопанствата и културите на Европа во тоа време беа толку тесно поврзани, така што за повеќе од нив, војната се чинеше дека е невозможна, се чинеше како ирационална и против интересите на самите земји. Но, сепат, таа избувна.

Денеска, нашиот свет е поврзан повеќе од било кога. Ова обезбедува повеќе можности, ствара богатства и гарантира слободи.

Сепак, нашиот свет е чувствителен, полн со напнатости и конфликти на интереси. Но, имајќи јасни погледи, не само за личниот интерес, но исто така и за интересите на соседите и партнерите, однесувајќи се со одговорност и размислувајќи за последиците на повисоко ниво, можеме да ја зачуваме мирот.

Континуираното истражување на нови простори за компромис, е основното начело на дипломатијата. 1914 година, ни овозможува еден жив поглед на она што ни се случува кога го игнорираме. Дали јулската криза, неопходно требаше тогаш да не испрати до таа катастрофа!? Секако – не! Дали треба да не го земеме в предвид тоа што се ни се случува денес?!

Одговорот зависи само ид нас, ние да бидеме одговорни денска, и да ги научиме лекциите од историјата.

На крај, уште еднаш: Честитки за конференцијата, со среќа Вашата соработка, и многу плодна дискусија денеска.

Ви благодарам.

CHRISTINE ALTHAUSER

Ambassador of the Federal Republic of Germany in Skopje

First of all many thanks for the invitation. I read a lot about your memorandum of cooperation signed in march last year. The previous speakers already highlighted the importance of the memorandum. And I am curious to learn about the steps undertaken in the time in between. In a newspaper report about last year's ceremony I read the headline: The hate started with the historians, with the historians is starting reconciliation, too.

Today we remember the events 100 years ago. On 28 June 1914, telegraphs were disseminating the news of the violent death of the Austrian heir to the throne in Sarajevo. Five weeks later the First World War broke out. In the German collective memory this event is often overshadowed by the Second World War and the crime against humanity that was the Shoah.

For many of our neighbors, the countries in which the bloody battles and terrible killing in the trenches took place, the First World War remains etched in their memories. In France today it is still called "la Grande Guerre" (the Great War), and George Kennan declared it to be the "seminal catastrophe" of the 20th century.

On the centenary of the catastrophe, numerous new studies have been published which strive to render the incomprehensible comprehensible. Your conference is part of this cycle. Congratulation to all those who took the challenge of organizing this scientific conference today.

The history of the outbreak of war one hundred years ago and of the collapse of the fragile balance of power in Europe in the

summer of 1914 is as much a striking as a disturbing tale of a failure of the elites, the military, diplomacy. The outbreak of war in 1914 put an end to the initial phase of globalization. Europe's economies and cultures were so closely intertwined that at the time war seemed impossible to many, it appeared irrational and against countries' own interests. Yet it still broke out.

Today, our world is more interconnected than ever. This offers many opportunities, it creates wealth and grants new freedoms. Yet our world is also vulnerable, full of friction points and conflicts of interest. Prudent foreign policy and diplomatic craftsmanship are more important than ever in this world. Having a sober view not only of one's own interests, but also those of one's neighbors and partners, acting responsibly and thinking about consequences with a level-head are vital to safeguarding peace.

Constantly seeking new room to compromise is a fundamental political principle. 1914 provides us with vivid insight into what happens when we ignore that. Did the July crisis necessarily have to lead to catastrophe back then? Probably not. Can we rule out something similar happening today? The answer depends solely on us, on us being responsible today and on the lessons that we take from history.

Thus, once again: Congratulation for the conference, good luck for your cooperation and for today: many fruitful discussions.

Thank you.

SILKE MAIER WITT

Drejtoreshë e Forumit ZDF – Shkup

–I nderuari Ministër Ademi, e nderuara z–nja ambasadore Althausen, i nderuari z–ri ambasador Volers.

Para njëqind viteve filloi Lufta e Parë Botërore dhe 25 vjet më pas Lufta e Dytë Botërore. Luftërat shpërthyen në Ballkan. Në 11 shtator të vitit 2001 një luftë tjetër filloi, dhe sot përsëri po ballafaqohemi me luftë.

Secili sot po flet për sigurinë. Fjala disi është jashtë mode. Unë punoj me një organizatë e cila quhet Forumi Servisi Civil për Page, dhe nëpërmjet të eksperiencës sime personale jam dedikuar që të punoj për page. Paqja kërkon bashkëpunim, kërkon aftësinë për të punuar në mënyrë konstruktive me konfliktet, kërkon kompromis. Ne kemi nevojë të përforcojmë këto kapacitete që të zvogëlojmë dhunën dhe parandalojmë luftërat e ardhshme.

Si e ashtuquajtur punëtore e pages, e di se duhet të vlerësojmë hapat e vegjël, sinjalet e vegjël pozitiv. Fakti që z–ri Dragi Georgiev dhe z–ri Skender Asani, që të dy drejtorë të institucioneve që merren me histori, janë ulur njëri pranë tjetrit, është një prej këtyre hapave të vegjël. Para dy viteve ata vendosën të bashkëpunojnë, dhe të gjithë ju që jetoni në Maqedoni e dini se çfarë domethënë kjo!! Dhe ky bashkëpunim po rritet. Dy institutet filluan të bashkëpunojnë me Qendrën Përkujtimore të Hebrenjve të Maqedonisë dhe me Komuniteti Hebrenj në Shkup, një hap tjetër i vogël i cili mund të ketë ndikim në të ardhmen paqësore.

Do të dëshiroja që të gjithë profesorët dhe studentët e historisë të grumbulluar këtu të kenë diskutime të frytshme dhe kundërshtuese, dhe shpresoj se rezultatet e tyre do të shtojnë diturinë tonë se si të parandalojmë luftën. Ju faleminderit!

СИЛКЕ МАИЕР ВИТ

Директор на Форум ЗФД – Скопје

–Почитуван министер Адеми, почитуван амбасадор г–ѓа Althausер, почитуван амбасадор г–дин Волерс.

Пред сто години почна Првата светска војна, и 25 години подоцна Втората светска војна. Војните избувнаа во Балкан. На 11 септември 2001 почна една друга војна, и денска повторно се предизвикуваме со војна.

Секој денеска зборува за безбедноста. Денеска зборот е некако надвор од мода. Јас работам во една организација која се нарекува Форум цивилен сервис за мир, и преку моето лично искуство, сум посветена да работам за мир. Мирот бара соработка, бара способност да се работи на конструктивен начин со конфликти, бара компромис. Ние имаме потреба да ги зајакнеме овие капацитети за да ги намалиме насилствата и да ги спречиме војните во иднина.

Како таканаречена работничка на мирот, знам дека треба да се ценат малите чекори, малите позитивни сигнали. Фактот што г–дин Драги Георгиев и г–дин Скендер Асани, двајцата директори на институции кои што се занимаваат со историја, седат еден покрај друг, е еден од овие мали чекори. Пред две години тие решија да соработуваат, и сите вие кои живеете во Македонија, знаете што значи ова!!

И, оваа соработка расте. Двете институции сега почнаа да соработуваат со Мермоијалниот центар на евреите во Македонија и со Еврејската заедница во Скопје, еден друг мал чекор, кој може да има големо влијание за мирот во иднина.

Би сакал сите професори и студенти на историјата тука да имаат плодни и разнолитни дискусии, и се надевам, нивните резултати ќе ги збогатат нашите знаења како да ги спречиме војните.

Ви благодарам.

SILKE MAIER WITT

Director of Forum ZDF – Skopje

–Dear Minister Ademi, dear Mrs. Ambassador Althausen, dear Mr. Ambassador Wohlers

One hundred years ago the first WW started, only 25 years later the 2. WW started. Wars erupted on the Balkans. On 11th of September 2001 yet another war started and today we are faced again with war.

Everybody is talking about security nowadays. The term Peace is somehow outdated. I am working with an organization that is called Forum Civil Peace Service and through my own personal experience I dedicated myself to work for peace. Peace needs cooperation, it needs the ability to work constructively with conflicts, it needs compromise. We need to strengthen these capacities to make violence less likely and prevent new wars.

As a so-called peace worker, I know that we have to value the small steps, the small positive signals. The fact that Mr. Dragi Georgiev and Mr. Skender Asani, both directors of Institutions dealing with history, are sitting next to each other is one of these small steps. Two years ago they decided to cooperate, and all of you living in Macedonia know, what that means!!

And this cooperation is growing. The two institutions started now cooperation with the Memorial Center for the Jews of Macedonia and the Jewish Community of Skopje another small step that might have some impact on a peaceful future.

I wish all the history professors and students assembled here fruitful and controversial discussions, and I hope their findings will add to our knowledge how to prevent war.

Thank you.

KUMTESAT SHKENCORE
НАУЧНИ ТРУДОВИ
SCIENTIFIC PAPERS

FEJZULLA SHABANI¹

Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe UEJL

DIPLOMACIA E FUQIVE TË MËDHA PARA DHE GJATË LUFTËS, NDAJ SHTETEVE BALLKANIKE

Abstrakt

Në këtë temë do të trajtoj rrethanat diplomatike që kanë ekzistuar në Ballkan në prag të fillimit të Luftës së Parë Botërore. Duke u mbështetur në dokumentet e pabotuara ato diplomatike si dhe në literaturën e studiuesve të huaj në lidhje me këtë problematikë, do të tentoj që në këtë punim të nxjerr në sipërfaqe interesat e dy blloqeve, të Fuqive të Mëdha për Ballkanin, si dhe qëndrimin e shteteve ballkanike në lidhje me këtë luftë.

Një theks të veçantë në këtë studim do të kenë rrethanat diplomatike në prag të Luftës së Parë Botërore, roli i Ballkanit në rrafshin gjeopolitik, si dhe një krahasim të një periudhe njëqindvjeçare mbi interesimin e diplomacisë së huaj për problemet në Ballkan.

Gjithashtu në këtë punim do të tentoj të trajtoj edhe çështjen shqiptare si pjesë përbërëse e shteteve ballkanike, duke u përqendruar kryesisht në atë se cili ka qenë qëndrimi i

¹ Historiani Prof.Dr.Fejzulla Shabani, ndërroi jetë më 21.08.2014. Ai paraprakisht kishte shprehur gatishmëri për të marrë pjesë në këtë konferencë shkencore, për çka dhe me kohë e kishte dërguar abstraktin e punimit. Në nderim të kontributit të tij të dhënë në fushën e historisë, sidomos asaj shqiptare, drejtuesit e konferencës, i filluan punimet duke e lexuar këtë abstrakt punimi.

shqiptarëve për këtë luftë, raporti me shtetet ballkanike, gjithmonë duke u mbështetur në rrafshin diplomatik.

Në këtë punim do të elaboroj interesin e Fuqive të Mëdha për Ballkanin, të cilat tentuan që sa më tepër shtete t'i bënin aleat të tyre, por në të njëjtën kohë do të elaboroj edhe qëndrimin e shteteve ballkanike ndaj Luftës së Parë Botërore, duke pasur parasysh faktin se kjo luftë fillon për Ballkanin.

*GJET NDOJ**Arkivi Qendror i Shtetit Shqiptar – Tiranë*

SHQIPTARËT GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE, SIPAS DOKUMENTEVE TË ARKIVAVE TË SHQIPËRISË

Shqiptarët ishin kombi i fundit në Ballkan, që u çlirua nga pushtimi 550 vjeçar i Perandorisë Osmane. Kjo pavarësi u formalizua më 28 Nëntor të vitit 1912, kur krerët e gjithë trevave shqiptare të Ballkanit Perëndimor, të mbledhur në Vlorë, vendosën dhe nënshkruan “Deklaratën e Pavarësisë së Shqipërisë”.

Kufijtë e shtetit të ri shqiptar u përcaktuan nga Fuqitë e Mëdha, në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913. Po këto fuqi, miratuan projektin Austro–hungarez për vendosjen në krye të Shqipërisë një princ gjerman nga familja e Hohenzelerëve, Wilhelm Von Wied, por dhe mbikëqyrjen ndërkombëtare të saj, nëpërmjet Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK).

Pamundësia për të ushtruar sovranitetin e saj, në tërë hapësirën e territorit të banuar nga shqiptarët, si Qeveria e Ismail Qemalit, por dhe Qeveria e Wiedit, vinte në radhë të parë nga trysnia dhe veprimet pushtuese të shteteve shoviniste ballkanike, si Serbia, Mali i Zi, Greqia, etj.

Nga ana tjetër austro–hungarezët, si faktori përcaktues i jashtëm në Pavarësinë e Shqipërisë, vazhdonin të kishin interesa të drejtpërdrejta në ekzistencën e Shtetit të Ri Shqiptar, por dhe zgjerimit të sovranitetit të tij në kufijtë maksimal të mundshëm.

Në këtë situatë e gjeti Shqipërinë shpërthimi i Luftës së Parë Botërore në 1914.

Menjëherë pas shpërthimit të saj, por dhe për shkak të kryengritjes antikombëtare e antieuropiane të Shqipërisë Mesme, të komanduar nga Haxhi Qamili, u largua nga Shqipëria Princi Wied dhe Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK).

Kështu shqiptarët mbetën pa qeveri e pa udhëheqje.

Në këto kondita, Shqipëria nuk u bë anëtare e asnjë blloku ndërluftues, ndërsa territori i banuar prej shqiptarëve u bë shesh lufte për ushtritë e tjera. Rastet e implikimeve të shqiptarëve me influencë, në njërin fuqi, apo në një tjetër nuk mund të përcaktonte shqiptarët si palë në njërin apo tjetrin bllok të Luftës së Parë Botërore. Rastet më tipike lidhen me aktivitetin e Esat Pashë Toptanit në krah dhe në dobi të Serbisë, madje kjo e fundit i paguante mirë Esatin dhe mercenarët e tij. Ndërsa, Hasan Prishtina, Bajram Curri e Azem Galica, në vijimësi të veprimtarisë tyre nacionaliste, luftonin kundër ushtrisë pushtuese serbe.

Për të gjithë këtë pjesë të parë, kemi qindra dokumente në Arkivin Qendror të Shtetit (AQSH) në Tiranë.

Materialet arkivore ilustrojnë dhe situatën e intervenimit të ushtrive serbe, malazeze, greke e italiane. Intervenimi i këtyre ushtrive të huaja ndodhi që në fillim të vitit 1915 e në vazhdim. Ndërsa, qëndrimi i tyre, për shkak të rivalitetit me ushtritë e tjera, që i shkurtër, me përjashtim të ushtrisë pushtuese italiane, e cila qëndroi deri në fund të Luftës së Parë Botërore, në nëntor 1918.

Me pushtimin e Ballkanit nga ushtritë e Bllokut Qendror, pjesa më e madhe e Shqipërisë u pushtua nga ushtria austro-hungareze.

Ushtria franceze e nisur nga baza e saj e Selanikut pushtoi pjesën Juglindore të Shqipërisë, dhe në këtë kohë kemi dhe krijimin e “Krahinës Autonome të Korçës”.

Nga ana tjetër, Bullgaria pushtoi Shkupin, dhe pothuajse të gjithë Maqedoninë, Kosovën Veriore e Lindore deri në Sкен-deraj.

Edhe për këtë situatë ne posedojmë qindra dokumente arki-vore. Po kështu, edhe për veprimet pushtuese dhe për regji-min e vendosur nga ushtria italiane pas pushtimit të Shqipërisë jugperëndimore.

Në krahinat e pushtuara nga ushtritë ndërluftuese, u krijuan administrata shqiptare nën vartësi të këtyre ushtrive.

Kjo gjendje, sikurse e kemi të dëshmuar edhe në arkivat tona, vazhdon të jetë e tillë deri në përfundimin e kësaj lufte.

Përfundimi i kësaj lufte qe shkatërrimi i ekonomisë së vendit, përveç disa rasteve sporadike kur austro–hungarezët, bënë disa investime, si për shembull në rrugë, pastaj për herë të parë kemi dhe ndërtimin e një dekovili, me qëllim hapjen dhe shfrytëzimin e disa vendburimeve natyrore në vend, etj.

Nga ana tjetër me humbjen e Bllokut Qendror, humbet luf-tën edhe Austro–Hungaria, madje me mbarimin e kësaj lufte, pushon së qeni si perandori.

Kjo situatë gjeopolitike e re, kur shqiptarët nuk e kanë më mbështetësen kryesore të Pavarësisë (Austro–Hungarinë), pasi ajo është humbëse e luftës, është në disfavor të të ardhmes politike e shtetërore të tyre. Në këto kushte të reja avokati i tyre (Austro–Hungaria) e humb influencën në rajon, ndërsa shqiptarët gjenden në pikën më kritike të pavarësisë dhe të perspektivës së tyre shtetformuese.

Dokumentet e kësaj periudhe (1914–1918), janë me qindra–mijëra në arkivat shqiptare.

Këto dokumente janë kryesisht: protokolle, urdhra të drejtuesve ushtarakë, relacione të shtatmadhërive Austro-Hungareze dhe Franceze, për gjendjen politike dhe ushtarake në Shqipëri, vendime të drejtuesve ushtarakë për çështje ushtarake (rekrutime, mobilizime, etj), ekonomike (rekuizime pune të detyruar etj) , arsimore (hapje shkollash), kulturore, etj.

Në tërësinë e këtyre dokumenteve ka dhe dokumente që bëjnë fjalë për marrëveshje midis drejtuesve shqiptarë dhe komandantëve ushtarakë, shënime historike të nxjerrë nga libra, revista, gazeta dhe dokumente që flasin mbi gjendjen administrative, shoqërore dhe ushtarake në hapësirën shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore.

Përveç dokumenteve të shkruara, në Fototekën që ndodhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave Shqiptare, keni mbi 250 fotografi. Në këto foto kryesisht tregohen ushtarë gjatë qëndrimit të tyre në kampet ushtarake, apo të fotografuar me persona të ndryshëm të popullsisë lokale.

Ka gjithashtu fotografi të bëra nga ushtarakë me emër, siç është rasti i Mjakic Alois, një oficer i ushtrisë austro-hungareze, por dhe dhjetëra të tjerë. Gjithashtu ky i fundit ka bërë shumë foto ku paraqitet jeta e përditshme e popullsisë shqiptare gjatë Luftës së parë, veçanërisht në zonat e pushtimit austro-hungarez.

Si përfundim mund të themi se Lufta e Parë Botërore ishte një fatkeqësi e madhe për Evropën dhe për mbarë njerëzimin, pasi u vranë miliona njerëz, u shkatërrua ekonomia, shtëpi e vepra industriale pa fund. Ndërsa, për shqiptarët situata rëndojë më tepër, pasi përveç këtyre pasojave shkatërrimtare që shkaktoi kjo luftë, solli dhe një situatë gjeopolitike ku ne shqiptarët dhe vendi ynë disfavorizoheshim.

Kjo situatë gjeopolitike e re, kur shqiptarët nuk e kanë më mbështetësen kryesore të Pavarësisë (Austro-Hungarinë), pasi ajo është humbëse e Luftës, dhe nga ana tjetër shtetet shoviniste sllavo-greke inkurajohen, pas kësaj lufte, është në disfavor të së ardhmes kombëtare, politike e shtetërore të tyre.

Në kto kushte të reja pasi Austro-hungaria e humb influencën e tij në rajon, shqiptarët gjenden në pikën më kritike të pavarësisë dhe të perspektivës kombëtare dhe shtetformuese të tyre.

Në konferencat dhe traktatet ndërkombëtare që shënonin dhe fundin e Luftës së Parë Botërore, çështja e ekzistencës së kombit dhe të shtetit shqiptar që në rrezik shumë serioz.

Shqiptarëve pas kësaj lufte, ju desh të mbronin me përpjekjet dhe me gjakun e tyre trojet e tyre, sikurse ishte rasti i qendrës kundër pushtuesve malazezë në Shkodër, lufta për çlirimin nga pushtuesit italianë në Vlorë dhe zonat rreth saj, lufta e shqiptarëve për mbrojtjen e Dibrës dhe krahinave rreth saj kundër pushtuesve serbë, etj.

QERIM LITA

Arkivi Shtetëror i Maqedonisë – Shkup

SHQIPTARËT NË PRAG TË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Me vendimet e padrejta nga ana e Fuqive të Mëdha në Konferencën e Paqes në Londër, si dhe Marrëveshjen e Bukureshtit, Mbretëria e Serbisë, arriti ta dyfishoj territorin e sajë. Në mbështetje të burimeve të kohës, qartë shihet se shumica e popullsisë në këto territore ishte shqiptare, ndërsa popullsia serbe përbëhej nga një pakicë e parëndësishme. Në një shkrim me titull “Tre ditë në Shkup”, botuar më 8 shkurt 1913 në gazetën e atëhershme opozitare serbe *“Radničke Novine”*, veç tjerash, përshkruhet përbërja etnike në qytetin e Shkupit, ku në të shprehimisht thuhej: “Në Shkup, për shembull, ka rreth 58.000 banorë. Nga ky numër vetëm 3.000 janë serbë, shumica e tyre kolonistë. Mirëpo, në anën tjetër ka mbi 30.000 shqiptarë e turq” Mirëpo, sipas gazetës në fjalë, Shkupi shumë më tepër banorë, përkatësisht rreth 80.000 banorë, sepse siç thuhej: “popullsia myslimane e këtij qyteti nuk i regjistrojnë fëmijët dhe gjininë femërore”².

Përbërja etnike, nuk mund të fshihej as nga administrata e atëhershme ushtarak–policore serbe, e cila u vendos menjëherë pas pushtimit të këtyre viseve. Në raportet e tyre, shihet qartë se në qarkun e Tetovës³, Kumanovës, Kërçovës, Ohrit, Stru-

² ДАРМ.1.766.27.46/262-278, „Радничке новине“, nr. 12, 8 shkurt 1913, XIII, ТРИ ДАНА У СКОПЛУ.

³ Sipas regjistrimit të kryer në muajin shkurt 1913 nga ana e autoritete ushtarake e policore serbe, Tetova me rrethinë numëronte gjithsej 53.720

gës, Dibrës, pastaj mbarë territori i sotëm i Kosovës, Sanxhaku etj, shqiptarët përbënin numrin më të madh të popullsisë, të cilët asnjëherë nuk do të pajtohen të ngelin nën robërinë serbe. Kryeshefi i Qarkut të Kumanovës⁴, Ranko Trifunoviq, në raportin që më 1 gusht 1913 e dërgon deri te Komanda Supreme të Ushtrisë Serbe, veç tjerash vë në pah se, në këtë qark ka rreth 45.000 shqiptarë. Sipas tij, *“Shqiptarët shtrihe-shin në pjesën lindore të Karadakut dhe pjesën e Ana Moravës”,* duke i përfshi edhe vendbanimet e Luginës së Kumanovës e të Preshevës, deri në linjën *“Kumanovë – Bujanoc”,* madje edhe *“në vetë qytetin e Kumanovës. Presheva është qendra e tyre.”*⁵

Në raportin që kryeshefi i qarkut të Ohrit, Qirkoviq, në vitin 1914, e dërgoi deri te ministri për punë të brendshme, Stojan Protiq, veç tjerash ofrohen të dhënat e banorëve të këtij qarku sipas përkatësisë nacionale, ku thuhej: *“Qyteti i Ohrit ka 10.051; Struga 3.964 dhe Dibra 4.198 banorë. Tërë qarku ka 77.152 banorë me rreth 140 fshatra dhe 29 komuna. Në qark ka krishterë meshkuj 25.235, ndërsa femra 25.147, gjithsej 50.382, ndërsa myslimanë meshkuj: 13.742 ndërsa femra 13.028, gjithsej 26.770”.* Në vazhdim të raportit vihej në dukje se regjistrimi ishte realizuar pas Kryengritjes së Dibrës, prandaj në të nuk ishin llogaritur siç thuhej *“ata mysliman”* të cilët nga ai territor ishin arratisur në Shqipëri, që sipas

banorë, prej tyre 38.116 shqiptarë, 14.537 serb, 902 turq dhe 332 rom, Институт за Национална Историја (më tej ИНИ), Српски извори за историјата на македонскиот народ 1912-1914, избор, редакција и коментар: Д-Р Глигор Тодоровски, Скопје 1979 година, dok. Nr. 25, fq. 107-127..

⁴ Qarku i Kumanovës në atë kohë shtrihej në: Kumanovë, Sveti Nikollë, Kriva Pallankë, Kratovë, Preshevë dhe Bujanoc.

⁵ ИНИ, по аты, dok. nr. 39, fq. 163-210.

Qirkoviqit, numri i tyre arrinte deri më 20.000 *“ku vetëm nga qyteti i Dibrës kishin ikur rreth 8–9000 vetë.”* Më tej në raport thuhej se ka fshatra të *“tëra myslimane nga rrethi i Dibrës në të cilat nuk ishte kthyer asnjë i arratisur”*. Në këtë statistikë ishin përfshirë krishterët të cilët ishin arratisur nga territori i Shqipërisë, e ata gjenden në fshatrat: Krivcë, Konjare dhe Bumovë. *“Në mënyrë absolute asnjë krishterë nuk është arratisur nga territori ynë në Shqipëri, përveç tre regrutëve dhe pesë ish mësues të ekzarkisë të cilët kanë marrë pjesë në kohën e trazirave të shqiptarëve në Dibër, me çka duhet të demantohen gënjeshtret e agjencive telegrafike bullgare, që këtë e bëjnë shpesh herë.”*⁶, theksonte veç tjerash Qirkoviqi, e që sipas të dhënave që i ofron ai, del se pas Kryengritjes së Shtatorit, mase gjysma e popullsisë shqiptare nga qarku i Ohrit, veçmas kjo në Dibër me rrethinë, ishin detyruar ti lëshojnë vatrat e tyre për tu vendosur brenda territorit të Shtetit Shqiptar.

Valën e shpërnguljes masive të popullsisë shqiptare nga Dibra e madhe me rrethinë, Ismail Strazimiri në kujtimet e tij e përshkruan në këtë mënyrë: *“Gati të gjithë banorët e qytetit, sikurse të krahinave që prfshin Dibrën, qenë arratisë e emigrue. As një i njëzeta e qytetarëve s’kishte mbetë në Dibër dhe këta përbajshin një turmë pleqsh, të shumtët të gjymtuem e të sëmurë...”*⁷ Se shumica dërmuese e popullsisë në rrethin e Dibrës ishin shqiptar e pranon edhe kryeshefi i këtij rrethi Spiro Popviq, i cili 2 prill 1913 i raportonte Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë serbe për gjendjen e përgjithshme në këtë rreth. Në raport ofroheshin të dhënat statistikore për numrin e përgjithshëm të banorëve dhe sipas përkatësisë etnike:

⁶ Po aty, dok. 77, fq. 372-414.

⁷ Ismail Strazimiri, Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë – Kujtime historike, Tiranë 2010, fq.23.

1. Qyteti i Dibrës	10.200 banorë
2. Rrethi i Dibrës së Epërme	31.805 “
3. Rrethi i Dibrës së Poshtme	19.471 ⁸ “
4. Rrethi i Rekës	20.995 “
Gjithsej:	82.477 banorë

Nga kjo popullsi janë:

1. Shqiptarë	42.477 banorë
2. Serb	23.108 ⁹ “
3. Turq	16.892 ¹⁰

Në favor të kësaj bën fjalë edhe dokumenti i hartuar në vitin 1920, nga Ministria e Punëve të Brendshme në Beograd, ku në të shprehimisht thuhej: *“Me ardhjen e ushtrisë tonë në vitin 1912 dhe okupimin e Kosovës dhe Metohisë, ju dha një grusht vdekjeprurës idesë së Shqipërisë së Madhe, mirëpo paria shqiptare të përkrahur, kryesisht prej Austrisë, arritën ta krijojnë një Shqipëri të vogël si Shtet të pavarur, e cila në sytë e krejt shqiptarëve luante rolin e "Piomenit". Përveç asaj se populli serbë është tepër i rrallë, ndërsa numri i madh i Shqiptarëve ngelën jashtë kufirit të Shqipërisë, kufijtë e përcaktuar politikisht ndërmjet Serbisë dhe Shqipërisë, nuk kanë pasur thuajse as çfarë rëndësie për Shqiptarët e tokave tona, të cilët dëshironin që edhe ata të jenë pjesë përbërëse e*

⁸ Pjesa më e madhe e këtij rrethi me vendimet e Konferencës së Londrës i takonin shtetit shqiptar.

⁹ Popullsi krishtere që shumica e tyre ishin shqiptar të pastër veçmas kjo në Rekën e Epërme.

¹⁰ ИНИ, по аты, док. нр. 21, фг. 83-103.

*shtetit Shqiptarë, nga e cila solli deri te revolta e Shqiptarëve menjëherë pas vendosjes së paqes me Bullgarinë*¹¹.

Për sa më sipër, shihet qartë se në përjashtim të Austro-Hungarisë, të gjitha Fuqitë tjera botërore, sidomos Rusia Cariste, Franca dhe Anglia, qëndruan fuqishëm pas politikës së atëhershme serbo-madhe. Në ekspozenë dhënë në tetor të vitit 1913 para deputetëve të Kuvendit të Serbisë, Nikolla Pashiqi, Luftën e Parë Ballkanike e konsideroi si luftë midis krishterimit evropian dhe islamizmit aziatik. Ja se si ai e përshkruante këtë: “Nga momenti kur pata nderin të flas para Jush për gjendjen politike ashtu siç ishte në atë kohë, deri më sot kanë ndodhur ngjarje shumë të rëndësishme historike. Çështja e Orientit, e cila zinte vendin kryesor në politikën e Fuqive të Mëdha evropiane, u zgjodh nga ana e shteteve krishtere të Ballkanit në dobi të popujve ballkanik. Fuqia myslimane e cila para pesë shekujsh i pushtoi shtetet krishtere në gadishull, u detyrua të tërhiqet para shteteve të reja krishtere dhe tua dorëzoi këtë regjion, që ua mori para pesë shekujsh. Si duket rrjedha historike i nxori në rend të parë po ato shtete krishtere të cilat para 500 viteve u gjuhëzuan para invazionit turk dhe kombit serb ia kthyen tokën e njëjtë që turqit e morën në Kosovë”. Ai më pas nuk harroi tu falënderohet Fuqive të Mëdha, sidomos ndaj Ruisë, pastaj siç do të shprehet “aleatit të saj Francës” dhe “Anglisë mike”, të cilët “në mënyrë të drejtë i kanë pranuar aspiratat serbe” dhe të njëjtat “i mbështetën fuqishëm”¹².

¹¹ ДАРМ.Ф.В.ИИ.М.344.К.Пов.Ц.Бр.2637: Меморандум о развоју садашње стање Албанско питање, Shkup, 16 qershor 1920.

¹² ДАРМ. 1.17.6.228/681-688, EXPOSE de Monsieur Pachiitch, President du Conseil et Ministre des Affaires Etrangères – Sur la politique extérieure de la Serbie.

Për sa më sipër, del se Konferenca e vitit 1913 në Londër, krahas Perandorisë Osmane, dënoi edhe shqiptarët vetëm e vetëm pse numri më i madh i tyre i përkisnin fesë islame, duke mos e marrë parasysh se po ato shqiptarë vite të tëra luftuan për çlirimin e tyre kombëtar pikërisht kundër asaj Perandorie. Lidhur me këtë padrejtësi që iu bë shqiptarëve nga ana e Fuqive të Mëdha, Komiteti i Kosovës së bashku me organizatën maqedonase VMRO, atë kroate e hungareze, përmes një Promemorie i drejtohen Kongresit të Tretë të Pakicave Nacionale, i cili u mbajt më 24 gusht 1927 në Gjeneve, në të cilën ndër të tjerave thuhej: “Në më shumë se pesë shekuj robëri fiktive turke, historia në faqet e saja ka shkruar një lëvizje të madhe shqiptare, e cila pati për qëllim çlirimin e Kosovës. Ajo faqe që shfrytëzuar si qendra kryesore e lëvizjes çlirimtare të kombit shqiptar nga robëria turke (1880–1912) dhe vetëm dy muaj para Luftës Ballkanike, kryengritësit shqiptar nga Kosova i dhanë një grusht vdekjeprurës pushtetit turk. Kosova që marrë nga Shqipëria nga Konferenca e Londrës në vitin 1913 në favor të Serbisë dhe Malit të Zi, vetëm për faktin se të mund ti mbyllet rruga pangjermanizmit kah Lindja e Afërt “¹³.

Duhet të vëmë në dukje faktin se, qeveria serbe edhe pse mori mase gjysmën e tokave shqiptare, ajo nuk do të kënaqet me këtë, duke pretenduar aneksimin e tokave tjera shqiptare,

¹³ДАРМ.1.766.27.125/572-587, МЕМОРАНДУМ ЗА ПОЛОЖЕНИЕТО НА ПОТИСНАТИТЕ НАРОДИ НА БАЛКАНИТЕ ПРЕДСТАВЕН НА ТРЕТИОТ КОНГРЕС НА НАЦИОНАЛНИТЕ МАЛЦИНСТВА ВО ЖЕНЕВА., Ц.К. на Внатрешната Македонска Револуционерна Организација (Обединена), Комитет за ослободување на Косово, Комитет на Албанската Организација за национално ослободување, Ц.К. на Добручанската Револуционерна Организација.

që ajo i konsideronte si “pika strategjike”¹⁴. Një pretendim i tillë doli nga vetë kryeministri i Serbisë Nikolla Pashiq, i cili në ekspozenë e sipërpërmendur, veç tjerash shprehet: “Qeveria e Mbretërisë Serbe, ka menduar të kërkoj nga Fuqitë e Mëdha të bëhet retrifikimi i kufijve, në përputhje me interesat si të njërës po ashtu edhe të palës tjetër, si dhe për qëllim që ti qetësoj Fuqitë e Mëdha, sipas së cilëve Shqipëria duhet të ekzistoj...”¹⁵.

Për këtë qëllim, Qeveria e Mbretërisë Serbe pandërprerë ankohej tek Fuqitë e Mëdha, për gjoja përgatitjen e shqiptarëve “*për sulm të sërishëm*”, të ngjashme siç ishte ai i shtatorit të vitit 1913. Mirëpo, ishte pikërisht Qeveria e Austro-Hungarisë, e cila iu kundërvu fuqishëm politikës mashtruese të Beogradit. Ministria e Punëve të Jashtme e Serbisë, më 28 tetor 1913, i shkruante një letër Legatës së vet në Londër, me këtë përmbytje: “Ministria e Punëve të Jashtme ka nderin të ju njoftoj se grofi Bertholld me një rezervë të madhe e ka pranuar njoftimin e legatës sonë për përgatitjen e sërishme të shqiptarëve për sulm. Ai nuk beson për një mundësi të tillë. Njoftimi i tillë i Legatës, në Vjenë besojnë, se ne vetëm kërkojmë shkas për futjen e sërishme në Shqipëri. Si duket në Vjenë janë të vendosur të vazhdojnë me aksionin e izoluar rreth çështjes shqiptare. Grofi Bertoholld në një bisedë ka thënë këtë: “Ne mendojmë të vazhdojmë siç e kemi filluar me çështjen shqiptare, sepse kështu është më së miri... Ndërsa as kush të mos mashtrohet, për këtë çështje askujt nuk do ti lëshojmë pe...”¹⁶

¹⁴ Halim Purellku, *Zona e pushtimit Jugosllav në Shqipëri (1918-1921)*, Botime Albanologjike, Tiranë 2012, f. 17-19.

¹⁵ ДАРМ. 1.17.6.228/681-688, EXPOSE de Monsieur Pachitch, po aty.

¹⁶ ДАРМ.1.18.5.247/467, Министарство Иностраних Дела – Политичко Одделение, Пов. Бр. 2431, Кралевском Посланству – Лондон, Београд, 28 – X – 1913 год.

Si rrjedhje e vendosmërisë austro–hungareze, qeveria serbe u detyrua të ndryshoj strategjinë e veprimit. Ajo pasi qe detyruar ti tërheq forcat e veta ushtarake jashtë kufijve të shtetit shqiptar, rekrutoi një numër të madh të agjentëve të tyre, siç ishin Arif Hiqmeti, Xhemail beu, Taf Kaziu, etj., të cilët gjatë viteve 1913–1914, vepruan brenda territorit të shtetit Shqiptar¹⁷. Këta mercenar shqiptarë, aktivitetin e tyre e shtrinë nga Dibra e deri në Elbasan, duke manipuluar me popullsinë shqiptare, se janë të deleguar nga Fuqitë e Mëdha, me qëllim të “sjelljes së një princi mysliman” në Shqipëri. Ismail Strazimiri në kujtimet e tij, duke e përshkruar veprimtarinë anti-shqiptare të Arif Hiqmetit në Dibër, veç tjerash shkruan: *“Arif Hiqmeti malësorëve dibran po fliste dhe po u thoshte: Princ Vidi asht austriak, banon në një katund të Austrisë, asht ennue në Shqipni pa pëlqimin e popullit. Po të dojë e të bashkohet populli, Europa ka vendosë me çue në Shqipni një princ, në mos osmanli, mysliman. Unë jam dërgue këtu prej Fuqive të Mëdha për të bashkëpunue me popullin që të kërkojnë të drejtën e zgjedhjes së princit. Në këtë çështje kanë gisht shumë njerëz të përmendur të Shqipnisë. Qëllimet do të arrihen vetëm kur të tregohet ekzistenca e jonë këtu...”*¹⁸

Burimet arkivore të kohës, në mënyrë të qartë dëshmojnë se vendosja e Arif Hiqmetit dhe klikës së tij në këto vise shqiptare, ishte me porosi të qeverisë së Mbretërisë së Serbisë, me qëllim të përfitimit të disa krerëve shqiptar. Qirkoviqi, në raportin e sipërpërmendur, e përshkruante veprimtarinë e këtyre mercenarëve shqiptar, veçmas të Arif Hiqmetit, ku vinte në

¹⁷ Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës (më tej ASHAK), A. Diplomati i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme – Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915.

¹⁸ I. Strazimiri, vepra e cituar, fq. 29-33.

dukje se “nga Ohri e deri në Dibër, brenda territorit shqiptar, regjioni i veprimtarisë është i Arifit”, dhe se “*punën ai e kryen përmes udhëzimeve të drejtpërdrejta nga këtu, dhe unë për këtë nuk i përzihem.*” Gjithsesi se nga ana e qeverisë shqiptare, thuhet më tej në raport “*do të ndërmerren masa shumë të fuqishme kundër tij*” sepse veprimtaria e tij i sjell dëm të madh “*qoftë te autoriteti i Princ Vidit dhe qeverisë së tij, po ashtu edhe te komiteti shqiptar–bullgar, sepse këtij të fundit ia ndërpret një kanal shumë të rëndësishëm*”¹⁹.

Në një letër, që Arif Hiqmeti ia dërgon Qirkoviqit, veç tjerash ankohet për mosdërgimin e njeteve financiare, të premtuara nga ana e Qeverisë së Mbretërisë Serbe, me qëllim të përmbushjes së misionit të tij serbomadh. Në letër ai fillimisht shkruan: “*Ju lutem, e di se keni shumë punë por çështjen shqiptare tashti ta konsideroni si shumë serioze dhe urgjente, me qëllim që sa më parë të fusim rrënjë për më vonë, e kjo mund të arrihet vetëm përmes mençurisë dhe njeteve materiale. Zoti Pashiq e dinë se nuk duhet të pret sepse ne kërkojmë atë që u morëm vesh dhe njëri tjetrit i dhamë besën, por duhet në mënyrë të rregullt ta dërgoj atë shumë minimale të njeteve, të nevojshme për punën tonë.*” Nga përmbajta e letrës, merret veshtë se Arif Hiqmeti me disa bashkëpunëtorë të tij, para se të udhëtojnë për Shqipëri, kishin pas një takimi të drejtpërdrejtë me kryeministrin serb, Nikolla Pashiq, dhe se aty ishte marrë vendimi për dërgimin e Arifit me shokët e tij në Dibër të Vogël. Ja se çfarë i shkruan në vazhdim Arif Hiqmeti, Qirkoviqit: “*Nëse zotit Pashiq i vjen rëndë ti jep ato njete minimale për një të ardhme më të mirë të Serbisë, le të na thotë neve që ishim te ai dhe shokëve tanë në Shqipë-*

¹⁹ Институт за национална историја, Српски извори за историјата на македонскиот народ 1912-1914, по ату, dok. 77, fq. 372-414.

ri që ta ndërpresim punën”.²⁰ Në vazhdim të letrës, Hiqmeti shkruan për përpjekjet e diplomacisë Austro–Hungareze, që ta përfitojnë atë, duke i ofruar 10.000 napolona ari, për siç thotë ai “*vetëm e vetëm të punoj në favor të tyre*”, dhe pasi “*në mënyrë kategorike*” e kishte refuzuar bashkëpunimin me ta, konsulli austro–hungarez, i kishte ofruar Isa Boletinit “2000 napolona ari” për ta vrarë atë²¹.

Duhet të vëmë në dukje faktin se menjëherë pas kësaj letre, aktiviteti i Arif Hiqmetit merr përmasa më të zgjeruara, ku tashti ai vendosë lidhje të ngushta edhe me Esad Pashën. Lidhur me këtë, ai në pjesën e dytë të dhjetorit 1913, i shkruante Qirkoviqit, ku veç tjerash vinte në dukje se përkundër asaj se Esad Pasha u kishte premtuar “se fshehurazi do tu ndihmonite atyre”, megjithatë nuk ishin aq të sigurt për “sinqeritetin e tij”, mirëpo siç pohon Hiqmeti, “*e tërë kjo do të zbardhet kur ti japim parat nga Serbia*”. Gjithnjë sipas tij, ekzistonte një realitet që duhej “*besuar në sinqeritetin e Esadit*”, sepse siç do të shprehet në letër: “*Ai e dinë se ne punojmë për Serbinë dhe nëse ne i marrim paratë që Esadi të punoj në favor të Austrisë dhe në dëm të Serbisë ai do ti njoftonte agjentët austriak se çfarë punon Serbia në Shqipëri dhe për këtë shtypi austriak që moti do të shkruante...*”²²

Nuk vonoi shumë, Esad Pasha, përmes veglave të tij siç ishin Halit Lleshi, Taf Kaziu, Sefedin Pustina, Ali Beu e tjerë, arriti të përfitoj një numër të madh të krerëve shqiptar në krahinën e Dibrës e të Matit²³. Këta agjentë, veç tjerash zhvilluan edhe

²⁰ ASHAK. Njësitë, Institucionet dhe organizatat ushtarake, 3.1.1. Arkivi i Ushtrisë Jugosllave 1912-1913.

²¹ Po aty.

²² ASHAK), A. Diplomati i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme – Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915.

²³ I. Strazimiri, po aty, fq. 25-27.

një fushatë në mesin e refugjatëve dibranë e strugan, të cilët pas Kryengritjes së shtatorit, ishin detyruar ti lëshojnë vatrat e tyre për tu vendosur në Tiranë e Elbasan. Në raportin që Qirkoviq e dërgon më 18 janar 1914 deri te Ministria e Punëve të Brendshme në Beograd, shkruan: *“Agjentët e Esad Pashës po i bindin refugjatët nga Dibra e Struga se Serbia do t’ia falë Dibrën dhe Strugën Shqipërisë. Refugjatët në mënyrë të hapur flasin se nëse nuk plotësohen premtimet e Esadit ata me çetat e tyre brenda dy muajve do ta sulmojnë Serbinë...”*²⁴. Qirkoviqi, më tej në raport njoftonte për marrjen e Elbasanit nga ana e forcave esadiste, dhe se në mbrojtje të qytetit *“ka qenë Xhaferr Tahiri, komandant i përgjithshëm i Ushtrisë së Ismail Qemalit”*, i cili siç pohon ai: *“para dy viteve ka organizuar kryengritje në Manastir kundër Xhonturqve”*²⁵. Më pas në raport thuhej se *“sipas burimeve të sigurt”* nga Vlora në Elbasan kishte ardhur një oficer bullgar dhe së bashku me Irfan Beun *“ka hartuar planin për sulmin e çetave të përbashkëta shqiptaro–bullgare në territorin tonë”*²⁶ dhe se *“Irfani është emëruar për shef, ndërsa oficeri është kthyer para se të vijnë njerëzit e Esadit”*²⁷.

Fushata e Arif Hiqmetit në njërën anë, si dhe ajo e Esad Pashës dhe klikës së tij, gjoja për emërimin e një princi mysliman, përkatësisht osman, morri përmasa të gjera, sidomos kjo në pjesën veriore të shtetit shqiptar. Më 18 shkurt 1914, Qirkoviq përmes një depeshe, njoftonte Ministrinë e Punëve të Brendshme në Beograd, për organizimin e shqiptarëve kundër

²⁴ ASHAK), A. Diplomati i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme – Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, Министарство Унутрашњих Дела Пов. Бр. 670, 18 јануара 1914 године, Београд.

²⁵ По ату.

²⁶ Mendohet për viset shqiptare nën pushtimin serb.

²⁷ ASHAK, по ату.

ardhjes së Princ Vedit. Në të thuhej: “*Kryeshefi i rrethit të Dibrës njofton se Mati, Luma, Shkodra, Kruja, Çermeniku, Peshkopia, Dibra, Malësia dhe Malësia e Tiranës na kanë dhënë besë dhe kanë vendosur, se pa zgjedhje popullore nuk do ta pranojnë princ Vedin. Nëse ai vjen me ushtrinë, shqiptarët do të tërhiqen nëpër male dhe do të luftojnë në mënyrë guerile me ushtrinë. Nëse Vidi këtë nuk e pranon atëherë shqiptarët do të jenë të nënçmuar*”²⁸.

Është e rëndësishme të vihet në dukje se në atë kohë në Elbasan ishin vendosur disa personalitete të shquara shqiptare si: Dervish Hima, Irfan Beu, Hasan Prishtina etj, të cilët vendosën lidhje të ngushta me disa krerë të VMRO-së. Në depeshen e mësipërme, Qirkoviq, njofton për kalimin në ilegalitet të Dervish Himës, për shkak se kohë më parë ai: “*grabiti postën*” e Esadit, vrau postierin dhe “*ndërpreu rrjetin telegrafist me Elbasanin*”. Më pas ai ndalet në aktivitetin e planifikuar të Arif Hiqmetit në Shqipëri, ku thotë: “*Arif beu sot nga këtu udhëton për Peshkopi dhe atje do të veproj edhe në Gollorbordë tre deri katër ditë. Me këtë rast do të bëj pastrimin me çetat bullgare. Dje erdhi edhe Taf Kaziu dhe ai sot kthehet. Arifi së bashku me shokët e ka pranuar propozimin tim që të bëj pastrimin me bullgarët, prandaj me çetën prej 100 vetëve punën do ta nis që sonte. Për ne është mase e domosdoshme nevoja që kjo të kryhet sa më parë, për shkak se bullgarët janë në lidhje të ngushtë me njerëzit e Ismail Qemalit dhe po*

²⁸ ASHAK, A. Diplomati i Sekretariatit Federativ të Punëve të Jashtme – Beograd, Korrespondenca sekrete (MPJ) 1913-1915, Министарство Унутрашњих Дела, ПОВЕРЛИВО, 19 фебруара 1914 године у Београду – Хитно Министарство Иностранних Дела, Началник округа охридског шифрованом депешом од 18 овога месеца, доставио овом Министарство следеше...,

*grumbullohen, me çka mund të na shkaktojnë dëme shumë të mëdha...*²⁹

Gjithnjë duke u mbështetur në burimet diplomatike serbe, shohim se Arif Hiqmeti dhe Esad Pasha, përmes agjentëve të tyre arritën të krijojnë një përçarje midis Haqif Pashë Elbasanit, Dervish Himës, Hasan Prishtinës, Irfan Beut, etj., të cilët, siç u tha më sipër, në atë kohë qëndronin në Elbasan. Si rrjedhojë e mosmarrëveshjeve të krijuara, Hasan Prishtina, nga Elbasani vendoset në Dibër dhe Lumë, ku fillon organizimin e një kryengritje në viset shqiptare të aneksuara nga qeveria e Mbretërisë Serbe.. Për këtë qëllim ai zhvilloi takime të ndara me parinë e Dibrës e të Lumës, përkatësisht me Elez Isufin, Ismail Strazimirin, Basri Beun, Islam Spahinë, Osman Litën, Ramadan Çejkun etj..³⁰

Ndërkohë ai do të takohet edhe me komisionin i ardhur enkas nga Stambolli, po për atë qëllim, i udhëhequr prej Hajredin bej Pustinës. Për rrjedhojë, Hasan Prishtina me 150 ushtarët e vetë të cilëve do t'ju bashkëngjitën edhe një numër i konsiderueshëm i lumjanëve dhe dibranëve, sulmoi trupat serbe në afërsi të Kukësit³¹.

Për ardhjen e Hasan Prishtinës në Dibër, Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë Serbe, më 28 gusht 1914 njoftonte legatën e saj në Londër, ku veç tjerash të thuhej: “Marrim veshtë se dje Hasan Prishtina nga Dibra ka deklaruar se në Lumë ka hasë në mbështetje, dhe se me përkrahjen e Dibrës së Vogël dhe Matit menjëherë do ti sulmoj 2 trupat serbe në Prizren³²

²⁹ Po aty.

³⁰ I. Strazimiri, po aty, fq. 51-53

³¹ Po aty.

³² ДАРМ.1.18.6.39/56-59.

Pas disa ditë luftimesh kryengritësit shqiptar arrijnë deri në Zhur, mirëpo për shkak jo disiplinës nga ana e disa luftëtarëve shqiptarë, forcat e Hasan Prishtinës u thyen, me çka kjo përpjekje e tij për ti çliruar tokat e pushtuara dështoi³³.

Këtë punim do ta përfundoj me telegramin e Nikolla Pashiqit, lëshuar më 25 nëntor 1914, të gjitha legatave serbe, me këtë përmbajtje: *“Esad Pasha na është drejtuar neve me lutje që ta pushtojmë Elbasanin me qëllim të shuarjes së revoltës në Shqipëri, të cilën e nxitë Stambolli, që së bashku me Sofjen kanë shpallur luftë të shenjtë kundër Serbisë. Duke e pas parasysh situatën e këtillë të ndryshuar si duket do të jemi të detyruar të futemi brenda në Shqipëri, kjo duhet të jetë pikërisht në prag të fillimit të kryengritjes me çka kjo do të merr karakter se po i mbrojmë kufijtë tanë, por gjithsesi ky okupim do të ishte i përkohshëm, sepse ndryshe shkelim vendimin e Konferencës së Londrës.”*³⁴

³³ I. Strazimiri, po aty.

³⁴ ДАРМ.1.18.59/40.

SABIT SYLA

Instituti i Historisë “Ali Hadri” – Prishtinë

DRENICA GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Në prag dhe gjatë Luftës së Parë Botërore, e konkretisht vitet 1912 – 1918, kanë qenë karakterizuar nga zhvillime politike, diplomatike dhe luftarake, të përmasave gadishullore, kontinentale dhe botërore. Edhe territoret shqiptare qenë pjesë e koniukturave të tilla, vend i luftërave ndërmjet shteteve fqinje për të sendërtuar planet e tyre, si dhe dy blloqeve ndërluftuese (Antantës dhe Bllokut Qendror).

Në anën tjetër, Lëvizja Kombëtare Shqiptare shënoi një rritje të gjithanshme në luftën për çlirim dhe bashkim kombëtar në dekadën e parë të shek. XX. Kurorëzimi i një bashkërendimi të tillë u arrit me aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shtetit të pavarur shqiptar më 1912. Pavarësisht arritjes në aspektin kombëtar, në kohën kur u shpall pavarësia, gjendja ishte tejet e ndërlikuar. Situata politike ndërkombëtare, ishte jo e favorshme. Fuqitë e Mëdha nuk njohën pavarësinë e Shqipërisë e as monarkitë fqinje ballkanike. Kontradiktat midis Fuqive të Mëdha acaroheshin dita ditës, ndërsa Lufta e Parë Ballkanike vazhdonte, e tokat shqiptare ishin bërë arenë ndërluftuese ndërmjet ushtrisë së Aleancës Ballkanike. Në këtë kaos, çështja shqiptare u vu edhe në qendër të vëmendjes së konferencave ndërkombëtare. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (dhjetor 1912 – korrik 1913) përfaqësuesit e Fuqive të Mëdha evropiane e trajtuan çështjen shqiptare duke kënaqur orekset e vendeve fqinje ballkanike me territore shqiptare, pre

e këtyre orekseve qe edhe Kosova. Ishte politika e dyfishtë ballkanike dhe evropiane që i solli Shqipërisë atë gjymtim territorial që ka pësuar, si më 1878 në Shën Stefan, ashtu edhe më 1913 në Londër.

Pas krijimit të shtetit të pavarur shqiptar, Shqipëria përballoj intriga, plane e traktate tjera antishqiptare, të cilat synonin fshirjen e saj nga harta politike e Evropës. I tillë qe Traktati i Fshehtë i Londrës më 26 prill 1915, midis Fuqive të Mëdha të Bllokut të Antantës (Anglisë, Francës, Rusisë dhe Italisë). Pozicioni i Shqipërisë u përkeqësua pas nënshkrimit të këtij Traktati. Nga fillimi i qershorit të vitit 1915 ushtritë serbe e malazeze, pasi kishin pushtuar Kosovën dhe viset e tjera shqiptare disa vite më parë, synonin të depërtonin edhe në territorin e shtetit të pavarur shqiptar. Brenda një kohe të shkurtër pushtuan gjysmën e vendit, përfshirë Tiranën e Elbasanin. Mirëpo, ky pushtim nuk zgjati shumë, konkretisht deri në vjeshtë të vitit 1915, pasi ushtritë serbe e malazeze, të shpartalluara nga forcat austro – hungareze dhe ato bullgare, u detyruan të tërhiqeshin jo vetëm nga territoret e shtetit të pavarur shqiptar, por edhe nga Kosova³⁵.

Në Kosovë në fund të vitit 1915 (gjatë muajve tetor – dhjetor), ushtritë serbo – malazeze u thyen nga forcat austro – hungareze dhe bullgare. Trupat austro – hungareze e gjermane më 20 nëntor 1915 hynë në Pazarin e Ri, ndërsa më 21 nëntor hynë në Leposaviq. Luftërat e para kundër forcave austro – hungareze në territorin e Kosovës u bënë më 19 – 21 nëntor 1915 në rajonin e Leposaviqit. Në këto luftime ranë në duart e ushtrisë austro – hungareze 2 000 ushtarë serbë dhe sasi të mëdha të materialeve ushtarake. Më pas, ush-

³⁵ *Historia e Popullit Shqiptar III, Periudha e Pavarësisë 28 Nëntor - 7 prill 1939*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, “Toena”, 2007, f. 435.

tria austro – gjermane depërtoi nëpërmjet luginës së Ibrit në Kosovë pa ndonjë rezistencë të fuqishme³⁶. Në anën tjetër, edhe trupat bullgare që po depërtonin nga juglindja, korrrën sukses duke iu ofruar Prishtinës. Pra, Kosova pushtohet nga dy pushtues të rinj, Austro – Hungaria dhe Bullgaria.

Pushtimi i Kosovës dhe i viseve të tjera shqiptare nga Austro – Hungaria dhe Bullgaria solli më pas ndarjen e tyre në dy zona pushtimi. Zona e pushtimit austro – hungarez përfshinte Mitrovicën, Vushtrrinë, Drenicën e Poshtme, Istogun, Pejën, Gjakovën, Plavën, Gucinë, Tivarin dhe Ulqinin. Ndërkaq, zona e pushtimit bullgar përfshinte Podujevën, Prishtinën, Gostivarin, Tetovën, Dibrën, Kërçovën, Strugën, Ohrin dhe Prespën. Pas ndarjes territoriale të sundimit të tyre më 1916, ashtu si e tërë Kosova që ndahet në dy zona pushtimi edhe Drenica ndahet në dy të tilla, në veri Austro – Hungaria dhe në jug Bullgaria. Ushtria austro – hungareze më 25 nëntor 1915 kishte hyrë në Drenicën veriore.

Gjatë periudhës së okupacionit austro – hungarez, Qarku i Mitrovicës me rrethinë dhe komunat e Drenicës gjendeshin nën përbërjen e Guvernmanit, gjeneral ushtarak për viset e pushtuara që u formua në janar të vitit 1916 dhe i nënshtroar Komandës Supreme të Armatës Austro – Hungareze. Në krye të Qarkut (Prefekturës) së Mitrovicës gjendej koloneli Artur Shvarc, komandant i trupave të pushtimit në pjesën e Kosovës, ndërsa nënkoloneli Volf u emërua komandant i xhandarmerisë me seli në Mitrovicë. Ndërkaq, të gjitha komunat (edhe në Drenicë), kryetar të komunave nga pushtuesi vendosen shqiptarë si në komunat me shumice shqiptare ashtu edhe

³⁶ Liman Rushiti, *“Gjendja ekonomike dhe politike në Kosovë gjatë Luftës së Parë Botërore”*, Kosova, nr. 15, Instituti i Historisë - Prishtinë, 1986, f. 91.

në ato ku serbët ishin në numër më të madh si p.sh. në Banjë të Drenicës veriperëndimore rrëzë bjeshkëve të Moknes.

Jeta nën sundim bullgar ishte më e vështirë se në atë austro – hungarez. Pushtuesit bullgar në zonën që e kontrollonin nuk u epnin shqiptarëve të drejta kombëtare e njerëzore. Jo vetëm që nuk lejohej hapja e shkollave në gjuhën amtare, por ishte i ndaluar e i dënueshëm shpalosja e flamurit kombëtar, zhvillimi i kulturës kombëtare, etj. Ata ndiqnin e burgosnin të gjithë ata që zhvillonin aktivitete kulturore e kombëtar. Kështu e burgosen edhe Hasan Prishtinën. Gjendja vështirësohej edhe nga pasiguria, vjedhjet, punët angari, zia e bukës, rekrutimi i të rinjve në forcat ushtarake³⁷, etj.

Pozita e shqiptarëve në zonën e pushtimit dhe administrimit austro – hungarez krahasuar me vitet e mëparshme të sundimit serb e malazez u përmirësua dukshëm. Zgjidhjet nën pushtim gjatë LPB, për një pjesë të shqiptarëve në Kosovë mund t'i quajmë “fat në fatkeqësi”, në konfliktin e përgjithshëm botëror. Kështu, duke zbatuar politiken e autonomisë kulturore kombëtare ndaj popujve të shtypur, austro – hungarezet lejuan e ndihmuan në Kosovë hapjen e shkollave në gjuhën shqipe. Meritë të veçantë në këtë drejtim ka Hasan Prishtina, i cili i kushtonte një rëndësi të posaçme lëvizjes kulturore e arsimore kombëtare shqiptare. Me iniciativën e tij u hapen disa shkolla në Mitrovicë, Istog, Vushtrri³⁸, etj. Madje në këtë të fundit për herë të parë (Vushtrri), aty nga fundi i vitit 1915 e gjejmë edhe shkollën në gjuhën shqipe e cila

³⁷ Islam Dobra, *Krerë dhe prijës të Lëvizjes Kombëtare nga Drenica, prej gjysmës së shekullit XIX deri pas Luftës së Dytë Botërore*, Prishtinë, “Shoqata për ndriçimin e historisë kombëtare - shqiptare”, 1996, f. 162 - 163.

³⁸ Ibrahim Citaku, *Drenica 1991 - 1999*, Prishtinë, “Europrinty”, 2004, f. 43.

është ndër të parat në Kosovë³⁹. Kësisoj, gjatë viteve 1916 – 1918 kanë punuar shkollat fillore në gjuhën shqipe (prej kl. I deri V) në Prizren, në Mitrovicë, në Gjakovë, në Pejë, në Istog, në Skenderaj, në Vushtrri etj. Në disa fshatra të rrethit të Skenderajt si në Llaushë, në Runik, në Rezallë dhe në Polac, u çelen shkollat e para në gjuhën shqipe, të cilat financoheshin nga Austro – Hungaria⁴⁰. Në territorin e Drenicës kanë punuar edhe disa shkolla fillore katërklasëshe për djem e vajza, ku numri më i madh i tyre ishte në Runik, Klinë të Epërme, Drenas etj. Kësisoj sistemi arsimor në gjuhën amtare filloi të mëkëmbet. Po ashtu edhe administrata në gjuhën shqipe pjesërisht u bë e mundur që të realizohej në gjuhën shqipe, duke ndikuar kështu në rritjen e vetëdijes kombëtare. Por, pavarësisht lëshimeve të lartpërmendura, koha kur sunduan këto dy shtete në këtë Zonë jeta që tejet e vështirë e shoqëruar me vuajtje, shpërngulje, burgime e maltretime të popullsisë, si rezultat i metodave të ndryshme nga ana e aparatit sundues të tyre. Krahas tyre, një dukuri tejet e rëndë, ishte edhe regjistrimi i të ashtuquajturve “gjynli”, në ushtrinë turke e cila siç dihet ishte në luftë me Rusinë. Sunduesit austro – hungarez kishin lejuar që oficerët turq të vinin në Kosovë dhe të bënin një regjistrim të tillë e të cilët luftëtarë rrallëherë ktheheshin të gjallë nga andej. Fenomen të cilin për fat të keq e ndihmonin edhe disa bejlerë të pasur e hoxhallarë fanatikë, për shkak të interesave të tyre të ulëta personale⁴¹.

³⁹ Bedri Tahiri, *Azem Bejtë Galica*, Prishtinë, “Shkëndija”, 2005, f. 43.

⁴⁰ Fazli Hajrizi & Ibrahim Rr. Gashi, *Mësuesi Rrahim Gashi me brezat në trojet arbërore*, Tiranë, “Instituti i Integritetit të Kulturës Shqiptare”, 2010, f. 36.

⁴¹ B. Tahiri, *Azem Bejtë...*, f. 35.

Në një situatë të tillë të krijuar, në atë dekadë të parë të shek. XX, Lëvizja Kombëtare Shqiptare shënoi një rritje të gjithanshme në Kosovë, në veçanti në Drenicë duke qenë më aktive se kurrë. Këtë e dëshmon Lëvizja Çlirimtare e fillim shekullit XX e karakterizuar nga lufta për çlirim kombëtar, duke bërë edhe kthesë të madhe e ndryshuar kursin e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare duke qenë kështu sfiduese edhe për pushtuesin. Fjala është për Lëvizjen Çlirimtare të formuar në Drenicë, njohur ndryshe në historiografinë e deritanishme shqiptare edhe me emrin si “Lëvizja Kaçake” e cila është pjesë përbërëse e historisë së popullit shqiptar, me një të kaluar të pasur e të largët e cila kërkon thellime të gjithanshme e qasje të llojllojshme, pasi që është edhe e vetmja lëvizje që veprimi në Kosovë e më gjerë, para, gjatë dhe ndërmjet dy luftërave botërore, si lëvizje ushtarake.

Ishte ideologu i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, Hasan Prishtina po nga Drenica, i cili edhe do të udhëzojë krerët e Lëvizjes Çlirimtare për rezistencë të përgjithshme edhe ndaj këtyre dy pushtuesve të rinj, ashtu si më parë ndaj pushtuesit turk e atyre serbo – malazez. Në situatën e krijuar fillimisht nga pushteti ushtarak e policor serb, më pas nga ai austro – hungarez e bullgar, shqiptarët të cilët u vunë përballë alternativës së kundërshtimit ose të vdekjes ata vendosen që të mbrohen me të gjitha mjetet. Udhëzimet e konstruksionet e përgatitura dhënë krerëve të Lëvizjes Kombëtare Ahmet Delisë, Fazli Beranit, Ali Bunjakut, Latif Smajlit, Shaqir Smakes, Azem Bejtes e të tjerëve, do të dhënë edhe rezultatet e pritura për kryengritje kundër pushtuesve⁴².

⁴² Fazli Hajrizi, *Drenica dhe Lutanët e Turipeçcit*, Mitrovicë, “Lumi i Bardhë”, 2006, f. 224.

Në dimër të vitit 1915, pasi që rrethohet kreu i Lëvizjes Çlirimtare Shaqir Smaka nga forcat austro – hungareze, vriten 9 ushtarë austriakë dhe 1 toger⁴³. Në pranverë të vitit 1916, ushtria austriake e udhëhequr nga vetë komandanti kryesor austriak Hertman ose Llakmajstori fillojnë sulmin ndaj krerëve të Lëvizjes Kaçake. Me këtë rast, në betejën e zhvilluar qenë të dy udhëheqësit kryesor Azem Bejta dhe Shaqir Smaka. Hertman me kreun e Lëvizjes Shaqir Smaken kapen fyta – fyt. Në rrokullisje e sipër, për fat të keq Shaqirin e vrasin të tjerët duke goditur Hertmanin – oficerin austriak (godet që të dy), duke rënë kështu edhe udhëheqësi kryesor i Lëvizjes Çlirimtare⁴⁴. Është për t'u theksuar fakti se më parë Shaqir Smaka në takimin që kishte pasur me llokmajstorin e përmendur kishte kërkuar nga ai vetadministrimin e shqiptarëve, gjë që ishte kundërshtuar nga ky komandant austriak⁴⁵.

Lëvizja Çlirimtare edhe pas rënies së udhëheqësit kryesor ushtarak, vazhdon, tani më udhëheqësin e ri të Lëvizjes Azem Galicën i cili u bë edhe drejtues i të gjitha çetave kryengritëse në Kosovë. Në fund të vitit 1916 u sulmua dhe u likuidua një postëkomandë e xhandarmerisë austriake në Mikushnicë. Nga ky sulm, mbeten 7 të vrarë e 3 të plagosur⁴⁶. Azem Bejta pas vrasjes së vëllezërve të tij në Galicë nga austro – hungarezet, në mars të vitit 1917, sulmon ushtrinë bullgare dhe austriake. Në Obri i vranë 8 ushtarë bullgarë dhe austro – hungarezë, por edhe Azemi plagoset rëndë⁴⁷.

⁴³ I. Dobra, *Krerë dhe prijës të Lëvizjes Kombëtare...*, f. 166.

⁴⁴ *Po aty*, f. 167-168.

⁴⁵ *Po aty*, f. 165.

⁴⁶ B. Tahiri, *Azem Bejtë...*, f. 37.

⁴⁷ I. Dobra, *Krerë dhe prijës të Lëvizjes Kombëtare...*, f. 162

Qeta e Azem Bejtes më 1918 numëronte 300 – 400 luftëtarë. Në vjeshtë të vitit 1918 në bashkëveprim me çetat e tjera shqiptare, çliroi Drenicën dhe Istogun dhe në tetor e detyroi komandantin e garnizonit të Pejës ta dorëzonte qytetin. Në ballkonin e Bashkisë së qytetit ngriti flamurin kombëtar i cili valoi derisa erdhën ushtria serbe dhe ajo franceze, të cilat e zëvendësuan atë me flamurin serb⁴⁸. Forcave franceze të Frontit të Selanikut, që depërtuan në Kosovë (gjatë tetorit), u dorëzoi qindra robër austro – hungarezë dhe sasi të konsiderueshme armatimi⁴⁹. Kështu, derisa shqiptarët luftonin për çlirimin e vendit të tyre në anën tjetër serbët po marshonin në Kosovë duke pushtuar serish të gjitha vendet dhe duke vendosur pushtetin e tyre okupues. Edhe në Drenicë, trupat serbe depërtuan me shpejtësi duke restauruar me dhunë pushtetin e tyre ushtarak, në fund të vitit 1918.

⁴⁸ *Historia e Shqipërisë dhe e Shqiptarëve*, Prizren, “Siprint”, 2001, f. 191.

⁴⁹ Marenglen Verli, *Nga Kosova për Kosovën, Profile Biografike*, vëll. i parë, Tiranë, “Botimpex”, 2006, f. 89.

ISAK SHERIFI

Universitetit Shtetëror i Tetovës

SKENDER ASANI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

PROGRAMI I QEVERISË SHQIPTARE NË KONFERENCËN E PAQES NË VERSAJË (1919)

Në fillim të decenies së dytë të shekullit XX, me fillimin e luftërave ballkanike, shtetet përreth tokave të banuara me shqiptarë, të cilat ishin pjesë përbërëse të Perandorisë Osmane, kishin për synim që sa po të shkatërrohet kjo perandori, ato t'i fusin në përbërjen e shteteve të tyre etnike. Jo rastësisht gjatë lidhjes së aleancës ballkanike, populli shqiptar edhe pse kishte dëshirë të jetë përbërëse e sajë, ajo nuk u pranua me të vetmin qëllim se ishte paraparë në planet e projektet e tyre okupuese. Gjatë depërtimit në viset shqiptare, ushtria e aleancës ballkanike kishte bërë masakra të papara dhe tmerruese për popullatën shqiptare, që do të rezultojë me shpërngulje masive në drejtim të Turqisë. Aleanca ballkanike këtë dhunë të shfarosjes e justifikonte se po e luftonte dhe po e ndiqte ushtrinë turke.

Nga ana tjetër Qeveria e kryesuar nga Ismail Qemali nuk ishte e fuqishme për t'i mbrojtur viset verilindore të sajë. Në Konferencën e Ambasadorëve në Londër, viset verilindore shqiptare iu dhanë Serbisë, që faktikisht kjo konferencë zyrtarizoi aneksimin e këtyre viseve dhe krijoi një shtet të cunguar shqiptarë (Shqipërinë londineze, I.SH, S.A). Ndaj këtyre vendimeve dhe ndaj dhunës shqiptarët ishin përgjigjur me kryengritjen antiserbe të shtatorit të vitit 1913.

Në përputhje me vendimin e 29 korrikut 1913, Konferenca e Ambasadorëve në Londër, përkatësisht Fuqitë e Mëdha, pranuan në nëntor 1913, që princ i Shqipërisë të ishte gjermani Vilhelm fon Vid, i propozuar nga Austro-Hungaria dhe Italia. Sipas Statutit organik të Shqipërisë (Kushtetuta e parë e shtetit shqiptar, S.A) të miratuar në prill të vitit 1914, Fuqitë e Mëdha garantonin tërësinë dhe paprekshmërinë e tokave të Shqipërisë. Sipas këtij statuti, shteti shqiptar do të ishte asnjans dhe kjo asnjansëi garantohej po nga Fuqitë e Mëdha.⁵⁰

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore pati pasoja të rënda për shtetin e pavarur shqiptar, të pakonsoliduar ende politikisht. Fuqitë e Mëdha, që kishin vënë Shqipërinë nën garancinë e kontrollin e tyre, tani kishin hyrë në luftë me njëra – tjetrën. Të dy grupet e fuqive ndërluftuese shpejtuan ta përdornin Shqipërinë edhe si objekt të planeve të tyre luftarake e politike. Këtë gjendje të re ndërkombëtare e shfrytëzuan shtetet fqinjë që lakmonin tokat e Shqipërisë.

Në përfundim të Luftës së Parë Botërore, në fillim të nëntorit të vitit 1918, trevave etnike dhe çështja shqiptare u gjendën para një rreziku tjetër të tkurrjes etnike, siç kishte ndodhur edhe në dy konferencat e mëhershme, atë të Berlinit e të Londrës. Shqipëria londineze e pasluftës ishte e përçarë politikisht dhe e

⁵⁰В.П.Потемкин, *Историја дипломатије-Дипломатија новог века (1872 – 1919)*, Свеска друга, Београд, 1949.; Hysni Myzyri, *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Prizren, 2001; Muhamet Shatri, *Dokumente britanike për çështjen shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912 – 1913*, Tiranë, 2012; Paskal Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë I*, Tiranë, 2013; Врење у Албанији, “Политика”, бр.3466, дт.06.09.1913, Београд, 1913, 1.

dobët ekonomikisht, por edhe e okupuar nga forcat italiane, franceze dhe serbe.⁵¹

Në fund të muajit dhjetor të vitit 1918 u mbajt në Durrës Kuvendi Kombëtar, ku doli edhe votimi i qeverisë së përkohshme, e cila ishte ngarkuar me detyrë për të proklamuar se në mes të Adriatikut e të Jonit me një anë, të Vardarit, të Bosnjës e të Malit të Zi me tjetrën, në këto vise etnike jeton një komb me një kulturë të lashtë dhe synimi i saj është që të jetojë i lirë së bashku me popujt e tjerë të qytetëruar evropian.⁵² Detyrën që i kishte parashtruar para vete kjo përbërje e qeverisë, ishte argumentimi historik e politik i viseve etnike shqiptare që do t'ia drejtonte Konferencës së Versajës. Nëpërmjet këtyre argumenteve qeveria e përkohshme dëshironte të vinte në dijeni Fuqitë e Mëdha që ishin mbledhë në Parisë, që mos të përsërisnin gabimin që e kishin bërë në Kongresin e Berlinit të viti 1878 dhe Konferencës së Ambasadorëve në Londër të vitit 1913. Delegacioni shqiptar u përball me apetitet e shteteve për rreth trojeve etnike, të cilat gjatë Luftës së Parë Botërore ishin përkrah të Antantës dhe tash në Konferencën e Versajës dëshironin që territoret e banuara me shqiptar të jenë pjesë së shteteve të tyre.

Delegacioni shqiptarë i cili përfaqësonte qeverinë e përkohshme, ishte i detyruar që t'i përmbahet programit të miratuar në Kuvendin Kombëtar të Durrësit, që korrespondonte me vendimet e Vlorës të 28 nëntorit 1912. Motoja e këtij prog-

⁵¹Skender Asani, *Delegacioni shqiptar në mbrojtje të trevave lindore në Konferencën Paqësore të Versajës*, Albanologji II, Instituti Albanologjik – Prishtinë, Prishtinë, 2011, 387.

⁵²Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Shqipërisë (më tej AMPJSH), viti 1919, dosja 12, fl.2.

rani ishte i qartë: *“Shqipnia e Shqiptarëvet me kufijt që i ka falun Zoti, deri ku flitet gjuha e ambël e zogjve të shqipes”*.

Qeveria e përkohshme në proklamatin e saj drejtuar shqiptarëve, nënvizonte se armiqte e atdheut e të kombit punojnë, siç kanë punuar gjithmonë, jo vetëm jashtë Shqipërisë, por edhe brenda saj, për të na paraqitur para botës dhe sidomos para atyre që vendosin për fatin tonë, të ndarë e të përçarë, jo si një komb i tërë, por disa fise që s’kanë pasur kurrë bashkim njëri me tjetrin, si njerëz të egër e të padisiplinuar, që po të lihen vetëm, do të kishin ngrënë për së gjalli njëri tjetrin e kishin me turbullue paqen e përgjithshme.⁵³ Në këtë drejtim, më të theksuara ishin propagandat serbo – greke, të cilat dëshironin të paraqitnin popullin shqiptar si të paafte për të pasur shtetin e tyre në Ballkan dhe shkonin edhe më larg që çdo tendencë të njohjes të një shteti shqiptar në Ballkan ai do të ishte i dëmshëm për civilizimin dhe rregullimin e ri evropian! Në shërbim të kësaj çështje ata vunë në shërbim makinerinë e tyre propagandistike, duke publikuar në gazetatat e ndryshme botërore se shqiptarët nuk janë një popull kompaktë, janë një popull i cili jeton në fise feudale dhe e parapëlqejnë anarkinë për të vanë në veprim natyrën e egër të tyre.

Sipas protokollit të 28 qershorit 1919 të Qeverisë së Përkohshme, delegacioni shqiptar në Konferencën e Paqes në Versajë, kishte për detyrë të bëjë bashkimin e të gjithë individëve, grupeve e shoqatave dhe të gjithë ishin të detyruar që ti përmbahen rregullave të unitetit. Mihal Tortulli e Mehmed Konica, ishin të obliguar që në Konferencën e Paqes të ndjekin programin e qeverisë së përkohshme, e cila do të paraqes parimet e tërësisë tokësore, të pavarësisë e të drejtave supreme

⁵³ AMPJSH, Viti.1919, Dosja.12, fleta.3.

të kombit shqiptar. Sipas dëshirës së Mehmed Konicës, që është i zgjedhur për delegat në Londër, kryetari i delegacionit të qeverisë shqiptare kishte për obligim me njohtu zyrtarisht Kryesinë e Konferencës së Paqes në Versajë, se Mehmed Konica ishte pjesë e delegacionit shqiptar. Njëherësh, konferenca do të njoftohej se pjesë e delegacionit ishte edhe Mihal Tortulli. Pritej çështja e Shqipërisë së shpejti të hapet për diskutim në Konferencë. Parashtrohej si nevojë që një përfaqësues shqiptar të jetë pranë delegacionit anglez për të njoftuar për të drejtat e shqiptarëve, me synim të përfitohet simpatia e tyre për çështjen shqiptare. Për këtë çështje të caktohet Mehmed Konitca që sa më shpejtë të shkojë në Londër, dhe Pandeli Evangjeli e Fuad Zembraku të emërohen si ekspert të delegacionit zyrtar të qeverisë së përkohshme.⁵⁴

Opinionit shqiptar kërkonte nga përfaqësuesit e deleguar nga qeveria e përkohshme në Konferencën e Paqes në Paris të bënte publike programin e saj, ndërsa me 19 korrik nëpërmjet një shkrese delegacioni shqiptar bënte publike programin e saj, të cilën ia drejtonte përfaqësuesve diplomatik pjesëmarrës në konferencë. Programi i Qeverisë së përkohshme, për sa i përket mbrojtjes së të drejtave të atdheut, programi përmbledhej në tri pika themelore:

1. Tansia toksore e Shqipërisë mbrenda kufijve të saj etnik;
2. Pavarsia e plotë e Shtetit shqiptar;
3. Të drejtat elementare të kombit shqiptar si për mbrenda ashtu edhe atë të jashtme.⁵⁵

Ndërsa, më 24 korrik, delegacioni shqiptar në përbërje kryetari Bumçi, anëtarët Mehdi Frashëri, Luigj Gurakuqi dhe sekretari i delegacionit At Gjergj Fishta, ishte mbledhur urgjen-

⁵⁴ AMPJSH, Viti.1919, Dosja.8, fleta. 40 – 41.

⁵⁵ AMPJSH, Viti.1919, Dosja.9, fleta.257

tisht për të shqyrtuar Promemorien bullgare, e cila parashihnte aneksimin e krahinave të Shkupit, Tetovës, Gostivarit, Rekës, Dibrës e Ohrit, ku këto treva i quante krahina bullgare. Në këtë mbledhje u vendosë që t'i dërgohet Kryetarit të Konferencës një protestë kundër këtyre kërkesave të padrejta të bullgarëve. Në këtë protestë thuhej se në këto krahina shumica e popullsisë është shqiptare dhe padrejtësisht Serbia i mban në dorë këto treva që duhet t'ia kthejë shtetit shqiptar.⁵⁶ Me 25 korrik delegacioni shqiptar në një mbledhje shqyrtoi bisedimet që po zhvilloheshin në punimet e Konferencës për çështjen e shqiptarëve muhamedan që gjendeshin në viset që u dhanë Greqisë në vitin 1913. Kjo popullatë duke mos dashur që të pranojnë ta ndërrojnë kombësinë për t'u bërë grekë, dhe duke mos mundur që të ndërrojnë shtetësinë turke me atë shqiptare, (nga shkaku që shteti shqiptar, ende nuk kishte marrë formë konkrete dhe ndërkombëtare, pra formalitetet e duhura për këmbimin e shtetësisë, nuk ishin të mundura), prandaj ata qëndruan në pozicione të status—kuosë, domethënë shtetas turq. Në fund të qershorit qeveria greke, kishte nxjerrë një urdhëresë me anë të së cilës të gjithë shtetasit turq brenda territorit të Greqisë, i detyronte të lëshojnë vendet e veta. Delegacioni shqiptar reagoi ashpër kundër kësaj urdhërese, duke vënë në dijeni konferencën se ky akt është në kundërshti me nenin 6 të traktatit të paqes të lidhur ndërmjet Turqisë dhe Greqisë me 1/14 nëntor të vitit 1913. Duke qenë se urdhëresa është një akt kundërligjorë dhe antinjerëzorë, sepse shqiptarët duhet të jetojnë, në viset e tyre etnike si shtetas shqiptar, Greqia nuk ka të drejtë ti dëbojë ma parë se Konferenca t'i caktojë kufijtë e Shqipërisë. Delegacioni shqiptar

⁵⁶ AMPJSH, Viti.1919, Dosja.8,fleta.28.

do të reagojë ashpër para Konferencës që mos të dëbohen nga trevat e tyre etnike çamët muhamedan.⁵⁷

Megjithatë, kërkesat shqiptare nuk gjetën mbështetës të fortë në aleancat e mëdha botërore, kështu që fati i tyre përsëri mbeti në pamëshirën e fqinjëve grabitqarë.

⁵⁷ AMPJSH, Viti.1919, Dosja.8, fleta.31.

HAKI KASUMI

Instituti i Historisë “Ali Hadri”, Prishtinë

GJENDJA NË KOSOVË GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Shqiptarëve nuk u buzëqeshi fati i lirisë edhe pse luftuan pa ndërpre kundër të gjithë pushtuesve të cilët kishin shkelur vijeve e tyre etnike. Kështu ndodhi edhe pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane për të cilën gjë kontribuuan edhe shqiptarët në përgjithësi, e sidomos ata të Kosovës. Popullata shqiptare që ishte shumicë absolute e banuesve të ish Vilajetit të Kosovës nuk arriti ta gëzojë lirinë e merituar pasi që pushtuesit e ri kishin arritur të shfrytëzonin momentin politik dhe rrjedhat e përgjithshme në Ballkanin e trazuar në dekadën e dytë të shekullit XX.

Gjendja e përgjithshme në Kosovë nga viti 1912 e deri në fillimin e Luftës së Parë Botërore ishte tejet e rendë. Planet e njohura nacional shoviniste serbo malazeze për këto vise të pushtuara shqiptare ishin hartuar më herët dhe po punohej që të sendërtoheshin në afat sa më të shkurtër. Ata vrisnin e masakronin në masë civil, ndërmerrnin masa represive dhe gjithashtu kishin hapur të gjitha dyert për shpërngulje të shqiptarëve në Turqi e gjetiu me të vetmin qëllim që të zbraznin Kosovën dhe viset e tjera shqiptare.

Me fillimin e Luftës së Parë Botërore, gjendja në Kosovë ishte renduar edhe më shumë, ishin shtuar forcat ushtarake dhe policore serbe, sepse Austro-Hungaria nga veriu bënte vazhdimisht presion ushtarak ndaj Serbisë. Në këto rrethana të vitit të parë të luftës, qeveria e Serbisë kishte bërë shumë kërkesa

drejtuar aleatëve të saj për: “rroba ushtarake, tenda, veshmbathje dhe municion”, për siç thonin: “*realizimin e veprimeve ushtarake për çështjet të përbashkëta*”.⁵⁸ Përgjegjësia e aleatëve në këto kërkesa ishte e vogël dhe e pamjaftueshme, kishte konstatuar pala serbe në reagimin e saj.

Edhe në këto kushte, presioni dhe reprezaljet serbe ndaj shqiptarëve nuk ndaleshin. Me të madhe bëhej mobilizimi dhe dërgimi i të rinjve shqiptar në frontet e luftës edhe pse ata ishin fare të papërgatitur. Trajtimi i regrutëve shqiptar nga oficeret serb, në repartet e të mobilizuarve ishte jo i mirë dhe diskriminues, për këtë dhe arsye dhe të tjera, ata ishin të detyruar të largoheshin⁵⁹, dhe të provonin të ktheheshin pranë familjeve të tyre. Kjo dukuri kishte filluar ti shqetësonte oficeret serb, gjë e cila shprehej në shkrimet e tyre.

Ushtria serbe sillej keq me banorët joserbë, bënte rekuizimin (marrjen e detyrueshme) për nevojat e veta, të drithit, të ushqimit për kafshë si dhe të kafshëve tërheqëse.⁶⁰ Këto veprime të pushtetit ushtarako— policor serb, aplikoheshin në mënyrë selektive dhe ndërmerreshin kryesisht ndaj popullatës shqiptare. Në anën tjetër forcat e rezistencës shqiptare të prira nga Hasan Prishtina, Bajram Curri, Isa Boletini e të tjerë, po organizonin dhe zhvillonin aktivitete luftarake kundër njësiteve ushtarako policore serbe të cilat edhe pse në ikje nga forcat austro —hungareze po planifikonin një intervenim ushtarak në Shqipëri për të ruajtur pozitat e renegatit Esat Toptani. Kjo kryengritje shqiptare e shkurtit të vitit 1915 arriti të ndal turrin e forcave

⁵⁸ . Petar Tomac, *Prvi svetski rat 1914- 1918*, Vojno izdavacki zavod, Beograd, 1973, 733.

⁵⁹ Vladimir J.Radojevic i Dobrosav J.Milenkovic, *Propast srpskih regruta 1915*, Beograd 1967, 12.

⁶⁰ Limon Rushiti, *Rrethanat politiko- shoqërore në Kosovë 1912- 1918*, Prishtinë, 1986, fq.170

ushtarake serbe dhe ti zmbraps ato për një kohë. Pas përforci-meve dhe ndihmës nga njësitet e Malit të Zi, forcat serbe rikthyen pozitat dhe detyruan kryengritësit shqiptar të tërhiqen. Edhe këto zhvillime luftarake e rënduan dhe e keqësuan gjendjen e popullatës shqiptare në Kosovë dhe më gjerë.

Në këto rrethana të rënduara në gjithë hapësirën kombëtare shqiptare po nxinte robëria e re, pa asnjë krahinë e rajon të pavarur. Që nga krahina e Sanxhakut e deri në cepat jugor, shtrihej robëria e monarkisë së Vjenës. Në pjesën jugperëndimore bregdetare pllakoste robëria e Romës. Që nga Prishtina e Gjakova, Prizreni e tërësisht në Shqipërinë verilindore e lindore shtrihej robëria bullgare. Në këto zhvillime të rënda e të ndërlikuara, Shtabi i Armatës Operative Bullgare njoftonte nga Ferizaj se “ushtritë, austro– hungareze... kanë plaçkitur çdo gjë nga popullsia vendase”⁶¹. Peja shfrytëzohej për furnizimin e Malit të Zi. Nga 600 vagonë drithë që jepeshin për gjithë Malin e Zi, 450 merreshin në Pejë. Në anën tjetër nga komanda austro– hungareze këmbëngulej se shkëputja nga Peja për furnizim do të shkaktonte pakënaqësi të madhe në Malin e Zi, madje edhe diçka më tepër. Pakënaqësia kishte arritur kulmin e durimit edhe në Shqipëri, atje gjendja ishte më keq se në Mal të Zi. Monarkia vetëm sa për të zbutur disi gjendjen në këtë kohë, dërgoi ndihmë simbolike prej 30. 000 koronash për t’ua shpërndarë të vobektëve, për të cilën gjë udhëzoheshin qarqet dhe rrethet.⁶² Në kushte dhe rrethana të tilla të një krize të përgjithshme Austro–Hungaria e Bullgaria e filluan qeverisjen në Shqipëri dhe në viset e tjera shqiptare

⁶¹ Shaban Braha, *Gjenocidi serbomadh dhe qëndresa shqiptare 1844-1990*, Gjakovë, 1991, 235; Gjithashtu, të dhëna interesante për këso veprimesh, gjenden edhe në librin e përmendur në fusnotën 1. fq. 16.

⁶² Po aty.

qe kishin mbetur padrejtësisht jashtë saj. Këto veprime gjithashtu kishin reflektuar në keqësimin e më tejshëm të gjendjes ekonomike e politike të popullatës shqiptare e cila në vitin 1914 e 1915 po përballej me të madhe me urinë. Vlerësimin e gjendjes më së miri e pasqyronte gazeta *Nju-Jork Tajms* kur shkruante se “*Një komb po vdes nga uria*”.⁶³

Në anën tjetër, forcat e rezistencës shqiptare në krye me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Isa Boletinin e të tjerë, po zhvillonin aktivitete për luftë kundër forcave ushtarake polico-re serbe të cilat edhe pse në ikje nga forcat austro-hungareze po torturonin popullatën shqiptare në Kosovë dhe po planifikonin një intervenim ushtarak në Shqipëri për të ruajtur pozitat e renegatit Esat Toptani. Kryengritja shqiptare e shkurtit 1915 arriti të ndal turrin e forcave ushtarake serbe dhe ti zmbraps ato për një kohë. Por pas përforcimeve dhe ndihmës nga njësitet ushtarake të Malit të Zi, forcat serbe rikthyen pozitat dhe detyruan kryengritësit shqiptar të tërhiqen. Edhe këto zhvillime e rënduan dhe e keqësuan gjendjen e popullatës shqiptare në Kosovë dhe më gjerë.

Në këto rrethana të ndërlikuara kur Bullgaria ishte në luftë me Serbinë, kjo për të pasur rrugën e çelur për në detin Adriatik, para aleatëve gjeti arsye për të okupuar disa vise të Shqipërisë edhe pse kjo kishte proklamuar neutralitetin në këtë luftë. Në këtë hap, Serbisë i ndihmonte edhe Esat Toptani të cilit nga kryengritësit shqiptar i kanosej rreziku gjithnjë e më shumë.

Kështu ushtra serbe nuk intervenoi vetëm në Has e Mirditë, ajo në qershor 1915 depërtoi thellë në Shqipëri dhe mori Elbasanin dhe Tiranën dhe forcoi pushtetin e renegatit të vet

⁶³ Si shënimi 4, fq. 236.

Toptani. Këto dhe zhvillimet e tjera vetëm sa e indinjuan popullatën shqiptare.

Zhvillimet vijuese në shtator–tetor 1915 kur Bullgaria, Austro–Hungaria dhe Gjermania u vërsulen ndaj Serbisë dhe e detyruan përfundimisht që ajo të orientohej për tërheqje në drejtim të Kosovës, për të vazhduar tutje në drejtim të Greqisë nga e cila anë, Serbia e priste ndihmën e premtuar të aleatëve anglo– franceze.

Në këto zhvillime, trupat bullgare, me 22 tetor 1915, kishin pushtuar Shkupin, dhe pastaj kishin depërtuar në Kosovë dhe arritur deri në rrethinën e Gjilanit.⁶⁴ Në krahun tjetër trupat austro–gjermane pasi kishin pushtuar Beogradin, me shpejtësi të madhe kishin depërtua kah jugu. Kështu drejtim i vetëm për tërheqjen e ushtrisë serbe ishte territori i Kosovës për të kaluar në Shqipëri – Detin Adriatik. Në gjysmën e dytë të nëntorit forcat ushtarake austro–hungareze arritën në territorin e Kosovës duke i shkaktuar dëme të mëdha ushtrisë serbe. Me 21 nëntor 1915 në Mitrovicë ishte shkaktuar një kaos i përgjithshëm për shkak të grumbullimit të ushtrisë serbe, të popullatës së ikur bashkë dhe mungesës së ushqimit dhe të sigurisë. Nga presioni i madh i forcave austro hungareze dhe në anën tjetër të atyre bullgare Komanda Supreme e ushtrisë serbe, detyrohet të merr vendim për tërheqje nëpër Kosovë: Pejë– Gjakovë– Prizren, në drejtim të Shqipërisë⁶⁵, nipër terren të vështir dhe në kohë dimri për të arritur në bregdetin shqiptar, prej nga destinim kishte Korfuzin.

Nga fundi i nëntorit 1915, Kosova përfundimisht u zbraz nga forcat ushtarake ushtarako policore serbe e malazeze dhe u pushtua nga ato Austro–Hungareze dhe Bullgare. Ndarja e

⁶⁴ Limon Rushiti, *vepra e cituar*, 174,

⁶⁵ Po aty.

Kosovës në mes të Bullgarisë dhe Austro– Hungarisë u bë në këtë kohë duke u mbështetur në konventën e 6 shtatorit 1915 të nënshkruar në Pelles.⁶⁶ Pozita e popullatës shqiptare jo vetëm që nuk ndryshoi për të mirë por ajo vazhdoi të rëndohej edhe pas këtyre zhvillimeve.

Në bazë të marrëveshjes përfundimtare Bullgaria ushtronte pushtetin e saj okupues në këto vise të Kosovës: Llap, Prishtinë, Gjilan, Kamenicë, Viti, Kaçanik, Ferizaj, Lipjan, Glogoc, Suharekë, Rahovec dhe Prizren. Ndërsa e gjithë pjesa tjetër e Kosovës ishte nën administrim e pushtetit okupues Austro–hungarez që përfshinte: Mitrovicën, Vushtrrinë, Serbicën (tash Skenderaj), Istogun, Pejën dhe Gjakovën.

Të dy këta pushtues në territorin e Kosovës kishin ndërtuar aparatin e veçantë administrativ sipas modeleve të pushteteve përkatëse dhe ishin plotësisht të pavarur nga njëri tjetri. Kështu pjesa e Kosovës nën okupimin bullgar në aspektin administrativ ishte e ndarë në 8 rrethe, 116 komuna, në të cilat bënë pjesë 832 fshatra. Numri i përgjithshëm i popullsisë në këtë territor në bazë të dhënave statistikore të kohës, ishte 317.438 banor. Në secilën qendër të qarkut, por edhe në çdo rreth pushtuesit bullgar vendosën edhe organet ushtarake— si qendër të divizioneve apo të brigadave ushtarake.⁶⁷ Vëmendja e pushtuesve bullgar ishte përqendrua posaçërisht në territorin e Kosovës, ku ishin vendosur forca të zgjedhura ushtarake ngase këtë e konsideronin vend me rëndësi të veçantë strategjike. Organet ushtarake bullgare ushtronin pushtetin e tyre të pakufishëm. Ato dhe organet policore ishin mbi organet e

⁶⁶ Po aty, 177.

⁶⁷ Limon Rushiti, vepër e cituar, 179, Krste Bitovski, *Stradanja i otpor stanovnistva Kosova i Metohije za vreme Bugraske okupacije*, Istoriski Glasnik, nr. 4, Beograd, 1963, 83.

pushtetit civil, të cilat shërbenin vetëm për çështje administrative. Pas qershorit të vitit 1918 pushteti okupues bullgar në Kosovë kishte ber ndryshime në strukturimin e pushtetit ushtarako policor për shkak të keqësimit të gjendjes së sigurisë. Prandaj edhe u bë riorganizimi i forcave ushtarake bullgare në këtë zonë okupuese në Kosovë. Tani e tutje në këto vise ishin krijuar dy rajone të “Brigadave okupuese” të cilat pastaj ndaheshin në ashtuquajturat “*Polkovne operacione reone*” që në fakt ishin koloni ushtarake okupuese. Qarku i Prishtinës përbënte të ashtuquajturin “rajonin e parë të kolonisë okupuese ushtarake të Brigadës së Parë Okupuese, ku nuk bënte pjesë rrethina e Ferizajt. Ndërsa qarku i Prizrenit bashkë me rrethinën e Ferizajt dhe të Kaçanikut përbënte rajonin e kolonisë së katërt okupuese bullgare të rajonit të dytë të brigadës okupuese. Këto njësi të mëdha administrative pastaj ndaheshin në njësi më të vogla në të cilat përfshiheshin territoret e rretheve përkatëse. Një ndarje e tillë qëndroi deri në fund të shtatorit të vitit 1918. Qeveritaret bullgar këto territore të okupuara i konsideronin si pjesë përbërëse të shtetit bullgar. I terë aparati i administratës ishte i përbër prej qytetarëve të sjellë nga brendia e Bullgarisë, përjashtim bën disa komuna të cilat përbëheshin nga fshatrat malore ku ishte angazhuar popullsia vendore. Pushteti okupues bullgar kishte angazhuar elementin vendor në disa poste të nivelit të ulët administrativ apo në organet e policisë për qëllime propagande dhe për të fituar besimin e masës popullore shqiptare e cila ishte e pa arsimuar dhe donte të krijonte përshtypjen e një barazie të gjithë qytetarëve në shtetin e Bullgarisë. Në anën tjetër reprezaljet e shumta dhe internimi i popullsisë shqiptare të këtyre viseve po vazhdonte me ritëm të lartë.

Në rrethanat e okupimit bullgar gjatë gjithë periudhës së Luftës së Parë Botërore, situata politike dhe ekonomike karakterizohej me dukuritë më të shëmtuara të jetës: njerëz të shumtë të uritur, të kapluar nga vuajtja dhe përballur me persekutime të rënda e të vazhdueshme nga një pushtet shumë armiqësisht i disponuar ndaj popullatës shqiptare që përbënte shumicën e banorëve të këtyre viseve. Produkt i zhvillimeve të tilla ishte edhe gjendja e përgjithshme e rëndë dhe e nderë, gjatë gjithë kohës të okupimit bullgar të Kosovës dhe të disa viseve të tjera shqiptare.

Ndërsa në pjesën tjetër të Kosovës të okupuar nga Austro-Hungaria mbretëronte gjithashtu një situatë e rëndë dhe me forma të tjera të qeverisjes nga një pushtet okupues që mund të quhej si më i moderuar. Në qershor të vitit 1916 kur u vendos vija e demarkacionit midis dy aleatëve pushtues të këtyre viseve, nën pushtetin Austro-Hungarez kishin mbetur: Mitrovica, Vushtrria, Serbica, Istogu, Peja dhe Gjakova. Edhe këto vise të Kosovës ishin ndarë në dy pjesë të quajtura guvernemane gjenerale ushtarake. Pjesa e Kosovës që në periudhën 1912-1915 kishte qenë nën pushtimin e Serbisë d.m.th. Mitrovica, Vushtrria dhe Serbica hynin në kuadër të guvernemanit ushtarak për Serbi që e kishte qendrën në Beograd. Kjo njësi administrative ushtarake përfshinte 12 qarqe, në mesin e të cilave bënte pjesë edhe qarku i Mitrovicës. Pjesët tjera shqiptare të Kosovës si Vushtrria dhe Serbica ishin rrethe të cilat bënin pjesë në kuadër të rrethit të Mitrovicës.⁶⁸ Një ndarje e tillë administrative e këtyre viseve kishte qenë edhe në periudhën paraprake të okupimit serb.

⁶⁸ Limon Rushiti, vepër e cituar më parë, 185; Dr Ruzhica Guzina, *Opstina u Srbiji 1839-1918*, 455.

Pjesa tjetër e viseve të okupuara nga Austro– Hungaria ishte përfshin në kuadër të guvernemanit gjeneral ushtarak për Malin të Zi, me qendër në Cetinë. Territoret e Kosovës që përfshiheshin në këtë njësit territorial administrativ ushtarak të pushtetit okupues austro– hungarez ishin Peja, Gjakova dhe Istogu. Në aspektin e mëtejshëm administrativ ky territor ishte i ngjashëm me atë të kohës së sundimit paraparak të Malit të Zi në këto vise. Peja ishte caktuar përsëri qendër e qarkut, në kuadër të të cilit hynin këto rrethe: Gjakova, Istogu dhe Rozhaja dhe Berani (Ivangradi). Pas kësaj date u benë disa ndryshime të vogla territoriale.⁶⁹

Në krye të njësiteve administrative ushtarake të quajtura guvenemane qëndronin guvenemanet gjeneral ushtarak, të cilët i nënshtroheshin drejtpërdrejt komandës supreme ushtarake të monarkisë. Kjo komandë supreme kishte të drejta të pakufizuara të pushtetit ushtarak dhe civil në të gjitha vendet e pushtuara. Ndërsa në bazë të hierarkisë së pushtetit shtetëror në pozitën e dytë radhitej komisar civil shtetëror. Ndërsa në aspektin organizativ pushteti kishte strukturë identike në të gjitha guvenemanët ushtarake i cili pastaj ndahej në sektorë: për çështje ushtarake dhe civile. Këto sektore pastaj ndaheshin në referate për çështje ushtarake dhe civile. Në krye të qarkut ishte e vendosur komanda e qarkut e cila kishte pushtetin absolut administrativ dhe gjyqësor në duart e veta. Në krye të qarkut të Mitrovicës ishte i emëruar koloneli Artur Shvarc, që njëkohësisht ishte edhe komandant i forcave ushtarake të këtij qarku. Ndërsa komandant i xhandarmerisë për këtë qark ishte emëruar koloneli Vollf.⁷⁰ Rregullimi i nivelit më të ulët admi-

⁶⁹ Dr. Novica Rakocevic, *Crna Gora u Prvom Svetskom Ratu 1914- 1918*, Cetinje 1969, 236.

⁷⁰ *Mitrovica me rrethinë* (monografi), Mitrovicë 1980, 100.

nistrativ kishte mbetur i njëjtë me atë të viteve 1912– 1915 të periudhës së pushtetit okupues paraprak. Dallimi ishte i madh porsa i përket personelit që i kryente punët në këto organe të pushtetit. Përderisa në kohën e okupimit serbo e malazez si dhe më vonë, në zonën e okupimit bullgar në shumicë edhe këto funksione i kryenin përfaqësuesit e komuniteteve që i përkisnin pushtetit okupues (serb e malazez dhe bullgar) tani ato i kryenin përfaqësuesit e popullatës vendase, që ishin kryesisht shqiptar. Popullatës vendase iu dhanë edhe disa liri dhe të drejta elementare njerëzore dhe kulturo arsimore. Këto u mirëpritën sidomos nga popullata shqiptare, të cilës deri me tani të gjithë pushtuesit ua kishin ndaluar si shkollimin dhe administratën në gjuhë amtare, përdorimin dhe shpalosjen e simboleve kombëtare etj.

Në anën tjetër edhe austro– hungarezet si pushtues, kishin ndërmarr veprime dhe masa të rrepta represive ndaj popullatës vendase. Në plan të parë ishte ndërmarr masa për çarmatimin e popullsisë, me qëllim të pengimit të rezistencës ndaj pushtetit okupues. Kështu komandanti i forcave ushtarake, Konrad fon Hencedorf, në mars të vitit 1916 lajmëronte komandën ushtarake se ishte duke bër çarmatimin e popullsisë, kurse me vonë ai kishte dhënë urdhrin që: “Qetësia dhe siguria duhet pa tjetër të ruhen, nëse është nevoja me masat më të rrepta”,⁷¹ urdhër ky që përfundonte me kërcënim, se me gjak do ta paguaj secili që tenton t’u kundërvihet organeve të pushtetit të monarkisë. Ashtu si pushteti okupues bullgar edhe pushteti austro– hungarez të gjithë ata që kapeshin në grupet apo njësitet e armatosura duke bër rezistencë internoheshin në kampet e ndryshme të ndalimit në Austri dhe në Hungari. Kështu

⁷¹ Limon Rushiti vepër e cituar, 187; Dimitrije Gjorgjeviq, *Austro- Bulgarski rezhim*, 215.

në telegramin e datës 03. VII. 1916 në kam,pet e internimit në Hungari u dërguan 103 qytetar serb e shqiptar nga Peja.⁷² Këso të dhënash mund të hasen në shumë dokumente të proveniencës Austriake, Hungareze dhe Bullgare gjatë zhvillimeve të këtyre viteve të kësaj lufte. Përveç masës të internimit të individëve, pushtetarët austro– hungarez aplikonin edhe masën e marrjes peng të familjareve të luftëtarëve të rezistencës kombëtare. Këto familje për një kohë të caktuar mbaheshin nëpër burgje, ku i nënshtroheshin formave të shumta të presioneve derisa nuk dorëzohej personi i kërkuar, e nëse ndodhte të mos dorëzohej i kërkuari, atëherë ajo familje internohej ose dërgohej në punë të detyrueshme që zakonisht ishin shumë të rënda. Kjo dukuri në Kosovë gjatë kësaj lufte ishte shumë e përhapur. Punohej kryesisht në mirëmbajtjen e rrugëve, për hapjen e rrugëve të reja për nevoja ushtarake, në mirëmbajtjen e hekurudhave, prerjen e maleve të cilat pushteti okupues i shfrytëzonte për nevojat e veta si dhe për gjatë rrugëve të sigurohej nga sulmet e befasishme të qetave kaçake. Pushteti austro–hungarez bënte gjithashtu edhe konfiskimin e tokës dhe të gjithë pasurisë së njerëzve të cilët i kundërviheshin, pastaj bënte rekuizimin e të lashtave dhe të gjitha të mirave të tjera, të cilat pasi merreshin dërgoheshin në qendrat e ndryshme të shtetit të tyre ku përpunoheshin dhe shfrytëzoheshin për qëllime e nevoja të ndryshme. Kjo në vija të trasha ishte gjendja në Kosovë dhe në viset e tjera shqiptare gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore.

⁷² Po aty, 188.

PJESËMARRJA E SHQIPTARËVE NË LUFTËN E ÇANAKALASË (24 prill – 8 gusht 1915)

Më 8 gusht 2014 u mbushën plotë 99 vjet të Betejës së përgjakshme të Çanakalasë, në mes dy ushtrive jo të barabartë në numër dhe armatime, në njërën anë armata e bashkuar të Antantës (anglezë, zelandezë, australianë, etj), në anën tjetër Divizioni 19 i ushtrisë turke i përbërë kryesisht nga shqiptarët e Rumelisë, të mobilizuar shumica me dëshirë e pjesërisht me forcë, nën komandën e Mustafa Qemalit.

Rreth betejës së Çanakalës deri tani nuk është shkruar. Përrjashtim bëjnë vetëm: Prof. Dr. Gazmend Shpuza⁷³, Dr. Ibrahim Krosi⁷⁴, Nexhip Allpari⁷⁵, Kopi Kyçyku⁷⁶, Patrik Konrosi⁷⁷, H. Amstreng⁷⁸, e ndonjë tjetër, por në të shumtën e rasteve në formë vetëm përshkruese. I takon historiografisë shqiptare që në një të ardhme të afërt, të studijoj rrethanat e kësaj beteje dhe të ngjashme me të, që edhe ajo të zë vend në penteonin e ngjarjeve me rëndësi në vitet e Luftës së Parë

⁷³ Prof. Dr. Gazmend Shpuza, *Shqiptarët dhe Ataturku*, Tiranë, 1996.

⁷⁴ Dr. Ibrahim Krosi, *Qemal Ataturku dhe shqiptarët*, Gazeta “Flaka”, fejtton, 12 dhjetor 1998 – 11 janar 1999.

⁷⁵ Nexhip Alpar – Nesipi KoçI, *Shqiptarët në Perandorinë Osmane*, Albin, 1997, Tiranë.

⁷⁶ Kopi Kyçyku, *Mustafa Qemal Ataturku*, Tiranë, 1993.

⁷⁷ Petrick Jinross, *Ataturku – Rilindja e një kombi*, Tiranë, 2003.

⁷⁸ H.C. Armstrong, *Ujku i murrme, Jeta dhe vepra e Mustafa Qemal Ataturkut*, Tiranë, 2007.

Botërore, ku edhe shqiptarët e këtyre anëve e dhan kontributin me pjesëmarrjen e tyre me pushkë në dorë.

Ngushtica e Dardanelëve, është kanali i hollë dhe i gjatë detare, që ndan Evropën prej Azisë së Vogël, e cila ka histori mijëvjeçare e mbushur me plotë mite e legjenda. Në këtë ngushticë shtrihen gjithashtu edhe brigjet e Gadishullit të Galibolusit në anën e Evropës dhe asaj të Peninsulës në pjesën aziatike, nga më të lashtat deri në kohërat më të reja. Këtu është Troja legjendare (Lufta e Trojës rreth viteve 1235–1225 p.e.s.⁷⁹, në mes akejve helenë dhe trojanëve dhe aleatëve të saj, pajonëve, dardanëve, etj. Për këtë rajon gjeo–strategjik ndër shekuj u thurën mite dhe legjenda që flasin për një periudhë të gjatë rreth 3.500 vjeçare.

Këtëj kanë kaluar persianët në fund të shek. VI p.e.s. e në fillim të she. V p.e.s. Leka i Madh prej këtu filloi fushatën ushtarake pushtuese në vitin 334 p.e.s. Këto vise i pushtuan romakët në shek. II p.e.s. dhe pas ndarjes së Perandorisë Romake në vitin 395 të e.s. nga Perandori Teodosi I, hyri në përbërje të Perandorisë Bizantine. Më vonë në shek. XV, në këtë vend, ku, Sulltan Mehmeti II – Fatihu, themeloi qytetin e Çanakales, ku në vitin 1915 Mustafa Qemali, Komandant i Divizionit 19 të Armatës së Turqisë arriti një fitore të shkëlqyeshme, kundër armatave të Antantës⁸⁰ dhe prej këtu filloi karrierën e tij të shkëlqyer e të pasur ushtarake dhe më vonë atë shtetërore. Duke pasur sukses të plotë në Betejën e Çana-

⁷⁹ Prof. Dr. Nebi Dervishi, *Pjesëmarrja e Shqiptarëve në betejën e Çanakales*, fehton, në gazetën “Fakti”, Shkup, 25-26.08.2010, Shkup, faqe 14 e 15; Dr. Petar Lisiçar, Grci I Rimjani, Zagreb, 1971; Dr. Shaban Dervishi, *Historia e Greqisë*, Tiranë, 2002, f. 172-174.

⁸⁰ Проф. д-р Јусуф Хамзаоглу, *Генијален воен стратег и реформатор* - “Вечер“, 26-27 мај 2001 год.

kales, më vonë bëhet edhe reformues më i madh i Turqisë dhe e mori emrin Ataturk (Babai i Turqisë).⁸¹

Divizioni i 19 i Armatës së Turqisë në Betejën e Çanakalasë komanduar nga Mustafa Qemali, sipas dëshmive të studiuesve dhe historianëve, përbëhej kryesisht nga shqiptarët.⁸²

Në kujtesën tonë, Beteja e Çanakalasë, ndër vite nëpër dasma dhe ndeje të rastit, këndohen këngë thurur me mjeshtri nga rapsodi popullor mbi këtë betejë, ku në mes tjerash thuhej:

*“Në mes Çanakales me plot shelgje...
Ka dalë Qemal Pasha, ushtrinë e ka mbledhur”.*⁸³

S’ka pikë dyshimi se është njëra ndër këngët e shumta thurur nga rapsodi popullor me tematikë luftarake, dhe për ne shqiptarët shumë e preferuar. Më në fund, ne i kemi një mori këngësh të tilla folklorike dhe të traditës sonë historike. Fillimi i Luftës së Parë Botërore, Fuqitë e Mëdha e nisën për qëllimet e veta për t’i zgjeruar kufijtë e tyre apo për pushtimin e tokave të reja. Këtë e bënë si Anglia, Franca, Italia e Rusia⁸⁴, ashtu edhe Gjermania e A–H., ndërkaq Turqia ishte aleate e dy fuqive të fundit (Gjermanisë e Austro–Hungarisë)⁸⁵.

Fillimi i Luftës së Parë Botërore, Mustafa Qemalin e gjeti atashë ushtarak në Sofje. Në këtë kohë Turqia si aleate e Gjer-

⁸¹ Mustafa Kemal – Ataturku- lider historik i Turqisë, gazeta “Koha”, 28 shkurt 2008, faqe 14, Shkup.

⁸² Dr. Ibrahim Krosi, *Qemal Ataturku dhe shqiptarët*, Gazeta ”Flaka”, fejton 12 dhjetor 1998 – 11 janar 1999.

⁸³ Qamil Dervishi (1902-1968), Kujtime – evokime, dhënë autorit, 1967.

⁸⁴ Dr. Petrika Thëngjilli, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë, 1997, f. 252; Abaz Mullai, *Historia e Ballkanit*, shek. XIX – 1918, Tiranë, 2008, f. 273 -274.

⁸⁵ Po aty, f. 253.

manisë e Austro-Hungarisë, hyri në luftë më 2 shtator 1914⁸⁶, ndërsa Mustafa Qemali, e ndiqte situatën me vëmendje ngjarjet e luftës në fronte të ndryshme. Pikërisht për këtë Qemali kërkonte me këmbëngulje të merrte pjesë në luftë, kurse përgjigja nga Porta e Lartë ishte negative. Kjo e detyroi Mustafa Qemalin që të bëjë kërkesë me ndërhyrjen e shokëve në Ministrinë e Luftës për të plotësuar dëshirën. Më në fund e emëruan në Shtabin Divizionit të 19 të sapoformuar të Armatës turke e stacionuar në Tekirdaj, në Rumelinë Lindore. Lajmin e shumëpritur Mustafa Qemali e mori më 02.02.1915, dhe brenda një kohe të shkurtër u kthye në një divizion me një forcë që do të ishte goditëse dhe do të luante rol të dorës së parë në Çanakale, e përbërë kryesisht nga shqiptarë të mobilizuar pjesërisht me forcë, që kishin migruar në Turqi pas Luftës së Parë Ballkanike 1912–1913, të cilët do të sulmonin ushtrinë e Antantës (anglezë, francezë, australiane, zelandezë, haitjane, etj) në agimin e 25 prillit 1915, e pozicionuar me 16 divizione në grykën e Dardaneleve⁸⁷.

Mustafa Qemali iu besua Divizioni i 19 i Armatës turke për ta komanduar, e cila u vendos në pjesën Jugore të Siujdhesës së Galipolit, prej nga dëshironte të hynte në Galipol. Krerët e xhonturqve në Stamboll kishin për qëllim ta hiqnin nga kjo detyrë Mustafa Qemalin, sepse ky vendi kishte pozitë tepër të

⁸⁶ Kopi Kyçyku, *Mustafa Qemal Ataturku – Themelues i Turqisë moderne*, Gazeta “Flaka”, Fejton dt. 18 qershor – 6 korrik 2001; Feroz Ahmet, *Qemal Ataturku dhe themelimi i Turqisë maqedonase*, Tiranë, 2010, f. 21-22; Ahmet Kasikçi, *Dedim*; Zaman Durdu – *Delibolu, Gelibolu Yari-madasi Gezi Rehberi*, Izmir, 2003.

⁸⁷ Д-р Драги П. Михајловиќ, *Привреда совреме на Турске*, Београд, 1937, стр.1. Robert Mautranit, *Historia e Perandorisë Osmane*, Tiranë, 2004, faqe 574. М. Световски, *Аматуркова Турска*, Београд, 1938, стр. 67-70.

rëndësishme gjeo-politike e ushtarake. Por, ky qëndrim i turqve të ri, ndeshi në kundërshtimin e ushtarëve, të cilët një zëri i thanë “JO” – sepse Komandanti i tyre ishte i shkëlqyer dhe trim. Nga ky përcaktim, turqit e ri u detyruan të tërhiqen, sepse ishin të gabuar në qëndrimet e tyre minuese e joparimore. Mustafa Qemali që ishte i prirur për luftë dhe njohës i mirë i atyre vendeve, nuk ia ndante sytë asaj ngushtice që ishte e gjatë dhe e gjerë dhe përfshinte tokat e Rumelisë përrëndimore dhe shkonte paralelisht me bregdetin e Anadollisë. Para syve të Qemalit shihej qytetit i bukur i Çanakalasë, dhe në jug të saj shtriheshin rrënojat e Trojës së famshme, vend poashtu strategjik, vend ky ku armiqtë (trupat e Antantës) mund të vendoseshin aty. Dhe nuk vonoi shumë komanda e ushtarëve të Antantës nisi zbarkimin e trupave të tyre dhe po ecnin në thellësi dhe sa për ç’orientuar turqit u vendosën në Anaburun dhe në Çanuk Bair, me qëllim që të mos dinin destinacionin (qëllimin) e tyre kryesor.⁸⁸

Për këtë do t’i jep urdhër të tre divizionet turke të mos hynë në betejë pa mos vendosur ai, përball 16 divizioneve të Antantës⁸⁹. Nga ana tjetër, Mustafa Qemali, duke qenë një strateg ushtarak i spikatur, shumë më i gjindshëm dhe i shkathtë se gjenerali gjerman Liman Fon, gjykoj se goditja kryesore e ushtrive të Antantës do të përqendrohej në Çanak Belin, dhe papritur forcat e veta i futi në betejë. Kjo betejë që e tmerrshme gjatë tërë natës, deri në mëngjesin e ditës tjetër, kur forcat e Antantës u detyruan të kthehen në pozicionet fillestare⁹⁰.

⁸⁸ Kopi Kyçyku, *Mustafa Qemal Ataturku*, Tiranë, 1993, f. 25.

⁸⁹ Patrick Kinross, *Ataturku – Rilindja e një kombi*, Tiranë, 2003, f. 66-67.

⁹⁰ H.C. Armstrong, *Ujku i murrme, Jeta dhe vepra e Mustafa Qemal Ataturku*, Tiranë, 2007, f. 80-81.

Fitorja në këtë betejë e inkurajoi Mustafa Qemalin, i cili edhe personalisht u bind se ka vepruar drejtë. Nga kjo disfatë e madhe e ushtrisë së Antantës, ato në vazhdim bënë përpjekje dhe u përgatitën për një sulm të ri. Nga ana tjetër ushtria turke, nën komandën e Mustafa Qemalit, po merrte guximin më të madh, duke parë, gjithmonë fitoren sa më të afërt dhe simpatia ndaj strategut Mustafa sa vinte e shtohet nga ushtarët e tij. Komanda ushtarake e Antantës duke e humbur këtë betejë, nisi një organizim të ri për një luftë dhe fitore. Kështu më 7 gusht të vitit 1915⁹¹, komanda e ushtrisë aleate vendosen pa humbur kohë që ta pushtojnë Galipolin, dhe menjëherë edhe vet Stambollin dhe vendet tjera strategjike. Për këto kishte njohuri edhe Mustafa Qemali, i cili pa humbur kohë ndërmer masat për të forcuar pozicionet. Të dy palët kundërshtarë kishin një objektiv të përbashkët, dhe atë, për të zotëruar dy pozicionet kryesore, pra dy fshatrat që kishin një emër *Anafarta*, sepse kush arrinte që të merrte këto dy vende strategjike e kishte të sigurt fatin e fitores së luftës në vazhdim. Komanda e ushtrisë së Antantës i freskonte dhe i forconte trupat e veta, duke sjellë forca të reja dhe të freskuara, e sidomos material luftëtarëve përmes rrugës detare me anijet e tyre.

Armata turke e dislokuan në këtë rajon nuk mund të lëvizte nga istikamet e veta, sepse armikun me mortaja pandërprerë gjuante me predha pozicionet. Mustafa Qemali i kishte urdhëruar ushtarët turq të mos dilnin nga istikamet për të ndërmarrë ndonjë sulm eventual. Nga ana tjetër ai, personalisht shkonte nga istikami në istikam, për të koordinuar me oficerët e ushtarët si dhe për të ngritur moralin e tyre me fjalët: “*Ne luftoj-*

⁹¹ Dagobert Von Mikusch, *Mustafa Qemal Atatürku themelues i Turqisë së re*, Tiranë, 2007, faqe 112; Patrick Kinriss, *Ataturku*, vepër e cituar, f. 68-69.

*më për vatan, për prindërit, për fëmijët dhe për vëllezërit tonë, dhe se lufta jonë është e drejtë dhe Zoti me na ndihmu, ndërsa armiqet as Zoti nuk i do, sepse ato luftojnë në një tokë të huaj. Ato nuk kanë moral lufte. Ushtarët e tyre janë mobilizuar me dhunë, pa dëshirën e tyre dhe se fitorja është qindtë për qindtë e jona. Pra unë do të nis i pari sulmin. Në momentin kur unë do të shkrepi me pistoletë, ju të gjithë sikur me qenë një trup i vetëm do të hidheni në pozicione e armikut*⁹². Dhe nuk vonoi shumë. Mustafa Qemali del nga istikamet dhe pasi bën disa hapa përpara nxjerrë pistoletën dhe gjuan në ajër dhe në të njëjtën kohë bërtet me të madhe: „*Përpara pas meje*“⁹³. Të gjithë ushtarët dhe eprorët e tyre nisën drejt armikut, të cilët u frikësuan aq tepër dhe pa humbur kohë nisën të tërhiqen në panik pa urdhër.

Një javë pas humbjes së Çanak Bair, z.Jan Hamilton (Komandant i armatës së Antantës në Galipol) ishte lidhur me Kitçener, ministrin e Luftës, duke lajmëruar dështimin e tij në Dardanele. Jo vetëm që turqit tani ishin superior nga numri dhe nga rezervat, por ato kishin fituar epërsinë morale ndaj trupave të rinj. Ndërsa befasia tani do të mungonte, ai do të kishte nevojë për një 100 mijë ushtarë të tjerë për të rifilluar sulmin. “*Ne jemi ngritur kundër Armatës kryesore turke*” përfundoi ai, “*që po lufton me trimëri dhe është e komanduar mirë*”⁹⁴.

Në betejat për Galipolin, Mustafa Qemali në mënyrë të përkryer kishte shfrytëzuar befasinë, terrenin dhe njohjen e ushtarit turk.

⁹² Patrick Kinross, Ataturku – rilindja e një kombi, Tiranë, 1999, faqe 70-71; Kopi Kyçyku, Mustafa Qemal Ataturku, Tiranë, 1993, f. 26

⁹³ Po aty.

⁹⁴ H.C. Armstrong, Ujku I murrme, Jeta dhe vepra e Mustafa Qemal Ataturku, f.91-93.

Vite më vonë, për këto luftëra, një historian zyrtar britanik shkruante: *“Rrallë në histori mund të ketë ndodhur që forcat ushtarake të një divizioni të vetëm të kenë ushtruar, në tre raste të ndara, kaq thellë një ndikim, jo më në rrjedhën e një beteje, por ndoshta në fatin e një fushate, dhe madje edhe në fatin e një kombi”*⁹⁵. Në këtë mënyrë pas luftërave të pandërprera, në 19 dhjetor 1915 forcat e Antantës u larguan tërësisht prej Çanakalasë, duke humbur rreth 253.000 ushtarë⁹⁶.

Drejtori i Muzeut në Çanakale, në 2012, me rastin e një studimi të rastit, na njoftoi shkurtimisht me Betejën Çanakalesë, në të cilën gjetën vdekjen ose janë vrarë afro 500 mijë njerëz⁹⁷. Ai në vazhdim shtoi se është kryer një punë e madhe me formimin e Muzeut, sepse këtu janë mbledhur dhe ruhen fakte për këtë betejë, me qëllimin që të respektojmë dëshmorët dhe të gjithë ata që luftuan aty, njëkohësisht të bëjmë me dije njerëzimit se çfarë pasojash tragjike sjellin luftërat, të cilët dëshiroi ai, kurrë të mos përsëriten. Gjatë gjithë asaj pasdite që na shoqëronte, na njoftoi në detaje lidhur me Betejën e lavdishme të Çanakalasë. Duke ecur aleave të varrezave të ushtarëve të rënë, përndryshe jashtëzakonisht të rregulluara dhe të mirëmbajtura, shpesh në gurët e tyre lexonin edhe emrat e qyteteve: Manastir, Ishyp, Ipek, Prizren, Ohri, Vlorë, Elbasan, Kumanova, Presheva, Gjakova, etj.

Duhet theksuar edhe një fakt i rrallë: gati të gjithë shqiptarët e rënë në këtë betejë, kanë qenë të moshës shumë të re. Nuk mund që të mos pyetemi në vete se si u gjetën një, numër i

⁹⁵ Po aty.

⁹⁶ Kopi Kyçyku, *Mustafa Qemal Ataturku*, Tiranë, f.26; Prof. Dr. Petrika Thëngjilli, *Perandoria Osmane*, Tiranë, 1997, f. 253.

⁹⁷ Po aty. Ahmet KasikçI, *Gelibolu, Dedim*; Zaman Durdu, *Gelibolu Yari-madasi Gezi Rehberi*, Izmir, 2003.

madh shqiptarësh në këtë betejë, duke pasur parasysh faktin se ajo u zhvillua në vitet 1915, kurse Turqia tanimë pothuajse ishte tërhequr nga Ballkani, pas Luftës së Parë Ballkanike.⁹⁸

E gjithë kjo nuk mund të na lejoj indiferentë, flet se historia dhe kultura jonë sa është e pasur dhe e lavdishme aq është edhe e dhimbshme dhe tragjike.

Duke pasur vëmendjen ashtu te mbishkrimet e varreve, në një moment me zë të ulët i them cicerones, se nga një numër i madh të rënë në këtë betejë kemi të drejtë të themi, se ajo është edhe e jona, kurse ciceronia, duke pohuar me kokë se keni të drejtë dhe shtoi se edhe vetë Ataturku e ka verifikuar pjesëmarrjen e popullit shqiptar në këtë betejë⁹⁹.

Është për të theksuar se varrezat, pothuaj pushonin në lloj-lloj lulesh, ku dominojnë karafilat e kuq. Kolonat e gjata të vizitorëve bëjnë homazhe ushtarëve të rënë të Aleancës të Antantës dhe te atyre të vendit. Kjo padyshim e prish qetësinë e amshueshme të atij lokaliteti dhe krijon një gjallëri nga vizitorët e të gjithë vendeve të botës, pëshpëritjet, komentimet, fotografimet, etj.

Në mënyrë të veçantë na bën përshtypje portreti i derdhur në bronzë i një ushtari turk, i cili po i ndihmon ushtarit kundërshtar të plagosur, për t'ia shpëtuar jetën. Kjo të përkuqton ndjenjën humane se edhe në çastet ku je ballafaquar me armikun duhet të sillet si njeri¹⁰⁰.

⁹⁸ Dr. Rustem Buzhala, *Shqiptarët në Turqi*, Prishtinë, 2011, f. 48-49; *Historia e popullit shqiptar, II*, Tiranë, 2002. Dr. Nebi Dervishi, *Lufta e Çanakales*, "Flaka", 20-23-24 gusht, 2010.

⁹⁹ Dr. Nebi Dervishi, *Lufta e Çanakales*, Gazeta "Fakti", fejton dt. 23-24 gusht 2010.

¹⁰⁰ Ahmet Kasikçi, *Gelibolu....*, Iemir, 2004; Naser Selimi, *Beteja e Çanakalasë*, në "Flaka", 1995.

Pasi përfunduan vizitën në Parkun Kombëtar dhe në Muzeun në orët e vona të natës e morëm rrugën e kthimit, të mbushur plot emocione për këtë betejë, të ndodhur afër një shekull më parë.

Ky punim është një homazh për të gjithë ato shqiptarë që u mobilizuan, shumica me forcë dhe ranë në fushë të nderit në Betejën e Çanakalasë, që bënë pjesë në divizionin 19 të Armatës Turke që komandohej nga Mustafa Qemali, me rastin e 99 vjetorit të kësaj Beteje!

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

SHQIPTARËT DHE TROJET E TYRE NË PROPAGANDËN SERBE GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Fillimi i Luftës së Parë Botërore (28 qershor 1914), i gjeti shqiptarët në luftë me qeveritë ekspansioniste të shteteve fqinje, të cilët gjatë Luftërave Ballkanike (1912–1913) pushtuan pjesë të tokave shqiptare, të Shqipërisë etnike. Këto shtete nuk njohën pavarësinë e Shqipërisë, madje as kufijtë e saj të cunguar në Konferencën e Londrës, e cila jashtë shtetit shqiptar, la siç dihet, padrejtësisht, mbi gjysmën e territorit dhe popullit shqiptar. Tani, këto shtete në rrethana të reja të Luftës së Parë Botërore që po fillonte, duke u pozicionuar në krah të Antantës (Rusisë, Francës dhe Anglisë), kundër Fuqive Qendrore (Gjermanisë, Austro–Hungarisë dhe Italisë), vazhduan planet e vjetra për pushtimin e tërësishëm të tokave shqiptare. Duke i konsideruar si punë të kryer, si vende të tyre, tokat shqiptare të pushtuara në Luftërat Ballkanike, tani ia mësnyë Shqipërisë.

Siç dihet nga historia, Mali i Zi synonte ta marrë Shkodrën me veri, jugun Greqia, ndërsa Shqipërisë e mesme me Durrësin, Serbia. Kështu, Serbia do të krijonte dalje në det, në Detin Adriatik dhe do ta realizonte ëndrrën e vjetër e cila ishte edhe synim i Rusisë, për të cilin shumë herë ishin deklaruar edhe udhëheqësit e saj. Kuptohet, në këto plane pushtuese gjithsesi kishte gisht edhe ajo, e cila sëbashku me Francën,

ishin ideator dhe përkrahës kryesor të krijimit dhe zgjerimit të këtyre shteteve ballkanike, kuptohet edhe të Serbisë, madje edhe të Serbisë së Madhe. Plan—projektin për krijimin e Serbisë së Madhe, të njohur ndryshe edhe si “*Projekti nacional serb*”, gjithnjë në dëm të fqinjëve, e sidomos të shqiptarëve, e kishte hartuar qeveria serbe, me dijetarë, duke përfshirë aty edhe disa shkencëtarë, përkatësisht pseudoshkencëtarë.

Lidhur me këtë që cekëm më lartë, ajo që është me interes për këtë punim, është shpjegimi dhe konstatimi i qëndrimit të këtyre qeverive ekspansioniste të shteteve fqinje, më saktë i qeverisë dhe përfaqësuesve të shkencëtarëve të Serbisë në propagandimin shkencor – pseudoshkencor të çështjes shqiptare pranë opinionit dhe kancelarive të mëdha evropiane e botërore.

Kjo çështje me interes për historinë tonë, duke e njohur kompleksitetin e marrëdhënieve shqiptaro—serbe gjatë historisë, nuk është shqyrtuar sa duhet nga historiografia shqiptare deri tani, përpos ndonjë punimi kalimthi, megjithatë historisë i intereson t’i studiojë të gjitha ngjarjet pa përjashtim dhe ta thotë të vërtetën për ato.

Shikuar historikisht, Serbia, qeveritë e saj, asnjëherë nuk i kanë shikuar me sy të mirë shqiptarët në trojet e tyre etnike, dhe përherë kanë synuar aneksimin apo thënë më drejtë, pushtimin e tyre. Kështu ka vepruar edhe qeveria serbe e Nikolla Pashiqit* gjatë Luftës së Parë Botërore, madje edhe para e pas saj.

*Nikolla Pashiqi (1845–1926), ishte politikan dhe burrë shteti në Serbi, më vonë edhe në Mbretërinë SKS dhe Jugosllavi. Themelues (1881) dhe udhëheqës i Partisë Radikale Popullore Serbe. Me ardhjen në pushtet të Kral Petrit (1904), e deri në vdekje ishte në qeveri, kryeministër apo ministër i jashtëm. Të gjitha ngjarjet e rëndësishme në historinë serbe të kësaj kohe lidhen me emrin e tij. Është pjesëmarrës në formimin e Alean-

çës Ballkanike dhe besnik i përhershëm i Rusisë Cariste (Mala enciklopedija Prosvete, II, K–P, Beograd, 1978, 786).

Pashiqi aftësitë e veta politike e diplomatike, si burrështeti, i shihte në realizimin e “*Projektit nacional serb*”, i cili qe edhe projekt i qeverisë së tij, për krijimin e Serbisë së Madhe. Ky projekt, që synonte “*të gjithë serbët në një shtet*”, me dalje në det, në Detin Adriatik, duhej të zgjohej në tokat e shteteve fqinje e sidomos të shqiptarëve, në rastin konkret të Shqipërisë. Si i tillë i gjithë ky projekt ekspansionist, shovinist, dhe deri në fund ekstrem dhe primitiv, duhej të propagandohej si i drejtë, dhe të bindej bota se Serbia “*historikisht e kishte të drejtën e aneksimit*”.

Për realizimin e këtij projekti, formimin e shtetit të përbashkët serb, në kushtet e luftës, nuk mjaftonte vetëm fitorja në luftë, por edhe propaganda, pra propagandimi i këtij plani brenda dhe jashtë vendit, detyrë delikate të cilën Pashiqi ia besoi disa shkencëtarëve, disa pseudoshkencëtarëve serbë. Në këto detyra me urdhër të qeverisë apo me dëshirën e tyre u angazhua një numër i madh i dijetarëve, pseudoshkencëtarëve serb, të cilët kryesisht punuan në këto tre drejtime:

1. Në nevojën e bashkimit të gjithë serbëve,
2. Në hartimin e projektit luftarak, dhe
3. Në qëllimin dhe kërkesat e Serbisë, në këtë luftë.

Ky aktivitet i gjithëmbarshtëm propagandues zhvillohet në forma të ndryshme, ku para së gjithash bënin pjesë: misionet propaganduese—politike, veprimtaritë botuese dhe ligjëratat e shkencëtarëve në auditoriume dhe universitete të shteteve anëtare të Antantës (Francës, Britanisë së Madhe dhe Rusisë).¹⁰¹

¹⁰¹.Stefanaq Pollo,Në gjurmë të historisë shqiptare,1,Tiranë,1990,10-70. “Gllas Crnogoraca” nr.10,2.03.1913. “Radničke novine” Peograd, 22.10.1913 (Krvna osveta soldateske). Iz Albanskih pisma. Muin Çami,

Qeveria serbe menjëherë pas fillimit të luftës (LPB-së), dërgoi grupe shkencëtarësh te Fuqitë e Antantës, madje edhe te ato shtete që ende nuk ishin anëtare të saj, si Italia, Rumunia dhe Bullgaria, për të bërë propagandë për gjoja të “drejtën historike” të Serbisë në këto territore, e sidomos të Shqipërisë Veriore.

Në “shkencën” e Kralave të Serbisë, temë e preferuar e përhershme ka qenë çështja shqiptare dhe territori i Shqipërisë Etnike, e cila përpiquej që planet dhe aksionet konkrete të hegjemonistëve serbomëdhenj, t’i arsyetojë me argumente historike, etnike, etj. etj., të trilluara, të shtrembëruara, më qartë me thënë – të rreme. Sipas saj, shqiptarët si popull i vogël në Ballkan, i pa arsimuar dhe i pa organizuar sa duhet, mund të bëhej, preja më e lehtë e një politike të tillë robëruese.¹⁰²

Duke u bazuar në këtë, sipas burimeve të vërtetuara mirë, në vitet e para të luftës, me urdhrin dhe shpenzimet e qeverisë së Nikolla Pashiqit u nisën 28 veta, shkenctar, në misionet propaganduese pseudoshkencore.¹⁰³

Shqipëria në marrëdhëniet ndërkombëtare (1914-1918), Tiranë, 1987, 80-85. Dr. Bogomil Hrabak, *Elaborat srbskog ministarstva inostranih della o pripremama serbske okupacije Severne Allbanije 1915 godine* “Vjetari i Arkivit të Kosovës” II-III, 1970, 8-35. DACCIP, PO, 1916-17, k.9-10. Gazmend Riza, Çështja e kufijëve shqiptar në Konferencën e Ambasadorëve në Londër 1912-1913 “Gjurmime Albanologjike” SSHH, 25-1995, 150-155. Halim Purellku, *Reprezaljet e pushtetit seb ndaj shqiptarëve të Maqedonisë së sotme (1912-1915)* “Jehona” nr.4, Shkup, 1992, 107-143. Arben Puto, *Pavarsia e Shqipërisë dhe diplomacia e Fuqive të Mëdha 1912-1914*, Tiranë, 1978, 140-145. Jovan Cvijiq, *Ballkansko polluostrvo o juzhno sllovske zemlje-Osnovne antropogeografije*, Beograd 1966, 240-250, 340-350, 440-500. Sreten Martinović, *Qëndrimi i ushtrisë serbe ndaj shqiptarëve* “Gjurmime Albanologjike” SSHH, 7/1977, 245-250.

¹⁰². Prof. Dr. Mark Krasniqi, *Trajtimi i shqiptarëve në veprat e Jovan Cvijiqit*, “Kultura Popullore”, 1-2, Prishtinë, 1992, 50-65.

¹⁰³. Lubinka Trgovčević, *Naučnici Srbije i stvaranje jugosllavenske drzhave 1914-1920*, Beograd, 1986, 30-35.

Jovan Cvijiqi, të cilin qeveria serbe dhe qarqet intelektuale si brenda ashtu edhe jashtë vendit, e njihnin si dijetar me vlera të mëdha, veç tjerash edhe për “kontributin e madh” që kishte dhënë duke mohuar autoktoninë e shqiptarëve në Kosovë, në Maqedoni dhe në troje tjera shqiptare, udhëtoi në Londër. Ky, para se të arrij atje, u ndal në Paris, ku kishte përkrahje të madhe, ku botoi një artikull në revistën “*Revue hebdomadaire*”, për bashkimin e shteteve ballkanike në një shtet, që do të quhej Jugosllavi (brenda së cilës do të qëndronte Serbia e Madhe). Në Londër ai u takua me njerëz që e përkrahnin Serbinë, politikën e saj, si: Siton, Votson, Stidon dhe Artur Evans, të cilëve u foli për atë Serbi të Madhe, dhe të “drejtën e saj historike” në Adriatikun Jugor, ku shtriheshin tokat shqiptare. Madje ky, ministrit të punëve të jashtme ia dha edhe një hartë—projekt, përkujtues, sipas të cilit Serbia, kishte të drejtë të pushtonte territore të Banatit dhe Shqipërisë, sa i duheshin asaj. Ky ishte edhe përpilues i teorisë ekspansioniste serbe në Maqedoni, ku në këtë mision propagandistik, paraqiti aspiratat territoriale të Serbisë duke treguar edhe atë, se sa është i rëndësishëm strategjikisht Selaniku për Serbinë, po qe se i jepej asaj. Në fakt aty, e gjente edhe bërthamën e Serbisë së Madhe, e cila mund të ishte pikë përqendrimi e një shteti të madh ballkanik.

Nga kjo ekspeditë pseudoshkencore, Cvijiqi e njoftonte Pashiqin, se: “*Në anën tonë, dominon simpatia e popullit dhe diplomacia angleze, mirëpo këtu disa popuj të jugut të Serbisë së Vjetër (aludonte në shqiptarët, N.H), i kanë miqtë e fortë*”¹⁰⁴

Në atë kohë Pashiqi, për qëllime propagandistike—pseudoshkencore për në Rusi (Petrovgrad), nisi Lubomir Stojanovi-

¹⁰⁴. Telegrami i Cvijiqit dërguar Nikolla Pashiqit, më 4.7.1915 nga Llon-dra; AJ 80-8-256.

qin dhe Aleksandar Beliqin, ndërsa për në Paris, Jovan Zhujoviqin. Stojanoviqi dhe Beliqi, ishin nxënës të shkollës ruse, prandaj si të tillë në meset e shkencëtarëve dhe intelektualëve rus, ishin të njohur dhe të mirëpritur. Madje Stojanoviqi ishte edhe politikan i rryer sllavofil. Duke qenë të tillë, qeveria serbe kishte besim të plotë në këta dy, për prezantimin e qëllimit dhe të aspiratave territoriale të Serbisë në qarqet ruse. Stojanoviqi para nisjes në këtë mision, kërkoi që t'i analizonte kontratat e fshehta të qeverisë serbe të lidhura me parë me atë ruse, e të nënshkruara nga Nikolla Pashiqi, me qëllim që ti harmonizonte qëndrimet, për të mos rënë ndesh me politikën zyrtare serbomadhe. Pas këtij sqarimi, arritën në Rusi ku u pritën nga ministri i Punëve të Jashtme, Sazanov, të cilit ia dorëzuan me shkrim qëndrimin—projektin e qeverisë serbe, për “*të drejtën historike territoriale të Serbisë*”, me theks të veçantë në: Srem, Baranjë, Banat, Baçkë dhe në Shqipërinë veriore. Ministri Sazanov u zotua se Rusia do të bëjë ç'mos tërë potencialen e vet diplomatik do ta shpenzojë në atë drejtim, që shteti serb në kthetrat e veta të ketë shumë territore, sepse njëkohësisht ishte edhe interesi i tyre.¹⁰⁵

Edhe misionarëve që shkuan në Francë, më saktë Zhujoviqit, ministri i Punëve të Jashtme atje, këtij, i premtoi se: Franca energjikisht do t'i mbrojë interesat serbe, për territoret të cilat Serbia është e interesuar.¹⁰⁶

Po në këtë kohë, me detyrë nga qeveria, udhëtoi për në Itali (Venedik), Jovan Tomiqi, që t'ua shpjegojë nëpër tribuna njerëzve eminent të shkencës dhe politikës, po pse jo, të mos i dinin edhe njerëzit e thjeshtë, aspiratat territoriale të Serbisë,

¹⁰⁵. AJ,80.4-420: Biseda telefonike e Stojanoviqit dhe Beliqit me Pashiqin më 24.5.1915.

¹⁰⁶. Lubinka Trgovçiq, vep. e cit.,50-55.

si “e drejtë historike” për marrjen e bregdetit Adriatik Shqiptar, duke i njoftuar ata, se sa dobi të madhe tregtare ka edhe Italia, nëse atë e merrte Serbia. Për qëllime të njëjta serbomëdha, në Romë udhëtuan edhe Pavle Zhupaniqi, Dragolub Arangjeloviqi dhe Kosta Stanojeviqi.¹⁰⁷

Nikolla Pashiqi, më 9 maj 1915 e dërgoi në Rumuni me detyrë të veçantë edhe historianin Jovan Radoniqin, i cili kishte për detyrë qeverisë rumune t’ia përcillte arsyet dhe bindjet e diplomacisë angleze, ruse dhe franceze, për “*të drejtën historike*” të Serbisë në territoret që i kishte pushtuar ajo në Luftërat Ballkanike. Ai bisedoi edhe me ministrin e Punëve të Jashtme të Rumanisë duke ia bërë me dije se: Anglia, Franca dhe Rusia, aleatë të përbetuar të Serbisë, në të ardhmen e parashohin një Jugosllavi e cila brenda kufirit do të ketë edhe territore të Shqipërisë veriore, duke ia dorëzuar atij edhe projekt-hartën e Serbisë së Madhe, të hartuar në shkurt të vitit 1915.

Qeveria e Nikolla Pashiqit, duke e llogaritur përkrahjen materiale dhe diplomatike të SHBA-ve në LPB, përgatiti fushatë propagandistike edhe në këtë shtet, me qëllim që ta përfitoj atë, kinse Serbia duhej të bënte luftë të drejtë e të domosdoshme. Për këtë qëllim ajo nisi atje shkencëtarët: Jelena Lozaninin, Mabel Grujiqin, Niko Zhupaniqin dhe Millosh Trifunoviqin. Sipas dokumenteve të kohës dhe deklarimit të qeverisë serbe të vitit 1915, shihet se kjo ekspeditë propagandistike nuk pati sukses, pra dështoi. Arsyeja ishte se për emigracionin serb atje, për shumicën dhe njerëzit e ditur, program-projekti serb, ishte i paarsyeshëm, ishte në dëm të popujve tjerë të Ballkanit, edhe të shqiptarëve, prandaj nuk u përkrah.

¹⁰⁷. Jovan Tomiq, *Le probleme italo-sllave*, Paris, 1915, 8-48.

Nikolla Pashiqi, siç thamë më lartë, aftësitë e veta diplomatike si burrshteti, i shihte në sukseset e depërtimit të propagandës në botë për qëllimet serbomëdha, prandaj në asnjë moment nuk hoqi dorë nga veprimet propagandistike për ekspansionizmin serbosllav në Ballkan. Për këtë qëllim ai në Amerikë dërgoi edhe një grup profesorësh të Beogradit, të shoqëruar nga dy dijetarë rusomëdhenj, të cilët vetë ai, para nisjes i njoftoi me qëndrimin e qeverisë serbe, për zgjerimin territorial, për krijimin e Serbisë së Madhe, kuptohet edhe në dëm të Shqipërisë. Pashiqi ua tërhoqi vërejtjen këtyre emisarëve, që gjatë elaborimit të çështjes shqiptare, me diplomatët dhe dijetarët amerikanë, të kenë kujdes dhe të përqendrohen në dy alternativa:

1. Nëse Italia e okupon Vlorën, Serbia në tërë Shqipërinë do të vendos protektorat, dhe të kundërtën;
2. Serbia do t'i okupoj pjesët veriore të saj deri te lumi Shkumbin, ndërsa në pjesët tjera të Shqipërisë do t'i vendosë udhëheqjet fisnore lokale.¹⁰⁸

Misionet propaganduese, Qeveria serbe me një intensitet edhe më të madh, i vazhdoi gjatë viteve 1916–1918.

Kështu, Aleksander Beliqi dhe Stanoje Stanojeviqi, disa herë u ftuan dhe qëndruan në Rusi, për të krijuar një qendër të studimeve “*për njohjen e të kaluarës serbe në Gadishullin Ballkanik mbi baza të gjuhës, historisë, letërsisë, kulturës dhe etnografisë*”, duke i porositë ata Pashiqi, që të kenë kujdes në propagandimin e projektit të qeverisë serbe, lidhur me zgjerimet territoriale të Serbisë në tokat e shteteve fqinje, e

¹⁰⁸. Daut Bislimi, *Propaganda pseudoshkencore-antishqiptare e Akademisë Serbe të Shkencave në fillim të Luftës së Parë Botërore*, “Gjurmime Albanologjike”, SSHH, 22, Prishtinë, 1992, 109-119.

sidomos në Shqipërinë Veriore, në të cilën “*Serbia e kishte historikisht të drejtën e aneksimit*”.

Për qëllime të njëjta propaganduese në këtë kohë nëpër zyra të mëdha të Evropës dhe të botës, u nisën edhe: Gjorgje Stanojviqi e Mihajlo Petroviqi në Francë, Pavle Popoviqi, Branisllav Petro-nieviqi, Jova Radoniqi e Bozhidar Markoviqi në Londër, Kosta Kumadini, Zhivojin Gjorgjeviqi, Mihajlo Petroviqi e Nikolla Vuliqi në Paris dhe Gjenevë, Slobodan Jovanoviqi, Zhivojin Periqi e Jefto Dedieri në Zvicër, Milloje Vasiqi, Vlladimir Mitroviqi e Momçillo Miniqi në Romë, Velizar Mitroviqi në Korsikë, dhe Vojisllav Jovanoviqi në Uashington.¹⁰⁹

Qeveria serbe, planet e veta të luftës, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, i zhvilloi edhe nëpërmjet veprimtarisë botuese propagandistike, botimit të broshurave, revistave, gazetave, librave, etj. Pashiqi me një grup veprimtarësh, si qendra të rëndësishme për këtë veprimtari, e planifikonin Zvicrën (neutrale) dhe Rusinë (aleate). Në pranverë të vitit 1916 në Zvicër, filloi të botohet revista “*La Serbie*” në frëngjisht, “*për t’i mbrojtur interesat e shtetit serb*”, gjoja nga fqinjët, prej të cilëve në fakt kurrfarë rreziku s’kishte, përkundrazi fqinjët rrezikoheshin prej tij, sepse diplomacia serbe kishte aspirata ekspansioniste ndaj shteteve ballkanike e veçmas ndaj shqiptarëve. Kjo revistë, për qëllime propagandistike, gjatë gjithë kohës u shpërnda në zyra të mëdha të Evropës dhe në qarqe diplomatike e intelektuale të kohës. Në këtë kohë në Gjenevë filloi aktivitetin propagandues edhe “*Byroja e gazetarisë serbe*”, me Bozhidar Markoviqin si udhëheqës, e cila punoi për përfaqësimin e Serbisë së Madhe, ndaj shteteve fqinje, veçmas ndaj Shqipërisë dhe shqiptarëve.

¹⁰⁹. DACCIP, PO, 1917, k.9.

Në Paris, gazetat dhe revistat propaganduese i organizoi Gergur Jakshiqi, historian i Universitetit të Beogradit, shumë i afërt me gazetat franceze e sidomos me fletushkën “*Le Temps*”, e cila çmohej dhe ishte e afërt me sektorin e propagandës në Ministrinë e Punëve të Jashtme, e në të cilën botoheshin studime analitike mbi kulturën dhe historinë e popullit serb, sipas udhëzimeve të qarqeve politike serbe.

Cvijiqi, i njohur për punën e tij propaganduese—antishkencore për shqiptarët, ka botuar studime edhe në revistën italiane “*Scientia*”. Si pseudoshkencëtar i rryer që ishte, Nikolla Zhupaniqi në SHBA, redaktoi revistën propagandistike sllave “*Americki Serbobran*”, ku botoheshin materiale të ndryshme për këtë qëllim.

Është interesant dhe meriton të përmendet se, në këto shkrime shumë autorë nuk e tregonin emrin e tyre të vërtetë, për shkak të pavërtetave që i shkruanin, prandaj paraqiteshin me emra tjerë (pseudonime), apo këta i lutnin miqtë e tyre jashtë, që të nënshkruhen në emër të tyre.

Duke parë efektin pozitiv të çështjeve serbe nëpërmjet botimeve të posaçme, siç ishte vepra kapitale “*Sijdhesa Ballkanike*”, e Jovan Cvijiqit, Qeveria serbe, shkencëtarëve serbë ia besoi edhe botimin e historisë serbe, historinë e Maqedonisë (Tihomir Gjorgjeviqit), broshurën “*Mbi ndihmën e Anglisë shtetit serb*” – (Millan Gjuriqinit), “*Serbia nën armiqtë*” – përmbledhje dokumentesh (Bogdan Popoviqit), etj., të cilat edhe u botuan.¹¹⁰

¹¹⁰. Lubinka Trgovčević, vep. e cit. 125-130., „La Serbie, 24.9.1916. M. Jakovleviq, Iz rata i emigracije (Uspomene), Subotica, 1923, 20-25. AC, MPC, Krf. II-III: Prema pismu N. Vuliqa ministru profete od 25.7/8.8.1917. AJAZU, JO 93/29: Pismo J. Radoniqa, Trubiqu, od 4.1.1917. J. Frantigham-Lozani, Dobrotvorna mija za Srbiju u Svetskom Ratu: pisma iz Amerike i Kanade 1915-1920, Beograd, 1970, 15-20. Jovan

Ligjëratat e shkencëtarëve serb pranë kancelarive të mëdha, opinionit dhe universiteteve evropiane dhe amerikane, ishin formë tjetër e veçantë e veprimtarisë propaganduese. Me anë të këtyre ligjëratave, dijetarët serbë, shkencën e historisë, e futën në shërbim të politikës hegjemoniste të borgjezisë dhe qeverisë së Serbisë. Për tri vjet (1915–1918) në emigracion sa qenë këta shkencëtarë, profesorë të universitetit të Beogradit, dijen e tyre pseudo-shkencore, për sa i takon çështjes shqiptare ua shprehën studentëve dhe opinionistëve në vendet ku qëndruan. Kështu, A.Beliqi dhe S.Stanojeviqi mbajtën kurse në Universitetin e Petrogradit. Ky i fundit, pas kthimit nga Rusia, një kohë qëndroi në Londër, ku bisedoi dhe mbajti një kurs ligjëratash në universitetin e atjeshëm, pastaj në Paris në Universitetin e Sorbonës, ligjëroi historinë e Serbisë, sipas urdhrave të qeverisë. Këtu ligjërata mbajtën edhe T.Zhivkoviqi, B.Petroviqi, K.Komadini dhe J.Cvijiqi.

Pashiqi, duke vlerësuar se Anglia është vendi ku duhej të punohej më tepër në fushën propagandistike për aspiratat e Serbisë së Madhe, në Londër nisi për ligjërata Pavle e Bogdan Popoviqin. Popoviqi kishte për detyrë në klubet serbe dhe në kontakt me njerëzit e shkencës dhe diplomacisë angleze, po edhe me njerëz të veprimtarive tjera, ta shpreh vullnetin dhe tezën megalomane të qeverisë serbe, se Serbia, do të bisedoj me kroatët dhe slovenët për bashkimin e tyre në një shtet serb, i cili pavarësisht nga ajo, se ky shtet, kishte të drejt të quhet Jugosllavi, askush nuk do të kishte të drejtë përparësie, mbi serbët. Këtu janë edhe fillet e fushatës pseudoshkencore për formimin e Jugosllavisë së vitit 1918 në brendësinë e të cilit do të ishte mbretëria serbe. Në këto ligjërata ku morën

pjesë edhe njerëz të shquar të dijes dhe të diplomacisë angleze, Popoviqi, kishte detyrë ti bind ata, se maqedonasit nuk e kanë prejardhjen nga bullgarët dhe se territori ku jetojnë ata, është territor serb i dinastisë Nemanjiqe, i Car Dushanit, ku nuk kishte popull tjetër pos serbëve, kuptohet as shqiptarë.

Për qëllime propagandistike, për dalje të Serbisë në Detin Adriatik, nëpërmjet territorit të ashtuquajtur “*Serbi e Vjetër*”, në fakt nëpërmjet tokave shqiptare, në Paris udhëtuan: M.Novakoviqi, B.Maroviqi dhe V.Mitrovqiqi. Ata, aty në revistat “*Le Temps*”, “*Revue de Paris*”, “*Echo de Paris*”, etj., botuan disa artikuj gazetaresk në stilin informativ–propagandistik për territoret e “Serbisë së Vjetër”, për programin nacional serb dhe aspiratat serbomëdha, ndaj territorit të Shqipërisë veriore, dhe për daljen e Serbisë në det nëpërmjet Shkodrës, etj.¹¹¹

Shkencëtarët serbë, shqiptarët dhe trojet e tyre, në kuadër të Serbisë së Madhe i parapanë edhe në harta. Një hartë të tillë, paraqiti pra qeverisë dhe politikanëve e deputetëve të Serbisë, Nikolla Pashiqi, të punuar nga Jovan Cvijiqi. Cvijiqi u angazhua për përfitim të territoreve të pjesës jugore të lumit Drin, duke e arsyetuar me rëndësinë tregtare që duhej të lidhej kinse shteti i Serbisë me Evropën, dhe duke pohuar se asnjë vijë tjetër kufitare me Shqipërinë nuk do të jetë e qëndrueshme, më mirë se kjo, për shkak të numrit të madh të popullsisë shqiptare në këto anë.¹¹²

¹¹¹.DASSIP,PO,1918,K.8. Pavle Popoviq, Dnevnik, 16-29.IV.1915, 13.9.1918. MGB, J.Cvijiq: Letra 4.6.10.12.1916. AS,J.Zhujoviq, 97: Pjesë të ditarit 1872-1915. „Analet de Nationalites„Paris, maj 1915. Mark Krasniqi, Trajtimi i shqiptarëve në veprat e Jovan Cvijiqit,„Kultura popullore„, nr.1-2.Tiranë, 1992, f.50-65. Shih edhe Hamit Kokallari, Kossovo-Borceau du peuple albanais et foyer de sa renaissance nationale, Tiranë, 1943.

¹¹².Jovan Cvijiq,vep.e cit.190-195.

Sa i përket kufirit me Shqipërinë e kësaj kohe, Stojanoviqi, në hartën e tij serbe, futi edhe territoret shqiptare të dy luginave të lumit Drin dhe territorin e Shqipërisë Jugore, deri në kufirin e sotëm shqiptaro-grek.¹¹³

Edhe Jefto Dedieri bëri një hartë etnografike, në të cilën futi territore shqiptare. Ky bëri falsifikimin e popullsisë shqiptare, për rreth Shkumbinit, duke i quajt ata ortodoksë serbosllav, duke i zhvesh nga gjuha dhe doket e zakonet shqiptare. Edhe Zhupaniqi në hartën e tij, përfshiu disa territore shqiptare.

Thënë shkurtë, të gjithë pseudoshkencëtarët serbë që morën pjesë në hartimin e hartave të Serbisë së Madhe, bënë falsifikimin e përbërjes nacionale të popullsisë shqiptare në trojet tyre. Propagandë mjaft të egër në dëm të çështjes shqiptare, në këtë kohë zhvilloi edhe kisha dhe shkolla serbe.

¹¹³.Lubinka Trgovçeviq, vep.e cit. 273-275.

MEMLI KRASNIQI

Instituti Albanologjik i Prishtinës

**PËRFSHIRJA E GRUPEVE USHTARAKE
TË ESAD PASHËS NË LUFTËN
E PARË BOTËRORE
(sipas dokumenteve arkivore britanike)**

Gjatë Luftës së Parë Botërore, edhe pse teknologjia ushtarake kishte përparuar dukshëm, përsëri elementi përcaktues dominues në këtë konflikt global ishte faktori njeri. Në këtë frymë, që të dy kampet ndërluftuese, bënë përpjekje që edhe në vendbanimet e okupuara shqiptare, të mobilizojnë numër sa më të madh të mercenarëve. Paraprakisht duhet ritheksuar se hapësira ku ishte shpallur Pavarësia e Shqipërisë gjatë LPB do të konsiderohej si “No Man’s Land”, pra tokë pa të zotë. Ky qëndrim jo parimor i shteteve evropiane bazohej në faktin që popullsia shqiptare, si shumicë myslimane që ishte, nuk kishte kujtesë historike dhe vetëdije kombëtare, elemente këto karakteristike për të gjitha kombet e kontinentit të vjetër. Për më tepër, kjo popullsi e islamizuar, kishte mbrojtur deri në fund jo interesat e saja ekzistenciale, por ato të Islamit dhe për rrjedhojë edhe të Perandorisë Osmane. Në rrethana të tilla, në mungesë të vetëdijes historike, kombëtare dhe shtetërore, vendbanimet e tyre u copëtuan ndërmjet shteteve që i rrethonin. Por me fillimin e operacioneve luftarake edhe në kufijtë e këtij shteti të brishtë, ata gjetën aleatë në figurën e Esad Pashës, të cilin e quanin udhëheqësin e shqiptarëve myslimanë, dhe i cili si çdo njeri me mentalitet oriental, ishte i

gatshëm të bashkëpunonte me të gjithë, për hir të një pushteti absolut në zonat e pretenduara nga ai.

Dokumentet arkivore britanike flasin për 1.800 luftëtarë shqiptarë të Esad Pashës, të cilët ishin të angazhuar në vijën frontale kundër palës austro-hungareze. Natyrisht, si pashai shqiptar ashtu edhe ushtarët e tij ishin të paguar nga ana e fuqive aleate, selia e të cilave ndodhej në Selanik, aty ku ishte vendosur edhe qeveria e Esad Pashës, i cili zyrtarisht pranohej si “*President i qeverisë shqiptare*”. Ky njeri që kishte mentalitetet oriental, ndonëse manipulonte me shqiptarët e besimit islam, nuk e kishte për asgjë të bashkëpunonte me okupatorët serb, të cilët shqiptarët i përndiqnin jo vetëm për shkak të kombësisë së tyre, por edhe religjionit, në të cilin betohej ky njeri pa identitet. Prandaj nuk duhet habitur fakti se vendin e tij, ky njeri, e kishte shitur për një shumë prej 60.000 frangave në muaj që i merrte nga qeveria serbe.¹¹⁴

Esad Pashën nga Shqipëria aleatët e tij anglo-francez e transportuan në Selanik më 1916 dhe me atë rast ai u prit nga generalin francez, Maurice Sarraïl.¹¹⁵

Kështu në një memorandum dërguar qeverisë britanike, theksohej se me 1 shkurt të vitit 1918, fuqia e kontingjentit ushtarak shqiptarë të esadistëve përbëhej nga 1.438 mercenarë, numrit të të cilëve duhej shtuar edhe pjesëtarë të tjerë që shërbenin në prapavijë në qytetin e Selanikut si rojtarë deposh, depoista, etj. Ky numër përfundimisht sillej rreth 1.800 mercenarë.

Që nga janari i vitit 1918, kontingjenti shqiptarë esadist ishte i ndarë në tri grupe:

¹¹⁴ The National Archives, London, Public Record Office, Reference: Cab.25/45, p.63.

¹¹⁵ British Pathe Archive, General Sarraïl (1916), Film ID: 1856.20, Sort number: ON 023 I.

1. Grupimi që mbante anën e djathtë të bregut të lumit Shkumbin, dhe që kishte bazën në vendin *Plecista* (por që sigurisht ka të bëjë me qytetin e Peqinit—vërejtje, M.K.). Kjo kompani mercenarësh përbehej nga 435 luftëtarë të Tiranës dhe Shijakut, duke përfshirë këtu edhe 50 mercenarë të tjerë nga Dibra e që mbanin anën e majtë të bregut të lumit. Ky grup komandohej nga një kapiten dhe dy togerë francez;
2. Grupimi qendror që mbante anën e majtë të Shkumbinit deri te gryka e Langaricës, përbëhej nga 587 trupa dibranësh dhe kavajas. Komanda e këtij grupimi ishte ne Chesme (ndoshta ka të bëjë me qytetin e Cërrikut, vërejtje M.K) dhe udhëhiqej nga oficerë francez;
3. Ndërsa grupini i majtë që përbehej nga 415 krutanë, shtrihej nga Kuçova, Selca e Gorës e deri në Devoll. Gjatësia e tërësishme e frontit e mbajtur nga esadistët ishte më shumë se 20 km.

Kontingjenti i sjellë nga Esad Pasha në fund të gushtit të vitit 1916 fillimisht kishte 580 njerëz të cilët u trajnuan në kampet ushtarake deri në shkurt të vitit 1917, dhe u futën në luftime në mars të vitit 1917.¹¹⁶

Këto trupa mercenarësh shqiptarë për tre muaj rresht luftuan bashkërisht me regjimentin e parë dhe të dytë afrikan në hendeqet (llogoret) e Nikopolës në frontin e Selanikut. Në fund të muajit mars të po atij viti, koloneli i regjimentit të parë afrikan raportonte: “*Shqiptarët që janë nën komandën time po tregohen shumë trima dhe marrin pjesë së bashku me francezët në të gjitha operacionet ushtarake. Edhe përkundër motit të keq morali i tyre vazhdon të jetë shumë i mirë*”. Gjatë

¹¹⁶ The National Archives, London, Public Record Office, Reference: Cab.25/45, p.68.

qershorit ky batalion shqiptarësh ishte lënë në rezervë dhe qe dërguar në Ostrec, ku edhe qëndroi deri në fund të gushtit të vitit 1917.

Nga shtatori i vitit 1917, kontingjenti shqiptarë esadist iu bashkëngjit divizionit francez që vepronte në Shqipëri, në veri të Pogradecit. Prej shtatorit e deri në tetor të vitit 1917, këta mercenarë, morën pjesë aktive në të gjitha operacionet ushtarake duke çliruar me këtë rast një zonë prej 25 km, që përfshinte hapësirën në veri të këtij qyteti e deri në grykën e Shkumbinit. Ushtarakët e Esad Pashës, sipas oficerëve francez, me rikthimin e tyre në atdhe, kishin filluar procesin e çlirimit të tij, që sipas pikëpamjeve të tyre ishte okupuar nga forcat austro-hungareze. Rrjedhimisht këta mercenarë ishin në luftime të pandërprera krah për krah me batalionin 372 apo me spahinj të marokenë.

Grupet e armatosura Esadiste morën pjesë në këto beteja:

- A. Sulmin më 21 shtator 1917 në Golik, në rrethinën e Korçës, së bashku me batalionin e 372. Nga 450 robër austriak, 150 ishin zënë nga shqiptarët;
- B. Pushtimin e Tchescheme (Cërriku) dhe Hundishta (Udënisht në veri të Pogradecit) më 28 shtator të po atij viti;
- C. Më 19 tetor 1917, u krye sulmi ndaj forcave austro-hunareze në Belitchani (Velçan, në veriperëndim të Pogradecit). Me atë rast u zunë 60 robër lufte.

Koloneli francez, Dupertuis, i cili komandonte regjimentin maroken të spahinjve, shpërndau shumë dekorata trimërie kontingjentit shqiptarë. Duke dhënë dekoratën “*Croix de Guerre*” (Kryqin e Luftës), ai shënoi: *”Jam i lumtur që mund të ju përgëzoj për cilësitë e shqiptarëve. Unë do të dëshiroja që ata*

*përsëri t'i kisha nën komandën time në betejë. Shqiptarët dhe marokenët janë trupa për lëvizje, shumë të qëndrueshëm, marshues të mirë, e sidomos në zonat malore, dhe të zgjuar. Një brigadë jo e plotë e përbërë prej trupave të tillë në zonat malore do t'u sillte dëme pozicioneve armike...".¹¹⁷ Pra, është një lëvdatë e shprehur për cilësitë luftarake të shqiptarëve, gjë që vetëm rikonfirmonte thëniet e mëhershme për këtë popullsi të kalitur nëpër lufta të ndryshme. Ndërsa, trupat ushtarake marokene, të cilat ishin pjesë e Brigadës franceze "*Jouinot-Gambetta*", gjithashtu morën pjesë në pushtimin e qytetit të Shkupit më 29 shtator 1918.¹¹⁸*

Që nga tetori i vitit 1917 kontingjenti esadist ishte vendosur në të dy brigjet e lumit Shkumbin si pararoje të trupave franceze. Këto forca kishin arritur të zmbrapsin shumë sulme austro-hungareze, me çka ato kishin bërë që forcat franceze të ndihen plotësisht të sigurta.

Nga 8 janari 1918 fronti ishte zgjeruar deri te malet e Seltca Gorës, duke i mundur forcave esadiste të mbajnë një front të gjatë 20 km. Të 580 burrat që e shoqëronin Esad Pashën paguheshin nga 40 franga të arit në muaj, ndërsa pjesa tjetër e mercenarëve paguheshin 14 fragka (monedha në letër), në muaj. Kontingjenti shqiptarë ushqeheshin, vishej dhe armatosej tërësisht nga francezët. Natyrisht edhe ishte i komanduar nga ushtarakët francezë, që në përbërje të tyre numëronte 13 oficerë.¹¹⁹

¹¹⁷ The National Archives, London, Public Record Office, Reference: Cab.25/45, p.69.

¹¹⁸ Imperial War Museums, London, Ministry of Information First World War collection, Catalog number: 32800.

¹¹⁹ The National Archives, London, Public Record Office, Reference: Cab.25/45, p.69.

Rrjedhimisht, shqiptarët dhe vendbanimet e tyre gjatë Luftës së Parë Botërore janë konsideruar vetëm si zonë luftimesh, ndërsa ata vetë si komb, me pak përjashtime, projekttoheshin si një popullsi e islamizuar, pa kujtesë historike, pa vetëdije kombëtare si dhe pa traditë shtetërore. Në kushte të tilla, edhe angazhimi i forcave mercenare esadiste bëhej bashkërisht me ato marokene, me çka kjo popullsi, konsiderohej myslimane, pra e paqartë dhe e pavetëdijshme mbi interesat e saja nacionale. Kështu, ushtarët shqiptarë, edhe pas dëbimit të Perandorisë Osmane nga Ballkani, vazhdonin të shërbenin në ushtrinë e saj. Si shembulli më i mirë i sakrificës së tyre është Lufta në Çanakala (1915), kur forcat aleate tentuan të pushtojnë ngushticën e Dardaneleve, dhe ku jetën dhanë 600 ushtarë shqiptarë, që të gjithë nga Vilajeti i Kosovës. Pra, edhe gjatë LPB, viktimat shqiptare dhe vendbanimet e tyre të shkatërruara, pjesërisht edhe me fajin e tyre, nuk do të kapitalizoheshin, ashtu siç bënë popujt e tjerë evropian, të cilët finalizuan ideat e tyre kombëtare.

ISAMEDIN AZIZI

Instituti i Historisë Nacionale – Shkup

PRETENDIMET TERRITORIALE DHE ÇËSHTJA E KUFIJVE TË SHQIPËRISË

Shpallja e Pavarësisë Kombëtare në një kohë kur po zhvillohej Lufta Ballkanike ishte një kthesë e madhe dhe njëkohësisht një ngjarje me një rëndësi të madhe në historinë e Shqipërisë. Objektivisht, lufta ballkanike, nga njëra anë nënkuptonte luftë kundër sundimit osman në Ballkan, ndërsa nga ana tjetër, njëkohësisht paraqiste edhe luftë për bashkimin e territoreve me shtetet e tyre kombëtare, territore këto që ishin ende nën sundimin e Perandorisë Osmane. Se sa kjo lufte kishte karakter “çlirimtar”, ashtu siç proklamohet nga shtetet ballkanike, ndër të tjera tregon edhe fakti për marrëveshjet paraprake mes tyre, e që për synim kishin edhe aneksimet e territoreve shqiptare. Është e njohur tani më se me këto marrëveshje ishte parashikuar copëtimi i Shqipërisë si një vend pa zot ku të tjerët vendosnin për fatin e saj. Kjo situatë dëshmohet me faktin se ushtritë e shteteve ballkanike nuk u ndalën në kufijtë e në territoret e tyre kombëtare siç ishte synimi fillestar i tyre, por ia mësynë edhe tokave shqiptare. Objektivat e forcave serbe nuk ishin vetëm pushtini i Kosovës dhe viseve shqiptare të Maqedonisë, por ishin shumë më të gjera. Ata synonin të pushtonin gjithë bregdetin shqiptar të Adriatikut deri në Elbasan.

Pas vendosjes së armëpushimit midis Turqisë dhe aleatëve ballkanikë, qeveritë e Fuqive të Mëdha kishin vendosur të thirrëj Konferenca e Ambasadorëve në Londër për të shqyrtuar të gjitha çështjet që kishin dalë si rezultat i Luftës Ballka-

nike. Në fakt, kjo konferencë për muaj të tërë u mor me çështjen shqiptare dhe, në mënyrë të veçantë, me caktimin e kufijve të Shqipërisë. Aty u bënë e u hodhën për diskutim shumë projekte, por si bazë shërbyen propozimet e Austro-Hungarisë dhe të Rusisë, dy fuqive kryesore rivale për sundim në Ballkan.

Në pajtueshmëri me vendimet e konferencës së ambasadorëve, edhe pse nuk ishin përcaktuar kufijtë e saktë të shtetit të ri, Austro-Hungaria e mbronte qëndrimin se asnjë fshat i banuar me shqiptarë nuk duhet të mbetet jashtë shtetit shqiptar. Edhe përkundër këtij qëndrimi, Vjena në momente të caktuara, nën presionin e fuqive të tjera, nuk insistoi për zbatimin e plotë të këtij parimi, e sidomos kur bëhej fjalë për tokat ku, krahas shqiptarëve, jetonin edhe popuj të tjerë, edhe përkundër faktit që shqiptarët përbënin shumicën e asaj popullate, e të cilat toka mund të ishin objekt i kompromiseve. Në anën tjetër, Rusia haptazi u konfrontua me Austro-Hungarinë për disa vendbanime në veri dhe në lindje të Shqipërisë. Përderisa zhvilloheshin bisedime për statusin e Shkodrës, njëkohësisht zhvilloheshin bisedime paralele edhe për Gjakovën, Prizrenin e Dibrën, të cilat me insistimin e Rusisë, i takuan Mbretërisë SKS.

Në bazë të dokumenteve të shqyrtuara arkivore kuptojmë se ishin dy pika prej të cilave Austro-Hungaria në asnjë mënyrë nuk dëshironte të tërhiqej. Nga njëra anë, ajo dëshironte një Serbi të dobët dhe me territor të ngushtuar, dhe nga ana tjetër, një Shqipëri të fuqishme dhe autonome. Një politikë e tillë shqetësoi shtetin bullgar i cili besonte se Austro-Hungaria, pa diskutim, do të insistonte që pjesa më e madhe e Maqedonisë t'i takojë Bullgarisë. Në këto rrethana, Austro-Hungaria ia kishte bërë me dije Bullgarisë se ishte e gatshme për

një marrëveshje mes tyre për çështjen e Maqedonisë, gjë që nënkuptonte edhe kusht për një bashkëpunim të ardhshëm.¹²⁰

Si kompensim për zgjerimin territorial të shtetit të ri shqiptar të banuar me popullatë shqiptare, qeveria e Austro-Hungarisë i propozon Bullgarisë zgjerim territorial në provincën serbe, atë të Pirotit deri në Moravë,¹²¹ dhe pjesën e mbetur të Maqedonisë, (pjesën e mesme të rrjedhës së lumit Vardar dhe pjesën veriore të lumit Struma).

Ndërkaq, për sa i përket çështjes së kufijve shqiptarë dhe të pretendimeve serbe për territoret shqiptare, sipas burimeve të njëjta, qëndrimi i Austro-Hungarisë ishte shumë i prerë. Ky qëndrim kuptohet edhe nga vet deklarata e grofit Berthold në një takim me përfaqësuesin e Serbisë në Vjenë, me z. Jovanoviç, ku mes të tjerave kishte deklaruar se *”shteti i tij në asnjë mënyrë nuk do të tërhiqet nga qëndrimi i tij për të penguar Serbinë në depërtimin dhe marrjen e ndonjë porti në detin Adriatik, por ishte i gatshëm që të shqyrtonte çfarëdo propozimi që do t’i lejonte Serbisë dalje tregtare në detin Adriatik”*.¹²²

Sipas po të njëjtave burime, shihet qartë se Austro-Hungaria nëpërmjet politikës përkrahëse ndaj shqiptarëve fshihte interesat e saj në Ballkan. Këto burime na bëjnë të ditur se konti Erental, i cili paraqitej si simpatizues i shqiptarëve, besonte se *“duhej të krijohet një Shqipëri autonome dhe e zgjeruar, sepse.....një Shqipëri e vogël do të ishte e pafuqishme për t’iu kundërvënë pretendimeve serbe dhe atyre bullgare, dhe kjo*

¹²⁰ Државен Архив на Република Македонија (më tej ДАРМ) мф. 1580, док. 81, 24 korrik 1911.

¹²¹ Oferta austro-hungareze “provinca serbe e Pirotit, ku janë të vendosur shumë bullgarë, ti takojë Bullgarisë ishte propozim i politikës austriake për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të këtyre dy shteteve ballkanike”. ДАРМ, мф. 1580, док. 81, 24 korrik 1911.

¹²² ДАРМ, мф. 2134, док. 113, Beograd, 21 dhjetor 1912.

*do të paraqiste burim potencial të rrezikimit të paqes në Ballkan. Një Shqipëri e zgjeruar dhe stabile do të ndihmonte edhe në zgjidhjen e problemit të Selanikut. Porti i Selanikut, sipas ideve austriake, nuk mund t'i takonte askujt, përveç Turqisë, dhe rruga e lirë deri aty që do të kalonte nëpërmjet shtetit shqiptar, mendoj, do t'i konvenonte më tepër Austrisë, sesa rrugë që do të kalonte nëpërmjet një Serbie të zgjeruar”.*¹²³

Se sa e rëndësishme ishte çështja e kufijve të Shqipërisë për Austro-Hungarinë, flet edhe fakti se grofi Mensdorf, përfaqësues i Austro-Hungarisë, në konferencë për çdo ditë dërgonte telegrame të detajuara të bisedave të zhvilluara në Londër deri te ministri Berthold në Vjenë. Ndër të tjera, në telegramin e 18 dhjetorit të vitit 1912, thuhet: *”Në fillim të Konferencës së Ambasadorëve të ditës së sotme, nga unë është kërkuar të deklarohem rreth kufirit lindor të Shqipërisë së ardhshme. Unë e kam përsëritur qëndrimin tonë se, të gjitha pjesët e banuara me shqiptarë duhet patjetër t'i takojnë Shqipërisë, dhe sidomos rëndësi të veçantë i kam kushtuar kufirit verior të Shqipërisë, dhe kam kërkuar të mbetet kufiri aktual me Malin e Zi”.*¹²⁴ Për mënyrën e zhvillimit të bisedimeve, ministri Berthold, në telegramin e tij të 19 dhjetorit 1912, e autorizon Mensdorfin që *“gjatë bisedimeve si bazë të merret parasysh vija kufitare sipas së cilës rajoni i Pejës, i Prizrenit dhe i Ohrit duhet të përfshiheshin në kufijtë e Shqipërisë, si dhe të merren parasysh kërkesat më të reja të toskëve të jugut në lidhje me përcaktimin e kufirit jugor”*¹²⁵.

¹²³ ДАРМ, мф. 1580, док. 148, Вiena, 31 гусшт 1911.

¹²⁴ ДАРМ, мф. 1305, Ministerium des Aussern, Diplomatische aktenstucke betreffend die ereignisse am Balkan., dok. 173.

¹²⁵ ДАРМ, мф. 1305, Diplomatische aktenstucke, dok. 181.

Ajo që vlen të përmendet në këtë periudhë kohore, është edhe fakti se fitorja e shpejtë e aleancës ballkanike kundër Perandorisë Osmane, krijoi mundësinë që kjo aleancë të japë propozime rreth përkufizimeve të shtetit të tyre me Shqipërinë. Me dëshirën që të merrte pjesën më të madhe të Ballkanit, në propozimin e përfaqësuesit të Serbisë lexojmë: *”Në lidhje me kufijtë e shtetit të ri shqiptar koncesionet e fundit që mund t’i bëjë Qeveria Mbretërore Serbe paraqesin vijën e cila kalon nëpërmjet kreshtës së malit që i ndan ujërat që derdhen në liqenin e Ohrit dhe Drinit të Zi, nga njëra anë, dhe Detit Adriatik, nga ana tjetër. Nëse kufijtë që paraqesin minimumin e kërkesave tona nuk mund të pranohen, atëherë asnjë qeveri në Serbi nuk do të ishte në gjendje të bind popullin që ta pranojë këtë dështim të ri kundrejt aspiratave që kishte populli serb, e për të cilat kishte bërë të gjitha sakrificat e mundshme”*.¹²⁶

Ky propozim serb ishte i papranueshëm për Austro-Hungarinë. Sipas këtij propozimi, në jug të Shqipërisë kufiri do të ishte i njëjtë me vijën kufitare që mbronte Greqia, ndërsa për sa u përket kufijve lindorë dhe veriorë, vinin në pah pretendimet serbe dhe malazeze. Kjo vijë kufitare që paraqitet nga aleatët ballkanikë edhe më tepër do ta kufizojë territorin e Shqipërisë sesa propozimi i dhënë nga ana ruse.¹²⁷ Vija kufitare e Shqipërisë ishte burim i shqetësimit të shumë politikanëve të kohës të cilët kishin frikën se situata do të bëhej edhe

¹²⁶ ДАРМ, мф. 2134, док. 334, Београд, 30 дхјетор 1912. Пër çështјен е кufijве тe Shqipërisë shih, Inostrani, Politički pregled. Kraj Skadarskog pitanja.- Granice Albanije.- Deo turskog drzavnog duga koji bi mogli primiti Balkanski saveznici posle mira, Srpski knjizevni glasnik, knj. XXX, br. 10, 16 maj 1913, 796.

¹²⁷ ДАРМ, мф. 1305, Ministerium des Aussern, Diplomatische aktenstucke ..., dok. 218.

më serioze nëse kufijtë e Shqipërisë shtyheshin shumë më në lindje dhe më në veri. Prandaj propozohej që kufiri lindor i Shqipërisë të ishte ujëndarësja ndërmjet liqenit të Ohrit dhe Adriatikut si dhe ajo e Drinit dhe Adriatikut.¹²⁸

Në telegramin e ambasadorit Mensdorf nga Londra deri te ministri Berthold, i dërguar me 6 shkurt të vitit 1913, flitet për rrjedhën e konferencës në Londër, ku ndër të tjera, Sër Edvard Grej e informon konferencën për një propozim të ardhur nga princi Lihnovski për përcaktimin e kufirit të Shqipërisë në veri dhe në lindje. Vija kufitare do të fillonte nga Adriatiku, do ta përcillte rrjedhën e lumit Buna deri në pikën ndërmjet vendeve Ruskuli dhe Samrik, do të vazhdon-te në drejtim të liqenit të Shkodrës, duke ia lënë Taraboshin Shqipërisë, prej aty, në drejtim të gjirit të liqenit të Hotit, duke i lënë Malit të Zi Hotin dhe Grudën, ndërsa Shqipërisë Kastratin, Kelmendin dhe Shkrelin. Plava, Gucia, Peja dhe Manastiri i Deçanit do të mbeteshin jashtë Shqipërisë si dhe Prizreni, me përjashtim të territorit të Lumës. Gjakova dhe Dibra do t'i takonin Shqipërisë, prej nga kufiri do të kalonte në pjesën lindore të Drinit deri te liqeni i Ohrit.¹²⁹

Ajo që më tepër bie në sy në këto biseda është se secila nga shtetet e Fuqive të Mëdha mbështetnin propozimet që shkonin në favor të atyre shteteve ballkanike, të cilat ishin të lidhura ngushtë me interesat e tyre. Këtë e dëshmon edhe telegrami i ambasadorit Mensdorf dërguar ministrit Berthold më 14 shkurt 1913 ku flitej për një propozim rus për përcaktimin e kufirit lindor dhe verilindor të Shqipërisë. Sipas këtij propozimi, vija kufitare do të fillonte nga Adriatiku në pjesën jugore të lumit Buna, Qyteti i Shkodrës do t'i takonte Shqipërisë, e

¹²⁸ ДАРМ, мф. 2134, док. 113, Београд, 21 дхјетор 1912.

¹²⁹ ДАРМ, мф. 1305, Diplomatische aktenstucke...док. 273.

Mali i Zi, si kompensim, do ta fitonte tërë liqenin e Shkodrës. Bregu i liqenit, nga derdhja e saj në lumin Buna e deri te gjiri i liqenit të Hotit, i premtuhej Shqipërisë, me garanci që Mali i Zi të ketë liri të plotë për zbatimin e rregullimit të liqenit. Gjakova do të mbetej jashtë Shqipërisë, pastaj do të përcillej rrjedha e Drinit të Bardhë deri në derdhjen e saj në Drinin e Zi, dhe do të vazhdonte deri në pikën ku vija kufitare arrin deri në propozimin e njohur të pjesës lindore të lumit Drin, e cila vazhdon deri në pjesën veriore të liqenit të Ohrit.¹³⁰

Në kuadër të kësaj, ambasadori Mensdorf u dorëzon përfaqësuesve tjerë të konferencës së Londrës një propozim më të “butë” sipas të cilit, kufiri i Shqipërisë do të fillonte nga bregdeti Adriatik, përgjatë rrjedhës së lumit Buna deri në fshatin Gorricë, i vendosur në bregun e djathtë të lumit. Prej aty, vija kufitare do të ngjitej lart, deri në majat e maleve që e ndajnë lumin Buna me liqenin e Shkodrës, duke ia lënë Taraboshin Shqipërisë. Kjo vijë do ta kalonte liqenin deri te fshati Zogaj, i cili i mbetet Shqipërisë, dhe do të vazhdonte deri te liqeni i Hotit, prej nga do ta përcillte kufirin ndërmjet fiseve Grudi dhe Hoti që iu lanë Malit të Zi, nga njëra anë, dhe të fiseve Kelmendi dhe Kastrati, nga ana tjetër, që iu lanë Shqipërisë. Vija kufitare vazhdon duke u përputhur me kufirin aktual të fiseve Kuçi, nga njëra anë, dhe të fisit Kelmendi, nga ana tjetër, deri në rrethinat e Plavës dhe të Gucisë, e këta të fundit i mbesin Malit të Zi.¹³¹ Në vazhdim, sipas propozimit të njëjtë, kufiri shqiptar zbret nga vargmalet dhe kalon në kreshatat kodrinore në jug të Gjakovës e cila mbetet jashtë Shqipërisë. Ajo e përcjell rrjedhën e Drinit të Bardhë deri në perëndim të qytetit të Prizrenit duke vazhduar ndërmjet qarkut të

¹³⁰ ДАРМ, мф. 1305, Diplomatiche aktenstucke...док. 286.

¹³¹ ДАРМ, мф. 1305, Diplomatiche aktenstucke...,док. 314.

Prizrenit dhe të Lumës, duke ia lënë këtë të fundit Shqipërisë. Nga aty, vija kufitare vazhdon përgjatë kodrave malore të Korabit duke ia lënë Shqipërisë krahinën e Dibrës së Vogël, ndërsa jashtë Shqipërisë krahinën e Rekës. Duke i lëshuar këto kodrina pak më në veri se qyteti i Dibrës, i cili mbetet jashtë Shqipërisë, vija kufitare vazhdon përgjatë Drinit të Zi deri në fshatin Llukovë, duke e lënë qytetin e Strugës jashtë Shqipërisë, vija vazhdon deri në bregun e liqenit të Ohrit.¹³²

Edhe përkundër përcaktimit të përgjithshëm të kufirit shtetëror shqiptar, prapëseprapë ngelën disa pika kontestuese me shtetet fqinje, të cilat për shkak të fillimit të Luftës së Parë Botërore tema rreth kufijve do të zvarritet me vite. Edhe përkundër faktit se Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore mbajti pozicion asnjanes, pasojat e një lufte të tillë fortë ndjeheshin në territorin e saj, për arsye se tokat e saj u ndanë në zona okupuese ndërmjet fuqive ndërluftuese.

Në fund të vitit 1918, forcat serbe, mbanin të pushtuar një pjesë të konsiderueshme të territorit shqiptar, që përfshinte krahinat lindore e verilindore, si ato të Dibrës së Poshtme (Peshkopisë), Hasin, Lumën, Malësinë e Gjakovës, Krasniqen e Kelmendin, zonë e cila në Beograd u pagëzua si “*vijë strategjike*”, e që sipas tyre ato ruanin rrugën Gostivar–Dibër, që sulmohej nga shqiptarët dhe siguronin pagën për popullsinë kufitare jugosllave që rrezikohej prej tyre.¹³³

Në Konferencën e Parisit, çështja shqiptare, ndonëse nuk u trajtua më vete, zuri një vend të konsiderueshëm. Shtetet fqinje të Shqipërisë si, Italia, Mbretëria e SHKS-së dhe Greqia

¹³² Po aty.

¹³³ Građa o stvaranju jugoslovenske države (I.I-20.XII 1918), B. Krizman, D. Jankovič, Institut društvenih nauka, Odeljenje za istorijske nauke, Beograd 1964, dok. 585.

erdhën në konferencë pak a shumë me pretendimet e tyre të njohura ndaj Shqipërisë dhe bënë përpjekje që ato edhe t'i realizonin. Gjatë luftës, ata kishin bërë përpjekje për të arritur marrëveshje të fshehtë për copëtimin e mëtejshëm të Shqipërisë, marrëveshje kjo e njohur si Traktati i fshehtë i Londrës. Frika e Beogradit nga penetrimi italian në Shqipëri të cilin e shihte si një kërcënim të drejtpërdrejtë të saj, e sidomos në rrethana të reja kur ajo mund të krijonte një lidhje më të afërt territoriale me Bullgarinë, e përcaktoi edhe qëndrimin e delegacionit jugosllav në konferencë në lidhje me Shqipërinë.

Më 18 shkurt 1919 qeveria e Beogradit paraqiti një memorandum para konferencës, përgatitur nga shefi i misionit ushtarak në Paris, Petar Peshiç, ku krahas kërkesave të saja për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar, sipas vendimeve të përcaktuara në Konferencën e Ambasadorëve të vitit 1913, bëhet i njohur edhe memorandum i mbi kufirin e Mbretërisë SKS me Shqipërinë nga pikëpamja strategjike, ku kërkoheshin ndryshime të mëdha në favor të Mbretërisë SKS, gjegjësisht shpall programin maksimal territorial të Beogradit, i cili parashihte aneksimin e pjesës veriore të Shqipërisë deri në lumin Shkumbin¹³⁴.

Vend të veçantë në bisedimet e Konferencës së Parisit zë "*Çështja e Adriatikut*" me të cilën lidhet edhe fati i Shqipërisë. Pas nënshkrimit të paqes me Gjermaninë, kjo temë doli në plan të parë në Konferencën e Parisit. Çështja e Adriatikut ishte rezultat i kontradiktave midis Italisë e Mbretërisë SKS për ndarjen e tokave të ish-perandorisë Austro-Hungareze gjatë bregut lindor të Adriatikut. Qeveria e Romës kërkonte të aneksonte, si viset bregdetare të Adriatikut Lindor, siç parashikohej në Traktatin e fshehtë të Londrës e që banohej

¹³⁴ Skripta iz Diplomatske Historije Jugoslovenske Države 1918-1941, Konferencija u Parizu i mirovni ugovori, B. Krizman, Zagreb, 1973.

kryesisht me popullatë sllave, ashtu edhe qytetin e Rjekës të banuar në pjesën më të madhe prej italianëve, por që sipas traktatit duhej t'i mbetej Kroacisë, përkatësisht Mbretërisë SKS.¹³⁵ Çështja e Adriatikut futi përçarje edhe në vet delegacionin jugosllav. Pikërisht për këtë çështje, dolën në pah mosmarrëveshjet midis dy liderëve të delegacionit jugosllav, atij të Pashiçit, që mbronte unitarizmin serb dhe Trumbiqit, që mbronte qëndrimet e një federalizmi kroato-sllaven, e i cili, si përfaqësues i interesave kroate, ishte tepër i ndjeshëm për fatin e Rjekës. Ai ishte kundër çdo lloj kompromisi që humbjet territoriale në Adriatikun Verior të kompensoheshin me toka shqiptare.¹³⁶ Pashiçi dhe pjesa më e madhe e delegacionit ishin për një kompromis të përgjithshëm për këtë çështje dhe ata ishin të gatshëm të bënin lëshime në Dalmaci dhe për Rjekën në favor të pretendimeve territoriale në Shqipëri. Beogradi ishte shumë më i interesuar dhe këmbëngulte për kufij strategjik dhe për mandat në Shqipërinë e Veriut, nëse konferenca e Parisit nuk do ta pranonte pavarësinë e Shqipërisë sipas kufijve të përcaktuar në vitin 1913. Konflikti italo-jugosllav do të zgjidhet me marrëveshjen e dy palëve në nëntor 1920 i njohur si Traktati i Rapallos, sipas të cilit Italia morri Istrinë, Zarën dhe disa ishuj në Adriatik. Rjeka si qytet i banuar kryesisht nga popullsia italiane ishte parashikuar të gëzonte statusin e një shteti të lirë,¹³⁷ ndërsa Mbretëria SKS, edhe pse u paraqit si “viktimë”, morri gjithë Dalmacinë, por jo

¹³⁵ Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë, 1912-1924*, Tiranë 2007, 67, P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia 1918-1927*, Tiranë, 1992, 74.

¹³⁶ Skripta iz Diplomatske Historije Jugoslovenske Države 1918-1941, Jadransko pitanje do Repalla, B. Krizman, Zagreb, 1973, 24.

¹³⁷ Muin Çami, *Shqipëria në rrjedhat e historisë, 1912-1924*, Tiranë 2007, 152.

edhe Shkodrën ashtu siç pretendonte Pashiçi, për të cilin kjo marrëveshje paraqiste një dëshpërim të madh për shtetin serb.¹³⁸

Pranimi i Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve si një shtet i pavarur, që njëherit nënkuptonte edhe ripohim i pavarësisë së shtetit të shpallur në vitin 1912, nuk e nënkuptonte edhe garantimin e tërësisë territoriale të saj në kufijtë e vitit 1913. Kjo, mbase në territorin e saj akoma gjendeshin forcat ushtarake të shteteve fqinje, sidomos ato serbe dhe greke, që bënin me dije se këta dy qeveri nuk kishin ndërmend t'i respektonin aktet ndërkombëtare. Nga pamundësia për ta zgjidhur vetë këtë çështje, Shqipëria problemin e kufijve të saj e ngriti në organet më të larta ndërkombëtare të kohës, me shpresë se ndoshta me intervenimin e të huajve kjo çështje do të zgjidhej në favor të saj. Kjo çështje ngjalli shumë diskutime për zgjidhjen e së cilës u angazhuan të gjitha instancat ndërkombëtare të kohës, siç ishin: Komisioni Ndërkombëtar për Përcaktimin e Kufijve, Konferenca e Ambasadorëve, Lidhja e Kombeve, Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, qeveritë e Shqipërisë dhe të Mbretërisë SKS si dhe ato të Fuqive të Mëdha. Edhe përkundër angazhimit të këtyre institucioneve ndërkombëtare, çështja e kufijve ngeli e hapur edhe shumë vite më tej.

Për përcaktimin përfundimtar të vijës kufitare mes Shqipërisë dhe Mbretërisë SKS, ishte e duhur edhe zgjidhja e dy pikave kontestuese që ishin të një rëndësie shumë të madhe për të dyja palët, ajo e Vermoshit dhe ajo e Shën Naumit. Më 25 qershor 1921, çështja e kufijve të Shqipërisë u diskutua në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, ku u ballafaquan dy qëndrime të kundërta rreth kompetencave se kush e kishte të drejtën për t'u marrë me përcaktimin e kufijve të Shqipërisë. Delegacioni

¹³⁸ A. Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Tiranë, 2009, 200.

shqiptar, të drejtën për caktimin e kufijve të saj ia njihje Lidhjes së Kombeve, ndërsa delegacioni serb dhe ai grek, këtë të drejtë ia njihnin Konferencës së Ambasadorëve.¹³⁹ Debatet rreth “*konfliktit të kompetencave*” u mbyll në favor të delegacionit serb e grek, me rezolutën që miratoi Asambleja e Lidhjes më 2 tetor 1921 duke u thirrur në Traktatin e Sen-Zhermenit, i cili i kishte ngarkuar Fuqitë Aleate të caktonin kufijtë e Mbretërisë SKS dhe të Greqisë, gjë që nënkuptonte edhe caktimin e kufijve të Shqipërisë.¹⁴⁰ Nga kjo kuptohet se Lidhja e Kombeve rezervonte një funksion mbikëqyrjeje, ndërsa zgjidhja përfundimtare e çështjes në thelb i lihej Konferencës së Ambasadorëve.¹⁴¹ Pas shumë diskutimesh e debatesh dhe pas krijimit të një komisioni ekspertësh me detyrë që të bënte studimin paraprak të pretendimeve territoriale të Greqisë, Serbisë dhe Italisë, më 9 nëntor 1921, Konferenca e Ambasadorëve shpalli vendimet e saj. Vendimi i parë kishte të bënte me njohjen e qeverisë shqiptare, pas së cilës vijonin dy pika tjera, të cilat parashikonin korrigjime të kufirit në veri e verilindje të Shkodrës, në perëndim të Prizrenit, në perëndim dhe në juglindje të Dibrës dhe në rajonin e Linit në liqenin e Ohrit.¹⁴² Sipas vendimit të 9 nëntorit 1921, më 18 janar 1922 u formua Komisioni Ndërkombëtar për caktimin e kufijve të Shqipërisë¹⁴³ dhe pas një pune konkrete në terren në qershor–korrik 1922, dhe pas dëgjimit të të dyja palëve, konkludoi se

¹³⁹ A. Puto, *Problemi i statusit të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve dhe në Konferencën e Ambasadorëve*, Studime historike, Tiranë, 1965, 11.

¹⁴⁰ A. Puto, *Shqipëria politike, 1912-1939*, Tiranë, 2009, 296-297

¹⁴¹ Po aty.

¹⁴² A. Puto, *Problemi i statusit*,..., 26, P. Milo, *Shqipëria*..., 205. A. Puto, *Shqipëria politike*,..., 298,

¹⁴³ Милчо Балеvски, *Балканските политички прилики и дипломатските битки за Манастирот Свети Наум*, Скопје, 1984, 108.

Vermoshi me të drejtë i takon Shqipërisë. Dhe me vendimet e 10 nëntorit 1922 dhe të 13 janarit 1923, vija kufitare në veri e në verilindje u miratua përfundimisht nga Konferenca e Ambasadorëve. Mirëpo qeveria e Beogradit, me arsyetimin se kjo vijë kufitare ishte shumë afër qytetit të Podgoricës, ashpër protestoi në Konferencën e Ambasadorëve e me çka u shty edhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

Në të njëjtën kohë, çështja e manastirit të Shën Naumit, ngjalli shumë më tepër diskutime se sa çështja e Vermoshit. Diskutimet vendimtare u përqendruan në interpretimin e akteve ndërkombëtare të Konferencës së Londrës në vitin 1913, e sidomos në pjesën ku bëhej fjalë për përcaktimin e kësaj pjese të kufirit, ku mes tjerash thuhej: *“Kazaja e vjetër e Korçës bashkë me bregun perëndimor e jugor të liqenit të Ohrit, prej fshatit Lin e deri në manastirin e Shën Naumit i takon Shqipërisë”*. Pikërisht fjalët *“deri në manastirin e Shën Naumit”*¹⁴⁴ paraqisnin temën boshte rreth së cilës u ndeshën interpretimet e tyre. Për palën shqiptare nuk kishte asnjë dyshim se kjo nënkuptonte që manastiri i takon Shqipërisë. Me t’u shfaqur problemi i manastirit, të dyja palët filluan t’i furnizojnë anëtarët e Komisionit Ndërkombëtar për përcaktimin e kufijve dhe qeveritë e Fuqive të Mëdha, me dokumente e argumente historike, strategjike, ekonomike e fetare për të drejtën e tyre për këtë vend. Pas shumë diskutimesh e debatesh në Komisionin Ndërkombëtar për përcaktimin e Kufijve dhe pas formimit të një Komiteti Tekniko–Gjeografik që vepronte në kuadër të Komisionit të Kufijve, në mënyrë unanime, më 28 nëntor 1922 propozon që manastiri t’i jepet Shqipërisë.¹⁴⁵ Konferenca e Ambasadorëve, me 6 dhjetor 1922,

¹⁴⁴ Милчо Балеvски, *Балканските политички...*, 113.

¹⁴⁵ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavia...*, 219.

pas një analize të mirëfilltë të çështjes së manastirit të Shën Naumit, solli vendimin që manastiri t'i jepet Shqipërisë.¹⁴⁶ Zhagitja e zbatimit të menjëhershëm të këtij vendimi i la kohë qeverisë së Beogradit të përgatitej për ta kundërshtuar këtë vendim. Qeveria e porsaformuar e Nikolla Pashiçit, pas një fushate të suksesshme diplomatike dhe intensive, arriti ta pengojë realizimin e kësaj marrëveshjeje. Me ndihmën e qeverisë franceze ajo arriti që përsëri çështjen e manastirit të Shën Naumit ta vendosë në tavolinën e bisedimeve, dhe si rezultat i kësaj, kjo çështje përsëri u kthye në Asambleenë e Lidhjes së Kombeve, e kjo më 17 qershor 1924, t'i drejtohet për mendim konsultativ Dhomës së Përhershme të Drejtësisë Ndërkombëtare¹⁴⁷ për interpretimin e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të Londër të vitit 1913.¹⁴⁸ Gjykata Ndërkombëtare e drejtësisë më 4 shtator 1924 dha mendimin e saj konsultativ, sipas së cilës thuhet se Konferenca e Ambasadorëve më 6 dhjetor 1922 ka dhënë mendimin përfundimtar për përcaktimin e kufirit ndërmjet Shqipërisë dhe Mbretërisë së SKS-së, sipas së cilës manastiri i Shën Naumit i takon Shqipërisë. Vendimet e këtyre institucioneve ndërkombëtare e gjetën Shqipërinë të trazuar e në rrethana të reja politike. Ishte krijuar një qeveri e re në krye me Nolin i cili nuk arriti të siguronte njohjen e qeverisë së tij nga shtetet evropiane, situatë kjo të cilën e shfrytëzoi qeveria e Beogradit për moszbatimin e akteve ndërkombëtare që nuk ishin në favor të saj. Ajo priste momente më të volitshme për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje në favor të saj.

¹⁴⁶ Милчо Балеvски, *Балканските...*, 135.

¹⁴⁷ P. Milo, *Shqipëria dhe Jugosllavja...*, 230.

¹⁴⁸ Милчо Балеvски, *Балканските...*, 166.

Me ardhjen e Zogut përsëri në krye të shtetit shqiptar, çështja e kufijve të Shqipërisë përsëri u hap, për t'u mbyllur pastaj me nënshkrimin e një marrëveshjeje të përbashkët ndërmjet Shqipërisë e Mbretërisë SKS, sipas së cilës, manastiri i Shën Naumit dhe një pjesë perëndimore e Vermoshit do t'i takojë Mbretërisë SKS.

Më 30 korrik 1926, anëtarët e Konferencës së Ambasadorëve në Paris së bashku me përfaqësuesit e Shqipërisë, Mbretërisë SKS dhe të Greqisë, nënshkruan aktin final të përcaktimit të kufijve të Shqipërisë. Për t'u përcaktuar kufijtë definitiv të shtetit shqiptar, u deshën të kalojnë katërmëdhjetë vjet nga shpallja e pavarësisë së saj.

RUDINA MITA

Universiteti "A.Xhuvani"—Elbasan

BESNIK BAJRAMI

Tetovë

ELBASANI GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Më 22 janar 1914, Ismail Qemali dhe qeveria e kryesuar prej tij që nga nëntori i vitit 1912, u detyrua të jepte dorëheqjen. Pushtetin pas dorëheqjes ia kaluan Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK), i cili përgatiti ardhjen dhe pritjen e Princ Vedit. KNK më 2 mars 1914 ndërmori dhe aktin e shkarkimit të Aqif pashë Elbasanit nga detyra e Prefektit të Elbasanit.

Më 7 mars 1914 Princ Vidi erdhi në Shqipëri. Vështrimi dhe vlerësimi i disa qarqeve politike për regjimin e Princ Vedit ishte realist. Ata regjimin e Princ Vedit, si faktorin kryesor për ruajtjen e lirisë e të pavarësisë së Shtetit Shqiptar, të garantuar nga Fuqitë e Mëdha në bazë të vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1913. Vetëm dy ditë pas arritjes në Shqipëri (9 mars 1914), Princ Vilhelm Vidi nëpërmjet kabinetit të tij mbretëror e vuri në dijeni Aqif Pashën për konsideratën e lartë që ushqente Princ Vidi për veprat atdhetare të tij.

Princ Vidi i kërkonte personaliteteve elbasanase ndihmën dhe mbështetjen për mposhtjen dhe shtypjen e bandave që vepronin dhe tronditnin rendin publik në zonën e Korçës. Ndihma nuk mungoi por pati edhe reagime ndaj disa emërimeve në kabinetin qeveritar të Vedit. Përmendim këtu reagimin e shkaktuar për emërimin e Esat pashë Toptanit si ministër i Punëve të Brendshme në qeverinë e sapokrijuar.

Pas heqjes së Esatit nga qeveria, Aqif pashë Elbasani më 28 maj 1914 u caktua ministër i Punëve të Brendshme dhe zëvendësministër i Luftës në qeverinë e princ Vidit ku shërbeu deri në 3 shtator 1914, ditën kur u largua princi nga Shqipëria. Në atë post të lartë e shumë të rëndësishëm ai si gjithnjë punoi me vendosmërinë e një burrishteti përkushtuar kombit të vet dhe tregoi sërishmi aftësitë e larta shtetformuese për ngritjen dhe për organizimin e administratës shtetërore dhe për përballimin e trazirave të brendshme, sidomos kryengritjes rebele e antikombëtare e Haxhi Qamilit, pjesëmarrësit e të cilës më 23 qershor 1914 i dogjën shtëpinë në Elbasan.

Princ Vilhelm Vidi e falënderoi Aqif Pashën për punën e kryer në detyrën e ministrit të Brendshëm dhe për kontributet që dha për vendosjen e rendit dhe në përballimin e situatave të vështira.

Shpërthimi i Luftës së Parë Botërore në verë 1914 dhe largimi i Princ V. Vidit më 3 shtator 1914 nga Shqipëria e ndërlikuan shumë gjendjen politike të vendit. Shqipëria u shndërrua në shesh luftimesh midis dy blloqeve kundërshtarë, Antantës dhe Tripalëshit, dhe u nda në tre zona pushtimi: Zona e pushtimit francez, Zona e pushtimit austro-hungarez dhe Zona e pushtimit italian.

Pas largimit të Vidit nga Shqipëria, shumë personalitete të trevës së Elbasanit u internuan jashtë vendit, rikthimi i të cilëve u bë vetëm pas kthimit të Elbasanit në zonë të pushtimit austro-hungarez. Rigjallërimi i veprimtarisë dhe aktivitetit të tyre u bë me qëllimin e vetëm se duke shpresuar e besuar se Austro-Hungaria, e cila para luftës kishte përkrahur regjimin e Vidit, do ta përkrahte atë edhe gjatë luftës dhe për t'u treguar fuqive ndërluftuese se në Shqipëri ishte regjimi i Vidit, asnjëanësia e të cilit ishte njohur e garantuar prej tyre.

Në krye të këtyre personaliteteve elbasanase dhe shqiptare që përkrahnin dhe mbështetnin rikthimin e Vidit në Shqipëri u bë edhe Aqif Pasha, i cili vuri të gjitha forcat për riorganizimin e administratës shtetërore Vidiste në Shqipëri të Mesme dhe zgjerimin e saj në të gjithë vendin. Për këtë qëllim një Komision i mbledhur më 18 shkurt 1916 në Elbasan, me nismën e Aqif Pashës e të Ahmet Zogut dhe i përbërë nga Ahmet Zogu, Qemal bej Elbasani, Ahmet Haxhisinani, Ymer Stringa, Shefqet Daiu, Sava Papajani, Simon Shuteriqi, Thanas Floqi e Lef Nosi vendosi:

1. Të mbahej një kongres më 2 prill *alla-frënga* në Elbasan për të biseduar gjendjen politike dhe masat që duheshim marrë për forcimin e shtetit shqiptar,
2. Komisioni do t'i propozonte Aqif Pashës, ministrit të Brendshëm, të thërriste edhe ministrat e tjerë, për të nisur e vazhduar punën qeveria e Vidit.¹⁴⁹

Kryetari i komisionit të Kongresit, Ahmet Zogu, ftoi më 2 mars bashkitë e qyteteve të zonës austro-hungareze e bullgare të pushtimit, dhe u dërgoi telegrame kryesive të katundarive të Beratit, Skraparit, Ballshit, Fierit, Lushnjes, Kavajës, Durrësit, Peqinit, Shijakut, Tiranës, Krujës, Lezhës, Shkodrës, Matit, Dibrës dhe Starovës që të dërgonin përfaqësues në kongres. Ahmet Zogu lajmëroi nga Elbasani edhe Nexhip Dragën (Mitrovicë), Bajram Currin (Gjakovë), Hasan Prishtinën (Prishtinë) dhe Mehmet pashë Derallën (Tetovë). Ai ftoi gjithashtu kolonitë shqiptare të Bukureshtit, Sofjes e Lozanës të dërgonin edhe ato nga dy delegatë.¹⁵⁰

¹⁴⁹ Instituti i Historisë, *Lef Nosi, Dokumente historike për t'i shërbyer Historisë sonë Kombëtare*, Tiranë 2007, viti I, gusht 1946, Nr. 6, fq. 184-185.

¹⁵⁰ *Po aty*, fq. 184.

Ahmet Zogu i dërgoi një letër¹⁵¹ August Kral-it (Konsullin e Austro-Hungarisë në Shkodër), të cilin pasi e njoftonte se më 18 mars 1916 ishte vendosur të mbahej Kongresi kombëtar, theksonte se nga Austro-Hungaria shqiptarët prisnin "*zgjanimin e kufijvet pas principit të kombësisë*".¹⁵²

Përpjekjet e atdhetarëve për thirrjen e një kongresi në Elbasan për të shqyrtuar masat e ndryshme politike për rivendosjen e shtetit shqiptar, të njohur nga Fuqitë e Mëdha, nuk u kurorëzuan me sukses. Në kushtet e Luftës së Parë Botërore, autoritetet austro-hungareze nuk ishin të interesuara për regjimin e Vidit dhe shtetin e pavarur shqiptar. Toger Von Zivtkovski, nënkonsull i Austrisë në Elbasan i shkruante më 12 mars Komandës së korpusit XIX se "*Rrahja e mendimeve mbi administratën e ardhshme është e rrezikshme*". Por dhe ndalimi i kongresit, vazhdonte ai, do të shkaktonte zemërim sepse delegatët ishin rrugës dhe do të shfrytëzohej prej kundërshtarëve tanë kundër nesh, eventualisht edhe prej bullgarëve.¹⁵³

Pra siç përmendëm, Mbledhja vendosi që të mbahej në Elbasan një Kongres Kombëtar i cili do të bisedonte për "*punët e*

¹⁵¹ Në letren e 3 marsit (17 mars allafrënga), pas i shprehte falënderimet për ndihmën që ai i kishte dhënë çështjes kombëtare shqiptare dhe shpresën se do ta ndihmonte edhe në të ardhmen i shkruante: "Shpresa që kemi mbështetur tek Zotëria e juaj na dha guxim dhe vendosëm që të bëhet më 18 mars (2 prill allafrënga) këtu një Kongres Kombëtar, me anën e të cilit të silltet bashkimi e vllazëria ndërmjet fiseve shqiptare dhe të mendohet ç'duhet bërë që Atdheu ynë paskëtaj të marrë udhën e përparimit e të dijë të gëzojë lirinë që po i japin sot armët e ushtrisë së perandorisë austro-hungareze nga e cila presim zgjerimin e kufijve sipas principit të kombësisë". (fq. 186)

¹⁵² Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, viti 2006, fq. 73.

¹⁵³ Arkivi i Institutit të Historisë (Arkivi i Vjenës), më poshtë A.I.H. dokument 26-6-634, datë 12 mars 1916.

atdheut"¹⁵⁴. Mbledhja i propozoi ministrit të Punëve të Brendshme të qeverisë së fundit, Aqif pashë Elbasanit, t'u bënte thirrje ministrave të tjerë për t'u kthyer në detyrë. Përfaqësuesi i Vjenës në Shqipëri, August Kral, shkruante më 3 mars 1916 se pashai elbasanas dhe personalitetet shqiptare u mbështetën në aksionin e tyre politik, si ish ministër i Punëve të Brendshme i qeverisë së fundit Shqiptare të Turhan Pashës e cila ishte larguar më 3 shtator 1914, por edhe si përkrahës dhe mbështetës së politikës vidiste në Shqipëri. Nga kjo pozitë pashai emëroi prefektë, nënprefektë, kryetarë komunash në disa krahina të vendit në zonat ku ishte vendosur ushtria austro-hungareze¹⁵⁵ dhe u vunë të gjitha forcat për organizimin e administratës shtetërore vidiste. Kongresi do të shqyrtonte *"mënyrën se si do të qeverisej Shqipëria, do t'i shfaqte Mbretit W.Wied dëshirën që ai të vinte sa më shpejt në Shqipëri dhe do të tregonte një mirënjohje për fuqitë që njohën të drejtën e ngritjes së flamurit kombëtar"*¹⁵⁶. Mirëpo për shkak të rrethanave të luftës, komandanti i forcave ushtarake austro-hungareze në Elbasan njoftoi Bashkinë e Elbasanit se në kohë lufte, veprimtari të tilla edhe në Austro-Hungari ishin të ndaluara për *"shkak të veprimeve ushtarake të qeverisurisë së Shqipërisë do të bëhet përkohshmërisht prej Ushtrisë së Mbretërisë së madhe të Austro-Hungarisë"*¹⁵⁷.

Rryma vidiste ekzistonte dhe vepronte në qytetin e Elbasanit, e cila kishte bindjen e plotë se Vidi dhe regjimi i tij u krijua, u mbështet dhe u njoh nga gjashtë Fuqitë e Mëdha, prandaj

¹⁵⁴ *Po aty*, fq. 73.

¹⁵⁵ *Elbasani Enciklopedi*, botim i Bashkisë së Qytetit Elbasan, Sejko, 2003, fq. 303.

¹⁵⁶ Kastriot Dervishi, *vepër e cituar* fq. 73

¹⁵⁷ *Elbasani Enciklopedi*, botim i Bashkisë së Qytetit Elbasan, Sejko, 2003, fq. 303.

ndërtimin e një administrate vidiste¹⁵⁸ në Shqipëri, pavarësisht rrethanave politike në të vendit, ai e konsideronte të domosdoshëm dhe të nevojshëm si shprehje e njohjes, zbatimit dhe respektimit nga shqiptarët të vendimeve të gjashtë Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër. Regjimi vidist do të gëzonte mbështetjen e përkrahjen e tyre, sepse *"ai vendim as nuk asht prishun, as nuk asht vjetruar...për me qënë mbështetë kërkesat tona mbi baza të shëndosha më duket tepër i nevojshëm që të kërkohet Shqipnia me forcën e vendimeve në Konferencën e Londrës, tue u ndreqë gabimet ose padrejtësitë që u banë atëherë në caktimin e kufijve....E kërkuenja për Shqipninë e një forme tjetër qeverimi, më duket shumë e rrezikshme, por asht edhe jashtë dëshirës të popullit... Pas mendjes sime duhet përpjekë që të ruhet Statu quo-ja (gjendja ekzistuese) e Shqipnisë në kohën e Mbretit dhe gjithë kërkesat të mbështeten mbi atë bazë, me lutje që kufijtë të çohen në qoket e natyrshme të tyre"*¹⁵⁹.

Më 23 janar 1917, komanda e korpusit XIX me anë të një proklamate drejtuar popullit shqiptar, shpallte autonominë kulturore të Shqipërisë, derisa të krijoheshin kushtet për vetadministrim.

Në fillim të vitit 1918, në Elbasan e në zonën e pushtimit, u gjallërua lëvizja për një Shqipëri të pavarur etnike dhe për rivendosjen e regjimit të Vidit. Nxitës i kësaj lëvizje të fuqishme u bë njoftimi në gazetën *"Noje Fraja Press"*, rreth botimit të Rizoffit, përfaqësues i Bullgarisë në Berlin. Në këtë botim shpreheshin synimet e Bullgarisë për aneksimin e

¹⁵⁸ Mentar Belegu, Hysen Kordha, Rudina Mita, *Aqif Pashë Elbasani (1860-1926), Përmbledhje dokumentesh*, Bashkia Elbasan, Tiranë 2012, fq. 296.

¹⁵⁹ Po aty, fq. 278.

trojeve shqiptare dhe sigurimin e një daljeje në Adriatik.¹⁶⁰ Në lidhje me këtë qytetarët e Elbasanit i dërguan një Memorandum proteste Korpskomandës së XIX në Shkodër kundër planeve aneksioniste bullgare dhe parashikuan të organizonin një manifestim politik në Elbasan, por autoritetet në zonën e pushtimit nuk i lejuan.¹⁶¹

Lëvizja e protestave u shndërrua, në Elbasan dhe në krahina të tjera në një lëvizje për rivendosjen e regjimit të Vidit.

*“Në Elbasan e në Fier... dhe në peticionet kolektive të bashkive të lokaliteteve më të rëndësishëm, u fut kontrabandë formulimi i legjitimitetit të mbretërisë së Vilhelmit të I-rë”.*¹⁶²

Agitacioni kryesor për Fon Vidin, vazhdonte konsulli Kral, nisej prej parisë së Elbasanit.

Organet e tjera *“dëshirojnë rikrijimin e Shqipërisë krejtësisht të pavarur nën mbretin e tyre të mëparshëm”*¹⁶³ Konsulli Kral kërkonte nga Ministria e Jashtme t'i jepte direktiva korpskomandës për qëndrimet që duhej të mbante ndaj diskutimeve e gjuhës politike që duhej të përdornin shqiptarët.¹⁶⁴ Konsulli Kral kërkonte të kufizonte kërkesat politike të shqiptarëve. Dëshira e shqiptarëve për rivendosjen e shtetit të pavarur shqiptar dhe bashkimin e krahinave etnike, ishte një aspiratë e përgjithshme kombëtare e patriotëve dhe intelektualëve shqiptarë dhe jo ambicie e interesa personale të nëpunësve dhe oficerëve shqiptarë, sikurse orvatej të justifikohesh konsulli Kral. Nga sa u tha më lart, del qartë se, kërkesa e patriotëve dhe e elbasanasve për rivendosjen e regjimit të Vidit, ishte për faktin

¹⁶⁰ *Po aty*, dok. 28-4-499, 14 mars 1918, Komanda e Qarkut Tiranës, Tiranë 17.2.1918.

¹⁶¹ *Po aty*.

¹⁶² A.I.H. (A.Vj.) dok. 28-32, Shkodër 1 mars 1918.

¹⁶³ *Po aty*.

¹⁶⁴ *Po aty*.

se ai personifikonte shtetin e mbretërinë shqiptare, të njohur e të garantuar para lufte nga Fuqitë e Mëdha. Kjo ishte arsyeja që, në Elbasan ishte vendosur të kremtohej 7 marsi i vitit 1918, gjë që nuk u lejua gjithashtu nuk u lejua edhe festimi i ditëlindjes së princit Fon Vid më 26 mars.¹⁶⁵

Shpresat që kishin pasur patriotë jo vetëm të Elbasanit, por edhe të tjerë se perandoria dualiste do të mbështeste Shtetin Shqiptar nën princ Vidin, u venitën.

Në fund të relacionit të tij, Kral insistonte të frenohej lëvizja Vidiste në Shqipëri, dhe rekomandonte të mos përmendej ai vetë dhe hollësitat konfidenciale të raportit të tij.¹⁶⁶

Marrëdhëniet politike midis patriotëve elbasanas dhe push-tuesve austro-hungarezë në zonën e pushtimit austro-hungarez, pra në Elbasan, vazhduan të ishin të ndera, derisa në shtator të vitit 1918 trupat austro-hungareze filluan tërheqjen nga Shqipëria. Vendin e tyre e zunë në muajin tetor 1918 forcat ushtarake italiane, franceze, greke e serbe.

¹⁶⁵ A.I.H. (A.Vj.) dok. 28-44, shtojca e raportit 25.03.1918.

¹⁶⁶ *Po aty*.

SEVDAIL DEMIRI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve
– Shkup*

DISA RELACIONE DIPLOMATIKE BULLGARE, PËR SHQIPËRINË DHE SHQIPTARËT, GJATË VITIT 1914

Bullgaria e cila ndër vendet e para e kishe njohur pavarësinë e Shqipërisë më 1912 dhe krijimin e shtetit shqiptar, po i përcillte me vigjilencë të shtuar të gjitha zhvillimet politike rreth Shqipërisë dhe trojeve shqiptare që kishin mbetur të pushtuar nga shtetet tjera, që nga luftërat ballkanike e deri në vigjilje të Luftës së Parë Botërore. Diplomacia bullgare, në politikën e saj të jashtme po mendohej të tregonte një lloj neutraliteti në aspekt të aspiratave territoriale ndaj Shqipërisë, pas një qasjeje deri diku pozitive karshi Shqipërisë në Konferencën e Londrës. Në prag të fillimit të Luftës së Parë Botërore, në Vlorë funksiononte Konsullata e përgjithshme bullgare, e cila drejtohej nga diplomati i njohur dhe me përvojë, Todor Pavlov. Kah mesi i vitit 1914, kjo zyre transferohet në Durrës, ku funksionon si Legatë mbretërore bullgare.

Nga zyra e diplomatit Pavlov, gati se për çdo ditë i drejtohehin informata ministrit të Jashtëm, përkatësisht kryeministrit të Bullgarisë, Vasil Radoslavov, i cili njoftohej në hollësi me të gjitha zhvillimet politiko—ushtarake në territoret shqiptare. Të gjitha raportet diplomatike bullgare nga Vlora apo Durrësi, sikurse edhe nga qendra e tjera të vendosjes, siç ishin Vjena, Bukureshti, Roma, Stambolli, Shën Pjetërburgu, e të tjera, e që kishin të bënin me fatin e Shqipërisë dhe shqiptarëve, janë

përkthyer në shqip dhe ruhen në Arkivin e Institutit të Historisë në Tiranë¹⁶⁷.

Në këtë punim, do të shqyrtojmë vetëm disa raporte të rëndësishme konsullore bullgare, që kanë të bëjnë me Shqipërinë dhe shqiptarët gjatë vitit kalendarik 1914.

Në këtë kohë, Shqipëria ishte në gjendje të mjerueshme. E lodhur nga luftërat ballkanike, e pushtuar nga ushtritë fqinje greke, serbe e malazeze, dhe pa një qeverisje të mirëfilltë shqiptare, pas dorëheqjes së Qeverisë së Vlorës, e cila më 22 janar 1914, pushtetin ia kaloi Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, i cili duhej që të priste ardhjen e Princ Vidit në Shqipëri. Në këtë kohë, hapësirë të mjaftueshme manovrini kishin gjetur forcat antikombëtare të udhëhequra nga Esat pashë Toptani, të cilat bashkëpunonin me Romën, Stambollin dhe Beogradin, në kundërshtim me interesat e Shqipërisë dhe shqiptarëve.

Diplomati bullgar në Vjenë, Sallabashev, më 8 janar 1914 i dërgon një telegram ministrit të Jashtëm të vendit të tij, Radosllavov, ku e njofton lidhur me takimin që kishte pasur me ambasadorin turk Hilmi pasha. Sipas këtij të fundit, Esat pasha ka pasur për qëllim të vërë Izet pashën në Shqipëri, pastaj të shpallte veten si princ: “*Hilmi pasha mendon se Shqipëria, që përbëhet nga 30 fise, me krerë të ndryshëm trashëgimtarë, nuk është e aftë për vetëqeverisje me Vidin, as me Esat pashën, dhe se herët ose vonë Austria dhe Italia do ta shtinë në dorë dhe do ta ndajnë*”¹⁶⁸.

Ndërkohë, më 12 janar, konsulli bullgar në Vlorë, Pavlllov, njoftonte se “*Myfit beu nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, kishte shkuar të bindë Esatin të jep dorëheqjen dhe*

¹⁶⁷ AIH, IV, 271, nr.inv. 967

¹⁶⁸ AIH, IV, 271, nr.inv. 967, fq.3

*t'ia dorëzonte pushtetin Komisionit, por u kthye pa ia arritur qëllimit; Esati nuk pranoi*¹⁶⁹. Ndërsa, në raportin e 18 janarit, Pavlllov njoftonte shtetin e vet se: “*Delegati anglez dhe gjerman pranë Komisionit të Kontrollit, u nisën për në Durrës që t'i propozojnë përsëri Esat pashës të jep dorëheqjen. Në qoftë se Esati nuk do të pranojë, thuhet se do të përdoren forca.*”¹⁷⁰

Më tej diplomati Pavlllov, thotë se “*Kur isha në Durrës, munda të marr vesh se Esati nuk do të bindet në asnjë mënyrë të heq dorë nga pushteti, dhe do të kundërshtojë, bile edhe me armë. Ai do të punonte të formojë në Durrës një kabinet, në të cilin do të mbetej ministër i Luftës, por delegatët duket se nuk janë të predispozuar të pranojnë një kërkesë të tillë*”¹⁷¹.

Megjithatë, në telegramin e 24 janarit mësojmë se “*Esati ka pranuar të jep dorëheqjen, me kusht që të jetë kryetar i delegacionit, i cili do të shkojë për t'i propozuar fronin e Shqipërisë princ Vidit, dhe të lëshojë pushtetin në ditën e nisjes së tij në Durrës*”¹⁷². Në këtë aspekt, diplomati bullgar Pavlllov,

parashikoi me saktësi dhe profesionalizëm, kur vlerësoi se “*Këtu Esati ka vepruar në mënyrë dinake, pasi ka siguruar qëndrimin në fuqi, derisa të afrohet dita e ardhjes së princit*”¹⁷³.

Më 28 janar 1914, legata bullgare në Romë, përmes diplomatit Rizov, njofton Sofjen se lajmi për Princ Vidin është pritur shumë mirë në Shqipëri, dhe se Austria dhe Italia i japin atij menjëherë dy milionë, që të mund të niset për në Shqipëri pas 10–12 ditësh¹⁷⁴. Po më 28 janar, Pavlllov nga Vlora njofton se: “*Sot anëtarët e Komisionit të Kontrollit u nisën për në*

¹⁶⁹ Po aty, fq.4

¹⁷⁰ AIH, IV, 271, nr.inv. 967, fq.7

¹⁷¹ Po aty

¹⁷² Po aty, fq.10

¹⁷³ Po aty

¹⁷⁴ Po aty, fq.11

*Durrës. Pritet të nesërmen të niset Esati në krye të delegacionit shqiptar për në Postdam. Ndërkohë, rreth 400 shqiptarë kanë bërë këtu mbrëmë një demonstratë kundër veprimeve të grekëve në Shqipërinë jugore. Ata u lutën Fuqive të Mëdha të detyrojnë Greqinë të zbrazë menjëherë krahinat e pushtuara shqiptare*¹⁷⁵. Po kështu, një ditë më vonë, Pavlllov raporton se paria shqiptare e Korçës dhe e Gjirokastrës i kanë dërguar mbrëmë këtë telegram princ Vidit në Romë: “*Mësuam me habi dhe pikëllim se ndikimi dinastik po ushtrohet sot për një ratifikim të kufijve jugorë në favor të Greqisë. Shqipëria nuk mund të durojë gjymtime të tjera, pasi ka humbur një milion bij të saj në veri dhe në jug, dhe prandaj i lutemi madhërisë suaj të bëni ç’është e mundur nga fatkeqësi të reja*”¹⁷⁶.

Në telegramin e 3 shkurtit, Pavlllov njofton se nga Holanda kanë ardhur dhjetë oficerë të rinj për xhandarmërinë. Kurse, Mitropoliti grek i Beratit, kërkon nga Komisioni i Kontrollit, hapjen e shkollave greke¹⁷⁷.

Në këtë kohë, grekët kishin pushtuar një pjesë të madhe të Shqipërisë jugore, ku kishin bërë dëme të mëdha, dhe pretendonin që atë pjesë që e quanin “Vorio Epir”, e kishin shpallur “Republikë Autonome të Epirit të Veriut”¹⁷⁸. Kështu, më 16 shkurt 1914, Pavlllov njofton Sofjen se ish-ministri i jashtëm i Greqisë, Jorgo Zografos, u ka dërguar mbrëmë nga Gjirokastra këtë telegram Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit: “*Të*

¹⁷⁵ Po aty, fq.12

¹⁷⁶ Po aty

¹⁷⁷ Po aty, fq.20

¹⁷⁸ Kjo “republikë” e vetëshpallur nga minoriteti grek më 14 shkurt 1914, krijoi një të ashtuquajtur qeveri në Gjirokastrë, me kryeministër Jorgo Zografon. Protokolli i Korfuzit e njohu këtë tokë si njësi autonome nën sovranitetin e Shqipërisë, por ai u anulua nga Konferenca e Ambasadorëve në vitin 1921.

gjithë popujt kanë të drejtë për ekzistencë të pavarur politike... Epirotët kanë shpallur pavarësinë e Epirit. Është formuar në Gjirokastrë ‘Qeveria e përkohshme’ nën kryesinë time. Duke ju njoftuar për këtë, lutem të urdhërohet nga ana juaj xhandarmëria shqiptare që mos hyjë në rajonin e Epirit të pavarur. Çdo orvatje për pushtimin e çfarëdo pjese të Epirit, konsiderohet si akt armiqësor’¹⁷⁹.

Telegrami i përcjellë nga diplomati bullgar nga Konsullata në Vlorë, z. Malishev, jep një bisedë interesante që ia kishte transmetuar anëtari i Komisionit Ndërkombëtar ë Kontrollit, Myfit beu, pas takimit me konsullin e përgjithshëm serb, Gavrilloviq. *“Duke folur për gjendjen në Shqipëri e Maqedoni, z.Gavrilloviq, ia ka deklaruar bashkëfolësit të tij, se qeveria serbe kishte vendosur të shuante me masat më rrepta, çdo orvatje kryengritëse të shqiptarëve ose bullgarëve në Maqedoni. Ai shtoi se ishte në dijeni që konsulli i përgjithshëm bullgar, z.Pavillov ishte dërguar këtu të vepronte së bashku me Myfit beun, Hasan beun, Isa Boletinin e krerë të tjerë, për të përgatitur kryengritjen e përgjithshme bullgaro-shqiptare në Maqedoni dhe Kosovë, por Serbia sot është shtet më i fuqishëm në Ballkan, dhe kishte vendosur të mbyste me gjak dhe zjarr krejt Maqedoninë dhe Kosovën, dhe kishte vendosur ta mposhte edhe Shqipërinë e lirë... I indinjuar nga kjo gjuhë brutale, provokuese dhe aspak diplomatike e diplomatit serb, Myfit beu ishte përgjigjur se nuk dinte se çfarë planesh përgatisnin për të ardhmen shqiptarët dhe bullgarët, por se për një gjë mund ta siguronte z.Gavrilloviqin, se: Në qoftë se turqit gjatë pesë shekujve, nuk mundën të shfárosin me zjarr dhe shpatë, qoftë shqiptarët, qoftë bullgarët, qoftë serbët, aq*

¹⁷⁹ AIH, IV, 271, nr.inv. 967, fq.21

më pak mund të besohet se në kohën e sotme Serbia me po ato mjete do të mund të shfërosë një popull. Paqe nuk do të ketë në qoftë se ju nuk do të pushoni të flisni për zjarr dhe shpatë, dhe në qoftë se vazhdoni një politikë dhune kundrejt kombësive joserbe në Maqedoni”¹⁸⁰.

Në ndërkohë, edhe Italia fillon në praktikë të tregojë apetitet e saj territoriale ndaj Shqipërisë, me pretekst të ndihmës për lirim e Shqipërisë jugore nga grekët. Në telegramin e shifruar nga Legata bullgare në Romë, e nënshkruar nga diplomati Rizov, më 24 mars 1914, lexojmë: “*Ministria e Punëve të Jashtme e Italisë, ka marrë konfirmim për mobilizim në Shqipëri, por është e dyshimtë nëse do të mund të mbledhen 20.000 vetët e nevojshëm. Ajo e konsideron gjendjen të rrezikshme. Pavarësisht se a do të mund të bëhet mobilizimi dhe të dalë me sukses ekspedita, dhe në qoftë se kjo del me sukses nën kryesinë e Esat pashës, në çdo rast, princ Vidi do të mund të komprometohet, dhe në Shqipëri mund të ketë edhe anarki”¹⁸¹.*

Në telegramin e Pavlovit më 26 mars, merret vesh se: “*Në Korçë, orvatja e epirotëve të teptilosur për të shkaktuar turbullira, është neutralizuar. Midis të vlarëve figurojnë 5 ushtarë grekë me uniforma. Dokumentet e zënë e njollosin nitropolitin grek të vendit...”¹⁸².*

Telegrami i 17 prillit 1914, i konsullit të përgjithshëm bullgar në Vlorë, Todor Pavlov, flet me shumë interes për ndihmën e disa bullgarëve në Shqipëri, të cilët përmes dhënies së informacioneve autoriteteve shqiptare, arritën që ta neutralizojnë planin grek për sulmin dhe futjen në dorë të qytetit të Korçës. Në të vërtetë, “*Pas marrjes së qytetit të Korçës prej ushtarëve*

¹⁸⁰ Po aty, fq.22

¹⁸¹ Po aty, fq.26

¹⁸² Po aty, fq.28

grekë më 16 shkurt, dhe rimarrjes së tij prej xhandarmërisë shqiptare, disa oficerë dhe qindra ushtarë qëndruan në qytet, të fshehur nëpër shtëpi të ndryshme grekomanësh. Në fillim të marsit, një pjesë e madhe e njësisë të xhandarmërisë që gjendeshin në qytet, shkuan u larguan nga Korça dhe shkuan për të marrë vendet e tjera të zbrazura nga grekët. Në këtë kohë në Korçë mbetën rreth 120 xhandarë. Por pikërisht në këtë kohë, grekët lokalë hartojnë plane për të sulmuar befash qytetin e Korçës. Sipas këtij plani, oficerët, ushtarët dhe kryengritësit grekë të fshehur në qytet, natën e 24 marsit duhej të sulmonin befash kazernat, dhe të vrisnin ose zinin rob njësinë. Njëkohësisht, rreth 600 kryengritësish grekomanë, duhej të sulmonin qytetin dhe të shpallnin bashkimin e Korçës me Epirin autonom... Por ky plan, u neutralizua në këtë mënyrë: Në fillim të muajit mars, arriti në Durrës një bullgar nga Kosturi, i cili u tregoi bullgarëve tanë atje se në vaporin që do ta çonte në Trieste, dhe prej atje në Amerikë, ishte njohur me shumë grekë, të cilëve u ishte paraqitur si grek. Ata i thanë në besim se për së shpejti Korça do të binte në duart e grekëve, duke i treguar madje edhe datën e sulmit dhe pushtimit të qytetit (24 mars). Kur e mori vesh këtë bullgari, vendosi të zbresë në Durrës dhe të tregojë punën. Me anën e bullgarëve që gjendeshin atje, qeveria shqiptare u vu në dijeni për planin e përgatitur.”¹⁸³ Më tej telegrami përshkruan në hollësi gjithë aksionin e forcave shqiptare për neutralizimin e kryengritjes grekomane në Korçë, derisa këta të fundit detyrohen ta ngritin flamurin e bardhë. Por, pabesia e grekëve tregohet edhe në momentin kur majori holandez drejtohet drejt shtëpisë ku ishte ngritur flamuri i bardhë. Atëherë grekët gjuajnë dhe

¹⁸³ AIH, IV, 271, nr.inv. 967, fq.31-32

plagosin tre xhandarë shqiptarë dhe majorin holandez Shne-len. Të zemëruar nga ky sulm i poshtër, shqiptarët sulen kundër grekëve të mbyllur në shtëpi, dogjën tri shtëpi dhe vranë qindra vetë. Të nesërmen u arrestuan shumë grekë në qytet, ndërsa populli u çarmatos. Ndërkohë, *“Lajmet nga pjesët tjera të Epirit e paraqesin gjendjen e shqiptarëve shumë të vajtueshme: çdo ditë vijnë muhaxhirë që tregojnë për plaçkitje, shkre-tërimë, djegie fshatrash e të tjera, arrestime në masë, rrahje dhe vrasje”*¹⁸⁴.

Më tej telegrami bën me dije se qeveria shqiptare po përgatitë një ekspeditë të fortë prej 15–20 vetash në Epir. Për këtë, në Durrës kanë arritur 20 mijë pushkë nga Italia dhe 36 topa 16 milimetërshe nga Austria. *“Ministri Hasan beu dhe të tjerë sigurojnë se këto armë dhe municionet nuk janë porositur kundrejt 10 milionëve që janë dhënë si paradhënie, por janë njëfarë dhurate nga Austria dhe Italia... Pas dorëzimit të notës kolektive përkatëse nga Fuqitë e Mëdha në Athinë, qeveria greke ka urdhëruar menjëherë ushtritë në disa vende të Epirit që të tërhiqen. Kështu, për shembull mbrëmë komandanti i njësisë greke në Tepelenë, ka thirrur komandantin shqiptar të vijë dhe të marrë në dorëzim qytetin”*¹⁸⁵.

Edhe në raportin e 29 prillit, nga Vlora, të konsullit Pavllov, theksohet se të gjithalajmet që vijnë nga jugu, flasin për shkre-tërimë të tmerrshme dhe mizori të padëgjua: *“Fshatra të tëra janë bërë shkrumb e hi, dhe shumica e banorëve janë therrur, djegur ose kryqëzuar në kryq... Midis dy popujve fqinj është hapur një humnerë e madhe, dhe se urrejtja e përgjakshme do të përçajë për një kohë të gjatë Greqinë dhe Shqipërinë. Problemi Epir do të ndihmojë në një shkallë të madhe në*

¹⁸⁴ Po aty

¹⁸⁵ Po aty, fq.31-33

*ngritjen e moralit dhe të vetëdijes kombëtare te shqiptarët, Shumë nga ata shqiptarë toskë, që deri vonë anonin kah Greqia dhe nga çdo gjë greke, tani janë bërë nacionalistë të tërbuar*¹⁸⁶.

Më tej, në raportin bullgar të 4 majit, njoftohet për arritjen e marrëveshjes midis qeverisë dhe kreut të mirditasve, Bib Dodës, për të marrë pjesë ky i fundit me 2.000 njerëz të tij në veprimet luftarake kundër epirotëve grekë. Është kontraktuar që për çdo vullnetarë, qeveria të paguante nga 60 franga në muaj.

Në dy telegramet e lëshuara më 5 maj 1914, informohet për trazira kundër qeverisë së Esat pashës në Tiranë dhe qytetet përreth, nën agjitacionin austriak, që për pasojë kishin dorëheqjen e Esat pashës.

Ndërsa, më 6 maj telegrami i Pavllovit bën me dije se: “*Sot në orën 4, nacionalistë shqiptarë të armatosur, të ndihmuar nga xhandarmëria dhe policia, sulmuan shtëpinë e Esat pashës. Topat ekomanduar nga oficerët austriakë, hodhën 7 granata mbi shtëpi, e cila pjesërisht është dëmtuar. Pas 10 minutave, Esati u kap dhe u çua kryqëzorin austriak. Ka një të vrarë dhe dy të plagosur. Marinarët italianë dhe austriakëruajnë pallatin, dy legatat dhe postën. Ministrat kanë dhënë dorëheqjen. Kabineti i ri nuk është formuar akoma. Miting patriotik kundër grekëve, serbëve, malazezëve dhe turqve, vegla të Esat pashës dhe bejlerëve. Ka baza për të besuar se Princi e ka organizuar kryengritjen me ndihmën e austriakëve, për të qëruar me Esatin*”¹⁸⁷.

Më tej, raporti i 7 majit 1914, flet për ankesën e delegatit austro-hungarez pranë Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit, z. Kral, sipas të cilit, disa shqiptarë ishin ankuar për sjelljen e autoriteteve bullgare kundrejt shqiptarëve që jetojnë

¹⁸⁶ Po aty, fq.37

¹⁸⁷ Po aty, fq.41

në Bullgari. Sipas fjalëve të tij, qeveria bullgare nuk i lejonte shqiptarët e vendosur në Bullgari të kthehen në Shqipëri, i merrte me zor ushtarët, etj.

Raporti i 8 majit nga Legata në Vjenë, e nënshkruar nga diplomati bullgar Pasarov, rrëfen për vizitën e Turhan pashës në Vjenë. *“Turhan pasha falënderoj me fjalë të përzemërta për ndjenjat mirëdashëse dhe miqësore të Bullgarisë kundrejt Shqipërisë. Qeveria bullgare dorëzoi e pra përfaqësuesin diplomatik në Shqipëri, dhe tani e ka bërë Konsullatën e përgjithshme në Legatë... Bullgarët në Shqipëri do të gëzojnë të gjitha të drejtat, do të trajtohen si vëllezër...”*¹⁸⁸.

Kurse, telegrami i shifruar që vinte nga Legata mbretërore bullare në Londër, më 13 maj 1914, tregon për një dëshpërim të Fuqive të mëdha kundrejt fatit të Shqipërisë, dhe flet për mundësinë e ndajrës së Shqipërisë nga vendet fqinje. *“Anglia, e cila më parë mbronte me zellin më të madh autonominë e Shqipërisë, ka filluar të lëkundet dhe të mos besojë në aftësinë për jetë të popullit shqiptar... Në qoftë se bëhet ndarja, Bullgaria duhet të kompensohet dhe kjo gjë mund të bëhet me ndihmën e Fuqive të mëdha, të cilat favorizojnë ndarjen e Shqipërisë”*¹⁸⁹.

Raporti i radhës i Pavllovit nga Durrësi, i lëshuar më 7 maj 1914, flet për emigrimin masiv të shqiptarëve drejt Anadollit. Sipas konsullit, nëpërmes Shkupit, çdo muaj emigrojnë mesatarisht nga 1.000 familje, që vijnë nga Tetova, Ferizaj, Prishtina, Novi Pazari, Mitrovica dhe Vushtrria. Llogaritet se dyndjet nga krejt “Serbia e re”, arrijnë deri në 3.000 familje në muaj. Duke llogaritur se çdo familje ka mesatarisht 5 frymë,

¹⁸⁸ Po aty, fq.42

¹⁸⁹ Po aty, fq.44

del se nga ky territor çdo muaj shpërngulen nga 15 mijë frymë ose 180 mijë frymë në vit¹⁹⁰.

Në telegramin e radhës dërguar më 16 maj 1914, Pavllov njofton për ngjarjen e një dite më parë, kur austriakët kishin arrestuar Esat Pashë Toptanin. Sipas raportit, “*në agim, një grup nacionalistësh, kundërshtarë të qeverisë, të ndihmuar nga xhandarmëria nën komandën e tre oficerëve holandezë, dhe me përkrahjen e 8 topave malorë të ardhur nga Austria, sulmuan shtëpinë e Esad Pashës, të cilin pas një përpjekje të shkurtër, e kapën dhe në orën 8 e gjysmë të paradites, e çuan në një anije austriake që gjendej në port*”¹⁹¹.

Telegrami i shifruar, i nisur në Sofje nga Legata mbretërore e Bukureshtit, nga diplomati Radev, njofton se: “*Baroni italian i tha sot atasheut ushtarak, se as që mund të bisedohet që Greqia t’i bëhet zot i kanalit të Korfuzit. Ministri vuri në dukje se Italia nuk ka qëllimet pushtuese, por një okupacion nuk përjashtohet, në qoftë se provohet se një Shqipëri e pavarur është e pamundur*”¹⁹².

Kah mesi i muajit maj 1914, regjistroheshin disa rebelime antiqeveritare në qytetet e Tiranës, Shijakut, Kavajës dhe Peqinit, herë–herë të njohura ndryshe si Kryengritje e Shqipërisë së Mesme. Përkrahësit e Turqisë, me synimin për sjelljen e një princi turk në krye të Shqipërisë (Turhan pashës), përmes revoltave kishin arritur që në këto qytete të dëbonin dhunshëm udhëheqjet komunale, të hiqnin flamujt shqiptar nga shtizat para administratave komunale, dhe në vend të tyre të valëvisnin flamurin turk. Me qëllim të neutralizimit të këtyre grupeve, bëheshin plane rikthimin e rendit dhe qetësisë publike.

¹⁹⁰ Po aty, fq.49

¹⁹¹ Po aty, fq.54

¹⁹² Po aty, fq.98

Ndërkohë, raporti që vinte nga Legata bullgare në Perterburg të Rusisë, më 24 maj, njoftonte për përmbajtjen e shtypit rus, i cili fliste për ndarjen e Shqipërisë: “*Flet për ngritjen e çështjes së formimit të një province thjeshtë myslimane nga Shqipëria qendrore, mbase ajo veriore do të bashkohet me Malin e Zi dhe Serbinë, duke iu dhënë kësaj të fundit dalje në Adriatik. Epiri do t’i jepet Greqisë. Supozohet se në këto kushte neve (bullgarëve, S.D.), mund të na jepet Drama, Kavalla, Seresi, ndërsa nga Serbia do të na lëshohet Shtipi, duke arritur kufiri ynë vardarin dhe Pçinjen?*”¹⁹³.

Ndërkohë, telegrami i shifruar i 9 qershorit nga Legata bullgare në Vjenë, i nënshkruar nga diplomati Stançov, informon për takimin e tij me kontin Berthold, i cili hedh poshtë zërat për mundësinë e ndarjes së Shqipërisë nga vendet ballkanike. Në raport thuhet, “*për sa i përket Shqipërisë, konti mendon, aq sa mund të parashikohet, se nuk përjashtohet që të ruhet pozita e princ Vidit, dhe ai do të punojë pikërisht në atë drejtim. Për sa u përket zërave në lidhje me ndarjen e Shqipërisë, ministri i konsideron si gjëra të kurdisura para kohe nga ata që kanë interes për këtë*”¹⁹⁴.

Në raportin e radhës të 10 qershorit, Pavlov në tri faqe përshkruan gjendjen kaotike që mbretëron në shumë pjesë të Shqipërisë, si rezultat i aktiviteteve të kryengritësve të Shqipërisë së Mesme, si dhe sulmeve të herëpashershme të ushtrive të huaja, derisa veprimtaria e Princ Vidit duke tejet e minimizuar karshi situatës. “*Në këtë gjendje, duket se edhe një tërheqje e princit nuk do të çonte me siguri në pajtim: Thuajse krejt vendi është në anarki të plotë, qeveria është e pafuqishme, dhe ndikimi i princit vetëm mund ta shtojë kaosin. Herët ose vonë do të*

¹⁹³ Po aty, fq.114

¹⁹⁴ Po aty, fq.88

*nevojitet një fuqi e organizuar ndërkombëtare ose tjetër, për të spastruar terrenin dhe për të vendosur rendin në vend*¹⁹⁵.

Drejtuesi i Legatës bullgare në Vlorë, në telegramin e 8 qershorit 1914, informon në lidhje me audiencën 35 minutëshe me Princ Vidin në pallatin e tij. Pos bisedës lidhur me bashkëpunimin Shqipëri–Greqi, princi kishte pranuar se gjendja në vend ishte shumë e vështirë: *“Ai e konsideronte gjendjen njafat të vështirë, dhe se vendi është duke kaluar një krizë të rëndë. Por, Madhëria e tij mendon se populli është i pafajshëm, dhe nuk ka dorë në këto turbullira, se të gjitha shqetësimet dhe vështirësitë dalin nga nxitësit, të cilët shfrytëzojnë naivitetin dhe ndjenjat fetare të popullit shqiptarë*¹⁹⁶.

Në telegramin e shifruar të Pavllovit, lëshuar më 17 qershor, thuhet: *“Qeveria rumune nuk ka pranuar të dërgojë ushtri në Shqipëri. Sot arritën 20 vullnetarë nga Austria. Për shkak të protestës së Italisë, qeveria austriake ka ndaluar mbledhjen e vullnetarëve për Shqipëri. Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, më njoftoi se epirotët kanë sulmuar përsëri dhe kanë pushtuar Tepelenën. Qeveria serbe ka kërkuar ekzekuturën për konsullin në Shkodër*¹⁹⁷.

Një raport të gjatë rreth gjendjes në Shqipëri, jep edhe drejtuesi i Legatës bullgare në Stamboll, z. Toshev, i cili njofton për informatat e marra nga takimi i tij me të dërguarin e Italisë: *“Kur erdhi fjala për çështjen e Shqipërisë, markezi Garoni vuri në dukje në mënyrë të posaçme faktin se Serbia dhe Greqia përpiqeshin në çdo mënyrë për të arritur në ndarjen e principatës së re. Në të vërtetë, si Italia, ashtu edhe Austria, ishin të vendosura të mos lejonin një ndarje të këtillë, por*

¹⁹⁵ Po aty, fq.95

¹⁹⁶ Po aty, fq.117

¹⁹⁷ Po aty, fq.97

*edhe grekët dhe serbët nuk duken më pak të vendosur për të shfrytëzuar gjendjen e tanishme të ngatërruar në Shqipëri. Por këtë mund ta paguanin shtrenjtë një ditë... Kur e pyeta a ka mundësi të bëhet ndarja e Shqipërisë nga Italia dhe Austria, z.ministër m'u përgjigj negativisht*¹⁹⁸.

Në letrën personale të diplomatit bullgar në Stamboll, A.To-shev, dërguar kryeministrit bullgar më 12 gusht 1914, theksohet se qeveria turke ka vendosur të dërgojë në Shqipëri disa delegatë, për të njoftuar komunitetin mysliman shqiptar, se duhej ndaluar lufta kundër Princ Vedit. Po ashtu, sipas një informate tjetër me interes: *"Konsulli gjerman në Shkodër i ka deklaruar komitetit shqiptar, se armët e përdorura deri tani kundër Princ Vedit, duhet të drejtohen kundër Serbisë"*¹⁹⁹.

Më tej, në disa telegrame, kryeministri bullgar Dr.Radosllavov, kërkon informacione të ndryshme shtesë nga legatat dhe konsullatat e tyre, lidhur me zhvillimet në Shqipëri, dhe ndërlidhjen e interesave bullgare në çështjen shqiptare. Kështu p.sh., në letrën e 17 tetorit 1914, Radosllavov thotë se: *"Sipas informatave nga Roma, pushtimi i Vlorës është bërë me pëlqimin e Gjermanisë dhe Austrisë. Sipas burimeve tjera, pushtimi i Epirit dhe Vlorës është bërë me pëlqimin Marrëveshjes Tripalëshe (?)... Përpiquni të mësoni të vërtetën!"*.

Relacionet diplomatike bullgare janë të një rëndësie të veçantë në zbardhjen e shumë situatave të paqarta dhe konfliktuoze që mbretëruan në Shqipëri dhe trojet tjera shqiptare në prag dhe gjatë Luftës së Parë Botërore. Ato janë një burim shumë i rëndësishëm arkivor, dhe një ndihmesë e pakrahasueshme ndaj historiografisë shqiptare, për të plotësuar mozaikun e faktografisë shkencore për këtë periudhë të ndjeshme historike.

¹⁹⁸ Po aty, fq.100

¹⁹⁹ Po aty, fq.119

BEDRI TAHIRI

Vushtrri, Kosovë

VEPRIMTARIA LUFTARAKE E AZEM GALICËS GJATË LUFTËS SË PARË BOTËRORE

Lufta e Parë Botërore (1814– 1918), trojet shqiptare, në përgjithësi dhe ato të mbetura jashtë Shqipërisë londineze, në vëçanti, i gjeti të katandisura fare. Kudo, mjerim, varfëri, shtypje, tortura, mizori, burgosje e vrasje masive.

Megjithatë, pushkët e lirisë nuk pushonin këngën e tyre. Rezistenca e pandërprerë kundër osmanllinjve dhe kundër serbo-malazezve i kishte çfilitur shqiptarët e Kosovës. As ardhja e pushuesve të rinj, austrohungarezëve e bullgarëve, nuk solli ditë të bardha. Dhe, shqiptarët, edhe pse përfituan ndonjë të mirë, kryesisht në fushën e arsimit, nuk i hoqën armët nga dora.

Në këtë mes, si përherë, prijëtare qe Drenica. Kryetrimi i saj, Azem Galica, u shqua me aktivitete të shumta luftarake e organizative. Ai, që kur u arratis nga burgjet e Serbisë, dhe austriakët ia pushkatuan dy vëllezërit: Seferin e Zenelin, nuk pushoi së vepruari për lirinë e trojeve stërgjyshore. Betejat në Galicë, në Mikushnicë, në Obri, në Rakinice, në Kllodërnice e sidomos në Bajë, ku vritet edhe Shaqir Smaka, ua futën tmerrin austrohungarezëve e bullgarëve, saqë, në Përrua të Keq, rreth dymijë ushtarë austrohungarezë i dorëzohen Azem Galicës, kur nuk kishte me vete më shumë se dhjetë luftëtarë. Gjatë kësaj periudhe, Azem Galica e Hasan Prishtina, krahas luftës së amatosur, punuan edhe në hapjen e shkollave shqipe. Ata i vunë fre edhe të një të keqeje të madhe të atyre viteve;

rekrutimit të të rinjve shqiptarë (“gjinlive”–“vullnetraëve”) për në frontet ruso–turke, duke formuar njëherësh çetat e lirisë dhe Ushtrinë e Hasan Prishtinës.

Azem Galicën nuk e dmoralizoi as tradhtia e Kostë Vojvodaës. Përkundrazi, u mobilizua dhe organizoi luftëra e beteja të reja, ngase Komiteti i Shkodrës e kishte emëruar Komandant të të gjitha çetave e grupeve çlirimtare, që në fundvitin 1919 numëronin mbi dhjetë mijë luftëtarë.

Pra, Azem Galica mbetet figura qëndrore luftarake e organizative e luftës për liri e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Parë Botërore.

Djaloshi në rrugën e babait

Me vrasjen e Bejtë Galicës, në betejën kundër Shemsi Pashës, në Deviç, më 1907, nuk u shua rezistenca e armatosur në familjen Galica të Galicës heroike. Rrugën e tij do ta vazhdojnë të bijtë, sidomos djali i tretë, Azemi.

Azem Bejtë Galica u lind më 10 dhjetor 1889. I rritur në gjirin e një familje me tradita luftarake e atdhetare, që nga fillimi u përcaktua në rrugën e lavdisë. Tiparet e një trimi të paepur dhe të një vizionari të mprehtë u manifestuan që në rininë e tij të hershme. Si i vogël dallohej nga moshatarët. Ishte i zgjuar e i shkathët. Por, mbi të gjitha, atë e cilësonin trimëria dhe guximi. Ende pa i mbushur 11 vjet me pushkën e dajës, vrau një serb të Selacit, (Stojanin) të cilit ia kishin frikën të gjithë.

Gjatë viteve 1910–1912 shpërthyen kryengritjet e përgjithshme për pavarësinë e tokave shqiptare. Më 5 maj 1912, Hasan Prishtina doli në Drenicë dhe dha kushtimin për një luftë mbarëkombëtare kundër Perandorisë Osmane.

Edhe Azemi 20–vjeçar, u radhit në çetat kryengritëse të Drenicës, të udhëhequra nga Ahmet Delia i Prekazit. Kur

drenicarët dhe shaljanët ishin nisur për luftë përbri tyre marshonte Isa Boletini, hipur mbi kalë e i shoqëruar nga shumë trima. Në mesin e tyre i ra në sy djaloshi sypatrembur e i etshëm për luftë.

– *I kujt është ai djalë?* – pyeti Isa Boletini

– *I biri i Bejtë Galicës, Azemi* – iu përgjigj njëri nga trimat që e shoqëronte²⁰⁰.

E ngau kalin dhe iu afrua. Pasi u përshëndet me të ia vuri dorën në krah dhe e përgëzoi:

– *Të lumtë, ore djalosh trim. Ti paske vendosur ta dërgosh në vend amanetin e babait tënd, ta vazhdosh rrugën e tij luftarake...*

Azem Bejtë Galica mori pjesë edhe në luftën e Merdarit. Pjesëmarrësi i asaj beteje, togeri i ushtrisë vullnetare shqiptare, Hamëz Shtrubullova, tregonte: *”Trimi ma i madh në luftë të Merdarit ishte djaloshi 21 vjeçar Azem Bejta, i biri i Bejtë Galicës. Me zanin e tij të fortë dhe me përdorimin e pakrahasuar të armës, na dha shpresë se armiku do të thehet. Por, papritmas, ni valë e madhe e ushtrisë së Kral Petrit, ra mbi ne, sikur vala e Detit të Zi. Më kujtohet kur Azemi, me ni grup shokësh moshatar, janë tërhequr, në drejtim të Shalës së Bajgorës. Pas dy ditësh, kuptuam se ishte strehuar te daja i vet, Kurt Selaci...”*²⁰¹

Posa ishte kthyer nga betejat që arrestuar dhe burgosur bashkë me dy vëllezërit: Seferin e Zenelin dhe me disa të rinj nga Drenica. Për tri vjet rresht qëndruan në Zajëçar, përkatësisht në Pozharevc, në burgun më të rëndë të kohës. Në burg jeta ishte e mjerueshme, por Azemi ishte optimist dhe mbante qëndrim burrëror. Kurrë nuk u gjunjëzua as nuk u zhgënjye.

²⁰⁰ Ajet Haxhiu, *Shota dhe Azem Galica, Tiranë, 1976, f. 18*

²⁰¹ Dr.Mehmet Rukiqi, *Azem Galica, Prishtinë, 2013, f. 51*

Në zemrën e tij kishte zënë vend dashuria për Kosovën, e cila ishte shndërruar në një ideal të pashuar jetësor. Gjithnjë shpresonte se një ditë do të kthehet në Kosovë dhe do ta vazhdonte luftën për çlirimin dhe pavarësimin e trojeve të veta...

Formimi i Çetës kreshnike, që u quajt Nëna e çetave

Dhe, ajo ditë e bardhë agoi. U këputën prangat, u shkallmuan dyert, u mbytën rojet dhe, u kapërcyen telat. Trimi vetë i shtati u gjend i lirë në trojet stërgjyshore që po lëngonin në robëri. Ishte pranvera e vitit 1915.

Azem Galica, pa humbur kohë, ende pa kaluar muaji, me dy vëllezërit dhe me disa trima nga fshatrat përreth u grumbulluan në Galicë, nën hijën e Qarrit qindravjeçar (*Lisi i Vorrevë*), mbi sofrën e mbuluar me flamurin kuqezi, që Nënë Sherifja e kishte ruajtur në fund të arkës së nunsërisë, formuan bërthamën e çetës kreshnike, duke u betuar: “*Betohemi në këtë flamur të shenjtë se sa të jemi gjallë do të luftojmë për lirinë e këtyre trojeve. Betohemi dhe bëjmë be se për Kosovën japim jetën sikur me le*”²⁰². Në këtë çetë bënte pjesë edhe *Nusja e Maleve* – Shotë Galica, me të cilën Azemi posa ishte martuar. Në fund të vitit 1915 ushtritë serbo-malazeze u thyen nga forcat austro-hungareze e bullgare. Shqiptarët, si zakonisht, edhe këta pushtues i pritën me armë në dorë. Grupe dhe çeta të vogla i sulmonin stacionet dhe patrullat e xhandarmërisë duke u shkaktuar humbje të konsiderueshme.

Gjatë kësaj kohe paraqitet edhe një dukuri që shqiptarëve u kushtoi shtrenjtë. Krahas shpërnguljes bëhej edhe regjistrimi i të ashtuquajturve “*gjynli*” (vullnetarë) në ushtrinë turke, e cila luftonte kundër Rusisë. Austro-hungarezët, të cilëve kjo u

²⁰² Bedri Tahiri, *Azem Bejtë Galica, Prishtinë, 2005, f.32*

konvenonte, kishin lejuar oficerët turq që të vinin në Kosovë dhe të bënë regjistrimin e të rinjve shqiptarë si vullnetarë për në front, të cilët rrallëherë ktheheshin të gjallë²⁰³.

Azem Bejtë Galica dhe Hasan Prishtia u angazhuan dhe shpejt i vunë fre këtij aksioni famëkeq. Kështu kur Ferat Draga bashkë me një oficer turk shkuan në Polac për të shkruar “gjynli”, trimi urtak Aruç Selimi – Gjinoci nga Makërmali, atyre dhe masës së tubuar iu drejtua me këto fjalë:

– *“Qysh se na ka shkel vendin tonë serbi kemi hupë shumë meshkuj. Tash jo vetëm që po na vdesin uni për bukë, po edhe djemtë donë me na i marrë e me i hupë. Jemi në këtë skaj të vendit e në gojë të ujkut. Anniq të tjerë po na presin të dyert tona. Kur të na largohen edhe këta pak djemë që na kanë mbetur si do të na bëhet halli? Nuk dimë se na vjen e mranja. Kush tjetër do t’na e mbrojë këtë tokë po nuk e mbrojtëm vetë. Mjaft na del vendi ynë. Nuk kemi pse ta hupim kryet nëpër qoshet e botës. Kush donë me e dhanë jetën, le ta jep tue mbrojt vendin e vet e jo tue luftuar për interesat e botës. Oficerët turq që na kanë ardhë janë bijtë e atyne që na kanë sundue 500 vjet. Prapë ata kanë ardhun këtu me na ngatërrue mendjen për interesat e veta. Vllazen! Tjetër është feja e tjetër është kombësia, tjetër është Turqia e tjetër Shqipnia. Ata e duan Turqinë, kurse ne Shqipninë”*²⁰⁴

Pas këtyre fjalëve masa u revoltua dhe, jo që nuk u shkrua askush, por edhe i dëbuan të ardhurit, duke i kërcënuar se po

²⁰³Kështu vetëm nga Galica, që atëherë nuk kishte më tepër se njëzet shtëpi, shkuan nëntë vetë, shtatë prej të cilëve mbetën diku në Karpate: FazliZena, Ramë Sejdia, Mursel Rexha, Islam Fetahu, Qerim Haziri, Dush Rexhepi dhe Ramadan Lahu. Kurse dy prej tyre: Tahir Shabani dhe Hajdar Salihu, pasi kishin hequr të zitë e ullirit, duke luftuar deri në Galici, mezi u kthyen pas disa vjetësh, kur nuk i kanë njohur as nënat e veta.

²⁰⁴Ajet Haxhiu, *Po aty*, f.39-40

erdhën edhe një herë tjetër në Drenicë nuk do të ktheheshin të gjallë. Nga ky moment më nuk shkoi askush në ushtrinë turke, por u inkuadruan në çetat kryengritëse dhe në Ushtrinë e Hasan Prishtinës, diplomatit të madh, i cili kishte arritur të nxjerrë një leje nga organet austriake.

Luftë me bullgarë e luftë me austro–hungarezë

Pra, siç po shihet “Edhe pas pushtimit të tokave shqiptare nga austro–hungarezët dhe bullgarët, aktiviteti i Lëvizjes Nacionalçlirimtare – kaçake nuk pushoi. Në Kosovë çetat kaçake vepronin nën udhëheqjen e trimave të njohur e të rryer nëpër luftërat e mëparshme. Në Drenicë ishte e njohur çeta e Azem e Shotë Galicës dhe ajo e Shaqir Smakës”²⁰⁵.

Tashmë, Kosova ishte ndarë në dy pjesë dhe Çeta luftarake e Azem Bejtë Galicës vepronte në të dy zonat okupuese. Disa herë u ndesh me armikun në Galicë, në Lushtë, në Kozhicë, në Kollë, në Taraxhë, etj. Një ditë të fundvitit 1916 e sulmoi dhe e likuidoi postëkomandën e xhandarmërisë austriake në Mikushnicë. Sulmi qe i suksesshëm: shtatë të vrarë e tre të plagosur.

Azem Galica, për austro– hungarezët, që nga ditët e para të pushtimit, ndjente një dyshim. Ndërsa për bullgarët, thoshte: “*Janë sllavë dhe prej tyre, kurrë nuk presim ditë të mira*”.²⁰⁶

Ashtu edhe doli. Një ditë, kur Azemi nuk ishte në shtëpi, forca të mëdha austriake e rrethojnë shtëpinë e tij, me ç‘rast i zënë dy vëllezërit: Seferin e Zenelin. Pasi ia djegin shtëpinë ata i marrin dhe, në shenjë hakmarrjeje për xhandarët e vrarë më parë, i pushkatojnë në malin Gamna, afër Mikushnicës.

²⁰⁵ Mr. Ibrahim Çitaku, *Azem Galica dhe veprimtaria luftarake e çetave kaçake të Drenicës, Prishtinë, 1996, f. 97*

²⁰⁶ Dr. Mehmet Rukiqi, *Azem Galica, Prishtinë, 2013, f. 103*

“Megjithatë, ndërrimi i pushtuesve ballkanikë të egër e barbarë me një robërues më të civilizuar, popullit shqiptar, e sidomos për shqiptarët e Kosovës, solli disa të mira: për herë të parë në historinë e popullit shqiptar të Kosovës u lejua hapja e shkollave në gjuhën amtare, përdorimi i flamurit shqiptar—krahës atij austro—hungarez, u lejua që në një masë administruata lokale të kryhet në gjuhën shqipe etj. Ndërsa, në viset shqiptare që kishte pushtuar Bullgaria, vazhdonte dhuna dhe mohimi i lirive kombëtare shqiptare”²⁰⁷.

Kryekomandant i çetave çlirimtare

Pas vrasjes së dy vëllezërve dhe djegies së shtëpisë, Azem Galica mori familjen: nënë Sherifen, vëlla Ademin, gruan e Seferit, me djalë e vogël, Bejtushin dhe kaluan në Obrinë e Ulët, e cila gjendej nën sundimin bullgar. Me ta ishte edhe vëllai i vogël i Shotës, Rexhep (Rexha). Ata u vendosën në kullën e Sefer Halil Smakiqit, që gjendej në vijën kufitare bullgaro—austrohungareze.

Pas disa ditësh forcat bullgare i hetojnë dhe e rrethojnë. Trim, për hir të familjes së konakxhiut, mendon të dorëzohet. Mirëpo, Seferi Halili, ia pret: *“O, Azem Galica, qysh po ma thue atë fjalë, he burrë. Pa i ra kulmi në tokë e gurët e themelit me i hyp sipri nuk bâhet të dalësh nga kulla ime”²⁰⁸.*

Dhe, ende pa zbardhur drita e 6 marsit 1916, fillon lufta e përgjakshme, e cila zgjati deri në mbrëmje. Rrethimi ishte i vështirë. Nga ana e prapme e kullës Azemi kërcen në tokë. Lufton me xhandarë, por përsëri detyrohet të tërhiqet në kullë

²⁰⁷ Mr. Ibrahim Çitaku, *Po aty*, f.89

²⁰⁸ Deklaratë e Ajët Halimit nga Obria e Poshtme, dhënë autorit më 9. 07. 1994.

me një plagë të rëndë në trup. Plagoset edhe Ademi i ri. Shota, e vetmuar me Rexhepin e pasprovuar, qëndronte dhe luftonte si luaneshë, derisa burrat e Obrisë u shkojnë në ndihmë dhe ata çajnë rrethimin.

Forcat bullgare, pasi zbardhi dita, i ngarkuan 18 kufomat e xhandarëve të vrarë dhe i nisën për në Prishtinë. Familjen me të zotin e shtëpisë, Sefer Halilin, i internuan në Pozharevc. Atje, në kampin famëkeq ka lindur edhe Hazir Sefer makiqi.

Nëna e Azemit me Bejtushin edhe disa vite qëndroi në Obri, duke kaluar në shtëpinë e Sinan Tahir Smakiqit, kushëri i Seferit, i cili e kishte shtëpinë në zonën austro-hungareze. Ademi pasi u shërua disa ditë në malet e Obrisë, dërgohet në Gradicë, ku pas disa ditësh ndërroi jetë. Vdekja e tij e hershme, pa i mbushur 16 pranverat, i pikëlloi shumë Azemin e Shotën.

Azem Bejtë Galica për disa ditë rresht u shërua në spitalin “malor” nga “mjekja” e palodhur— Shota, e cila i qëndronte te koka natën e ditën. U shërua në fshehtësinë më të madhe, në malet besnike, midis Drenicës dhe Podgurit, që e ruanin me besnikëri nga syri i armikut. Drenica dhe e tërë Kosova e pritnin kapëdinin e vet. Jeta e tij ishte e nevojshme dhe e vlefshme për të gjithë. Dhe, një ditë, pasi u shërua plotësisht, Shota u bëri zë shokëve që të ngjiteshin në mal. Erdhi edhe Shaqir Smaka, i cili kur e pa Azemin të gatshëm për luftë, i rrodhën lot gëzimi. Pasi u bashkuan çetat zbritën në Kllodernicë për t’i kaluar disa ditë.

Pas disa ditësh austro-hungarezët informohen ku gjenden luftëtarët e këtyre çetave dhe shkojnë i rrethojnë. Me një sulm të rreptë e shpërthejnë rrethimin duke i vrarë disa xhandarë dhe spiunin që u kishte prirë. Nga luftëtarët tanë u vra Ramadan Llullaku.

Çeta e Shaqir Smakës dhe e Azem Galicës kalojnë në fshatin verior të Drenicës, në Bajë. Edhe atje i hetojnë dhe i rrethojnë në befasi, duke u afruar deri te dera e kullës. Kur dalin Azemi e Shaqiri në korridor, nën shkallë kishte qenë udhëheqësi i ekspeditës, Llokmajstori Hirtman. Shaqir Smaka kapet fytyrë me të. Të dy ishin të fortë. Përleshja e tyre zgjati shumë. Dikur një shok i Azemit (Fekë Rakinica, dhëndër i Shaqirit) duke u munduar ta qëllloi Hirtmanin, i vret që të dy. Vdekja e Shaqirit dhe djegia e trupit të tij e pikëlloi shumë Azemin, i cili bëri luftë titanike derisa dalin nga rrethimi.

Me vdekjen e Shaqir Smakës (ishte vera e vitit 1917) të gjitha çetat kryengritëse të Drenicës do t'i udhëheqë Azem Bejtë Galica dhe e shoqja, Shotë Galica.

Shkollat e para shqipe

Siç tregojnë pleqtë dhe siç dëshmon historia, ata që u gjendën nën sundimin austro-hungarez, për një nuancë jetuan më mirë dhe i gëzuan disa të drejta më tepër se ata nën sundimin bullgar. Ky pushtues lejoi hapjen e shkollave në gjuhën amtare. Aspiratat dhe përpjekjet e popullit shqiptar të Kosovës, veçmas të intelektualëve përparimtarë të tij, për një sistem arsimor në gjuhë amtare shqipe filluan të mëkëmben më 1916, në ato treva, të cilat i pushtoi Austro-Hungaria. Vjena lejoi dhe ndihmoi jo vetëm hapjen e shkollave laike e shtetërore shqipe, por njëkohësisht bëri të mundur që pjesërisht edhe administrata të realizohej në gjuhën shqipe²⁰⁹. Pra, shqiptarët, edhe pse të vetëdijshëm për qëllimet imperialiste të Vjenës, i shfrytëzuan rrethanat e krijuara dhe brenda një kohe të shkurtër u hapën

²⁰⁹ Prof. dr. Hajrullah Koliqi, *Shkollat dhe arsimi në Kosovë në vitet 1915- 1918*, Shkëndija, nr.4, Prishtinë, 1994

shumë shkolla në gjuhën shqipe, u vendosën shqiptarë nëpër administratat lokale (nëpër komuna dhe rrethe), etj.

Këto rrethana i shfrytëzoi edhe Vushtrria e lashtë. Aty, që në fund të vitit 1915 e gjejmë shkollën shqipe, e cila është ndër të parat në Kosovë dhe kishte këta nxënës: Emin Badivuku, Musai i Ibrahim Agës, Aliu i Latif Agës, Fevziu i Mustafë Agës, Ferat Ahmet Pika, Sylejman Popova (djali i Hys Popovës), Maksut Xhafer Muharremi, Isaji i Ibrahim Agës, Hyzejr Hoti, Naim Jahja Bylykëmini, Abdullah Begu, Besim Zejnullah Begu (Berisha), Përtej Izet Badivuku, Jakup Hafuz Maxhuni, Alushi i Mahmut Begut, Bahtijar Begu, Ilijaz Badivuku, Hamdi Zajmi, Rizai i Latif Agës, Qazim Ali Riza, Haki Guxha, Sherif Isuf Gara dhe Ibush Fanda.²¹⁰

Pas tre–katër muajsh, po me këta nxënës u formua edhe banda muzikore–frymore (orquestra frymore) e shkollës, e cila u pagëzua me emrin e Hasan Prishtinës, i cili ishte nismëtar i saj dhe me njetet e veta bleu veglat muzikore në Vjenë.

Atdhetarët shqiptarë, krahas çeljes së shkollave në gjuhën shqipe, u angazhuan edhe në organizimin e kryengritjeve për çlirim e bashkim kombëtar. Kështu, më 1916, Hasan Prishtina dhe Azem Galica, për tri ditë rresht, në Vushtrri, biseduan dhe trajtuan shumë probleme kombëtare. Nga ky moment u punua paralelisht në dy fronte:

- 1) Në hapjen e sa më shumë shkollave shqipe, dhe
- 2) Në përgatitjen e një kryengritjeje të armatosur gjithëkombëtare.

Kështu Lëvizja çlirimtare në Kosovë, që kishte pasur më tepër karakter lokal dhe ishte zhvilluar në formë guerile, në vitin 1918 merr përmasa kombëtare.

²¹⁰ Fahri Buçinca, *Rilindja*, më 30. X. 1979

Tradhtia e Kostë Vojvodës

Këto lëvizje dhe përgatitje i përcillte edhe Serbia. Kapiteni i ushtrisë serbe, Kostë Millovanoviqi (1871–1944) nga Gjyarakovci, i njohur si Kostë Peçanci ose Kostë Vojvoda, kur kthehet nga fronti i Selanikut interesohet të lidhet me Azem Galicën, kinse për një luftë të përbashkët kundër austro–hungarezëve. Kështu, në verën e vitit 1918, në Pridvorcë të Kolasinit të Ibrit, gjegjësisht në Varragë, lidhin një lloj marrëveshje, sipas së cilës do të luftonin bashkë shqiptarë e serbë deri të çlirohet vendi e pastaj secili popull do të jetojë i lirë në trojet e veta.

Edhe pse u lidh kjo marrëveshje, askund nuk përmendet, as nuk dihet për ndonjë luftë të përbashkët. Dihet se Kosta kudo i shfrytëzonte luftërat dhe fitoret e Azem Galicës, të cilin e “konsideronte” komandant. Këtë e vërteton edhe Sokol Mehaj nga Tomoci i Istogut, i cili thotë se ka qenë në rrugë afër Gjyrakocit, kur kaluan Azemi dhe Kosta. Serbët dhe ushtarët e zënë robër, që punonin në rrugë, filluan të brohorasin “*Rroftë Kostë Vojvoda!*” Kosta iu afrua njërit dhe duke i rënë me këmbë i bërtiti: “*Thuaj: Rroftë Azem Bejta e jo Kosta, ky është komandant!*”²¹¹

Siç u pa më vonë kjo kishte qenë tradhti dhe mashtrim djallëzor, që u kushtoi shtrenjtë çetave çlirimtare.

Komiteti Mbrojtja Kombëtare e Kosovës

Pas Luftës së Parë Botërore tokat shqiptare u bënë pre e lakmive të shovinistëve fqinjë dhe e fuqive imperialiste. Shtetet

²¹¹ Liman Rushiti, *Rrethanat politike-shoqërore në Kosovë 1912- 1918*, Prishtinë, 1986, f. 199

fqinje, veçmas Serbia, nën pretekstin e ndjekjes së ushtrisë austro-hungareze, ishin vërsulur egërsisht mbi tokat shqiptare. Çdo pëllëmbë toke e çliruar nga një pushtues, robërohej nga një pushtues edhe më i egër. Kështu nisi të rrezikohej edhe pavarësia e Shtetit Shqiptar, e shpallur në Vlorë, më 28 Nëntor 1912.

Të nxitur nga momentet historike, një grup intelektualësh e atdhetarësh, më 1 maj 1918, nën udhëheqjen e Hoxhë Kadriut (Kadri Lutfulla Prishtina 1978– 1925), në Shkodër formuan Komitetin “*MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS*”. Komiteti, edhe pse selinë e kishte në Shkodër, kudo, që nga jugu e deri në veri, i kishte degët dhe nëndegët e veta. Në kohë të ndryshme si anëtarë të Komitetit punuan me vetëmohim luftëtarët e Lëvizjes Kombëtare Demokratike si: Hasan Prishtina, Bajram Curri, Sali Nivica, Hysni Curri, Bedri Peja (Pejani), Beshir (Beqir) Vokshi, Azem Galica, Avni Rrustemi, Elez Isufi, Aqif Pasha, Sotir Peci, Ragip e Qerim Begolli, Sotir Kolea, Kel Marubi, etj²¹².

Për t’i ndihmuar kryengritësit, Hoxhë Kadriu dhe Komiteti i Kosovës e hartuan PROGRAMIN prej dhjetë nenesh, ku u preken problemet kryesore të kryengritjes së përgjithshme të Kosovës të vitit 1919.²¹³ Sipas atij programi, krahës ndjekjes së ushtrisë austro-hungareze, duhej vendosur edhe pushteti popullor shqiptar. Në çdo vend të çliruar duhej vendosur flamuri i Skënderbeut, flamuri kuqezi.

Kështu, në vjeshtë të vitit 1918, filloi lufta kundër austro-hungarezëve. Azem Galica me çetat e veta e çliroi Drenicën, Istogun dhe marshoi drejt Pejës. Kudo valonte flamuri

²¹² Eqber Skëndi, *Hoxhë Kadriu (Kadri Prishtina)*, Prishtinë, 1992, f. 38

²¹³ Limon Rushiti, *Lëvizja Kaçake në Kosovë (1918- 1928)*, Prishtinë, 1981, f.94

shqiptar. Në Pejë arriti edhe Kostë Vojvoda me çetnikët e vet. Derisa kryengritësit po e mbanin të rrethuar Pejën, Azemi kishte shkuar në Shkup në emër të Komitetit, për t'u takuar me komandantin e forcave franceze. Azemi atij i tha se mbi 4000 ushtarë austro-hungarezë janë të rrethuar në Pejë nga forcat kryengritëse. Ai iu drejtua Azemit:

– *Ti a mund ta pushtosh Pejën?*

Azemi duke u bazuar në moralin e lartë luftarak të shqiptarëve dhe në etjen e tyre për liri, ia ktheu:

– *Unë në Pejë bëj çdo gjë.*

Azemi u kthye në Pejë dhe urdhëroi fillimin e betejës. U zhvillua një luftë e rreptë dhe e përgjakshme, por qyteti u çlirua. Rreth 4000 ushtarët e zënë robër iu dorëzuan forcave franceze, ndërsa armatimi iu shpërnda çetave kryengritëse. Flamuri u vu në qendër të Pejës. Pasi u çelën rrugët, në Pejë hyri ushtria franceze e pas saj edhe forcat serbe, të cilat ishin nisur për ta pushtuar Shkodrën dhe ndoshta për ta rrezikuar edhe pavarësinë e shtetit shqiptar. Kostë Vojvoda, që gjithmonë i kishte shfrytëzuar luftërat e Azemit, edhe kësaj radhe duke u mbështetur në forcat franceze dhe në ndonjë përkrahje të vogël të ca bejlerëve pejanë, e zbriti flamurin shqiptar dhe e ngriti flamurin serb.

Kështu, Peja dhe viset e tjera që u çliruan nga okupatorët austro-hungarezë (Mitrovica, Drenica e Kuqe, Istogu, etj.), menjëherë ranë nën kthetrat e një armiku edhe më të egër e më barbar, zullumit e të cilit ende i kishin të freskëta, ato të viteve 1912–1915. Kosta u bë kundërshtar i Azem Galicës dhe e ftonte që t'i dorëzojë armët dhe të pranojë ndonjë gradë a post ushtarak. Azemi i tradhtuar nuk u demoralizua e as nuk u mashtrua pas ofiqeve e gradave të ofruara, por e vazhdoi luftën për liri e pavarësi kombëtare.

Azem Galicën më shumë i shqetësoi qëndrimi i forcave franceze, sepse për serbët e kishte ditur moti se janë të pabesë dhe dinakë. Këtë e ka pohuar disa herë vetë Jorgo Gjukiqi (Jabuka) nga Jabuka e Koloshinit, që kishte zënë vend në Bukosh të Vushtrrisë, kur thoshte:

– “*Këtë sy ma ka verbua Azem Galica, por unë ia kam pasur borxh edhe jetën. E keni tradhtuar shumë rëndë. Luftërat dhe sukseset e tij i shfrytëzuan derisa i ndoqëm austriakët dhe hungarezët. Kur erdhën francezët ia kthyem shpinën. Kurrë nuk e harroj momentin kur e shkatërruam mbishkrimin “SKËNDERBEU” në hotelin e Mitrovicës dhe e vumë atë “Car Dushan”. Nuk njaftoi vetëm kjo. Unë i mashtruar nga krali e i verbuar nga gradat, i dola në pritë për ta vrarë tinëz. Ai si rrufeja m’i vrau dy shokët: Vojën dhe Stojanin dhe mua më la për të vdekur, pa njërin sy. Po hallall i kam thënë për së gjalli dhe hallall po i them për së vdekuri, se burrë si Azem Galica nuk lind më nëna. Ishte trim i pastër dhe besnik*”²¹⁴.

Pas këtyre përleshjeve të mëdha edhe harta gjeopolitike e Evropës pësoi ndryshime. Kështu, me kapitullimin e Gjermanisë në atë luftë, më 11 nëntor 1918, merr fund Lufta e Parë Botërore,” në të cilën morën pjesë 74 milionë ushtarë dhe u kushtoi popujve 10 milionë të vrarë, 21 milionë të plagosur, afër 8 milionë të zënë robër dhe 3.5 milionë invalidë të rëndë të luftës”.²¹⁵

Azem Galica, megjithatë, nuk u demoralizua. Në bashkëveprim me ideologët e Lëvizjes Çlirimtare, me Hoxhë Kadriun, me Hasan Prishtinën dhe me Bajram Currin, nisi riorganizimin e çetave të lirisë dhe përgatitjet për një kryengritje të

²¹⁴ Deklaratë e Zenel Haxhës nga Galica, dhënë autorit më 20 janar 1991

²¹⁵ Dr. Xheladin Shala, *Marrëdhëniet shqiptaro-serbe (1912- 1918)*, Prishtinë, 1990, f. 341

përgjithshme në Kosovë kundër pushtuesit të ri serb, të quajtur Mbretëria SKS. Azemi doli në popull dhe e lëshoi kushttrimin: “*Kush është i aftë për luftë dhe që e dëshiron lirinë dhe pavarësinë e tokave shqiptare t’u bashkohet çetave çlirimtare!*” Përsëri doli maleve, sepse siç thotë Kadareja: “*Fati i këtij vendi ka dalë gjithmonë në fillim në maja malesh, ashtu siç del dielli*”.

BUJAR DUGOLLI & DURIM ABDULLAHU

Universiteti i Prishtinës

PARAQITJA E LUFTËS SË PARË BOTËRORE NË TEKSTET E HISTORISË NË KOSOVË, SHQIPËRI DHE MAQEDONI

Në tezën e gjashtë të esesë së tij me tetëmbëdhjetë teza mbi konceptin e historisë, të cilën e shkroi vetëm dy vite para se të vetëhelmohej më 1940, koleksionisti, kritiku dhe filozofi gjerman Walter Benjamin, shkruan se: *“Të artikulossh historikisht të kaluarën, nuk do të thotë ta njohësh atë siç ka qenë realisht. Do të thotë të përvetësosh një kujtim, siç shkrepnin ai në çastin e rrezikut.”*²¹⁶ Por rreziqet permanente nëpër të cilat është duke u përvijuar historia botërore sot, duke e rëndomtësuar gjendjen e rrezikut në histori, e kanë bërë të vështirë kapjen e këtij kujtimi historik, qoftë në çastin e rrezikut, qoftë edhe gjatë vetë përjetimit të tij si të tillë. Përballë kurbaturës aq të përthyer dhe të kudondodhur të lëvizjes së historisë sot, çdo afërsi dhe kontakt i presupozuar mes kantierëve politik të historicizmit si historibërje, dhe kantierëve shkencorë të historisë si njohje dhe reflektim, paraqet rrezik për puritanizmin e objektivitetit aq të nevojshëm gjatë regjistrimit dhe shkrimit të historisë. Në një situatë të tillë, ku masa e madhe e rrezikut në histori përveç e pakapshme bëhet edhe e

²¹⁶ W. Benjamin, *“On the Concept of History”*, in *Selected Writings*, vol. 4, 1938-1940, trans. E. Jephcott, edit., H. Eiland & M. Jennings, (Cambridge: Belknap Press, 2003), p. 391.

pashmangshme, teza e Benjaminit²¹⁷ është strukur dhe ka mbetur efektivisht valide, vetëm brenda suazave të reflektimit empirik mbi historinë. Në këtë kontekst, çdo brishtësi dhe çdo fluiditet i historianëve karshi rezonimit të subjekteve të historicizmit, hap rrugë për kanosjet e shumta që mund të davarisin diskurset e historisë si shkencë; kanosje këto, të cilat kanë pas tyre gjithë fuqinë e nevojshme për t'i shmangur diskurset historike deri në atë masë, sa që të cenojnë kredibilitetin dhe besueshmërinë edhe ashtu fort të kritikuar të tyre. Të fshehura pas proklamave të vetëshpallura humane, apo të kamufluara nën petkun e shërbëtorëve të bindur dhe serioz, lukunia e izma-ve nga politika në njërën anë, së bashku me historianët kreacionistë e projektues në anën tjetër, qëndrojnë si duket në krye të mësynjeve që sjellin këto kanosje. Të alarmuar nga përparimi e depërtimi i shpejtë dhe vështirë i ndalshëm i tyre, historianët e taborit tradicional, janë vënë në një pozitë që kërkon një zgjidhje të shpejtë dhe kreative nga ta: një 'hendek rrethues' apo një 'përforcim i portave' qoftë ajo, kjo zgjidhje, duhet të sigurojë me doemos pacenueshmërinë dhe sovranitetin shkencor të tërësisë së veprimtarisë së shkrimit të historisë.

Këtu, njësoj siç edhe në të gjitha vendet e qytetërimit evropian, konceptimi matematikor mbi ciklin e plotë, është ngritur dhe strukturuar mbi intervalet e numrave dhjetorë. Sipas këtij kriteri të njohur, ndonëse të pashpallur, viti i 14-të i shek. XXI, komunikon përputhshmërisht në mënyrë transkohore me vitin e 14-të të shek.XX, motin kur edhe filloi Lufta e Parë Botërore. Përmbushja e plotë e ciklit shekullor që e

²¹⁷ Për një studim kritik ndaj tezave të Benjaminit mbi historinë shih H. Eiland & M. Jennings, *Walter Benjamin: A Critical Life*, (Cambridge: Belknap Press, 2014), pp. 647-675.

pason ngjarjen historike, ka hyrë në traditën evropiane si një pikëmbërritje e caktuar në kohë, e cila natyrshëm pret të shënjohet nga prapakthimet e vëmendjes së publike shkencore, – por jo vetëm – për shqyrtime dhe mbishqyrtime të reja të burimit të ngjarjes, vetë ngjarjes dhe pasojave të prodhuara nga ngjarja historike që ka mbushur shekullin e reflektimit të saj të përpamë dhe prezencës së saj në histori. Një cikël i tillë shekullor, i sapopërmbytur me pikëmbërritjen e 100-vjetorit të fillimit të Luftës së Parë Botërore, është kushti prodhues që ka pjellur këtë punim të fokusuar mbi paraqitjen e Luftës së Parë Botërore në tekstlibrat e historisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni.

Duke e marrur si të mirëqenë devizën e njohur psikoanalitike, për të cilën njeriu s'është gjë tjetër veçse një fëmijë i rritur, dhe duke e bartur atë për ta rikontekstualizuar në një rrafsh psikohistorik, rezulton që njohja e historisë nga njerëzit e rëndomtë, – pra nga ata që nuk e kanë historinë profesion – s'është gjë tjetër veçse tërësia e asaj që ata kanë mësuar gjatë shkollimit të tyre në fëmijëri. Duke ndjekur këtë logjikë të të argumentuarit, përmbajtja dhe në përgjithësi niveli i tekstlibrave shkollorë të historisë, na shfaqet si tejet i rëndësishëm dhe përcaktues në edukimin e brezave mbi historinë, si burim bazik për njohjen e të shkuarës së botës dhe qytetërimeve njerëzore.

Në historinë e tij mbi lindjen e burgut, historiani dhe filozofi francez Michel Foucault, – duke shkruar mbi rolin dhe nivelin e ndikimit të shkollimit në botëkuptimet e mëpastajme të individit shoqëror, – e cilëson shkollën si institucionin më gjithëpërfshirës disiplinues që ka fabrikuar dhe që vazhdon të fabrikojë njeriun modern.²¹⁸ Foucault këmbëngul në pozitën

²¹⁸ M. Foucault, *Discipline and Punish: The Birth of the Prison*, trans. Alan Sheridan, (New York: Vintage Books, 1995), p. 147.

prej farkëtuesi monolit, që shkolla luan tek nxënësit, – rrjedhimisht tek njerëzit në përgjithësi – përmes homogjenizimit të veçantive individuale të secilit nxënës, nën diktatin shtypës të mësuesit si mbikëqyrës, zhbirues, sundues dhe detyrues njëherazi.²¹⁹ Duke ofruar të njëjtën dije për të gjithë nxënësit e shumë gjeneratave me radhë, shkolla fabrikon vetëm një lloj njeriu për disa dekada rresht. Ky fabrikim, përveç që e ngulfat autenticitetin e nxënësve duke injektuar pasiguri në kreativitetin e tyre, ai e varfëron dhe e minimizon kapacitetin e tyre mendor, duke e shtypur dhe sheshuar atë deri sa e unifikon tërë dijen e nxënësve, përmes reduktimit të saj brenda një pakoje të ngurtë dijesh ‘të sigurta’, që ofrohet e gatshme për të gjithë ata dhe për secilin prej tyre. Mësimi uniform nëpër shkolla, është një transmetim dijesh klishe dhe të stërpërsëritura, që rrjedhimisht, prodhojnë vetëm nxënës me dije serike. Për të kuptuar se cili do të jetë njeriu i të ardhmeve të afërta, është e nevojshme të dimë se çfarë dije ofrohet në shkolla, dhe për këtë, mbase duhet të huazojmë pyetjet që Jean–François Lyotard, shtron në raportin e tij mbi dijen – (“La Condition Postmoderne: Rapport sur le Savoir”), – tek kushti postmodern: “*Kush përcjellë mësimin? Çfarë? Kujt? Në ç’formë? Me ç’pasoja?*”²²⁰

Pyetjet e Lyotard–it, mund të shërbejnë fare mirë si një skicë orientuese, për të depërtuar në brendësinë e tekstlibrave shkollorë të historisë, dhe për të parë konstruktin dhe nivelin e tyre. Në radhë të parë: *kush përcjellë* (shkruan) *mësimin?*

²¹⁹ R. Deacon: “*Michel Foucault on education: a preliminary theoretical overview*”, in South Africa Journal Education, no. 26 (2), (Johannesburg: Education Association of South Africa, 2006), pp. 177-187.

²²⁰ J-F. Lyotard, *The Postmodern Condition: A Report on Knowledge*, trans. Geoff Bennington & Brian Massumi, (Manchester: Manchester University Press, 1982), p. 48.

Në listat e autorëve të teksteve shkollore të historisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, vërehet një dominim i dyfishtë: së pari, ato janë shkruar vetëm nga historianë; dhe së dyti, shumica dërmuese e tyre, janë historianë të modernitetit. Kjo dominancë e dyfishtë, shkakton edhe një disbalancë të dyfish-të. Të shkruarit e tekstlibrave vetëm nga historianë, pa përfshirë fare sociologë dhe psikologë të zhvillimit në mesin e autorëve, i bën këto tekste profesionalisht mbase të përmbushura, por të mangëta në aspektin pedagogjik, duke lënë hapësirë për të dyshuar mbi nivelin e aftësisë së këtyre teksteve për të komunikuar me lexuesit e tyre, nxënësit. Ky nivel i komunikimit, merr rëndësi edhe më të madhe, kur kihet parasysh delikatesa e psikologjisë në formim e sipër të nxënësve. Në anën tjetër, shkrini i këtyre teksteve pothuajse vetëm nga historianë modernistë, – pavarësisht se tekstet përmbajnë mësimë nga të gjitha periudhat historike, – ka bërë që ato të përshkohen përgjithësisht nga qasje dhe interpretime (post?)moderniste mbi historinë. E tëra kjo, i bën këto tekste gati krejtësisht të njëtrajtshme dhe monolite në përmbajtjen dhe rezonimin e tyre.²²¹

Së dyti: *çfarë përcillet?* Ajo çfarë përcillet përmes tekstlibrave të historisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni për Luftën e Parë Botërore, nuk dallon shumë nga njëra tjetra dhe për-

²²¹ Për mangësitë dhe të metat e teksteve të Kosovës shih B. Dugolli & D. Abdullahu, “Çështje kundërtënëse dhe të ndjeshme në tekstet e historisë për shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë”, in Diskutime, viti III, nr.9, shkurt-mars 2014, (Tetovë: Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike - Akademia Diplomatike Shqiptare Tetovë & Instituti për Studime Evropiane i Universitetit të Tiranës, 2014), pp. 121-144; po ashtu shih edhe J. Thaqi, *Problemet dhe të metat e teksteve shkollore (Analizë e teksteve shkollore të Kosovës të Ciklit të Shkollës së Mesme të Ulët (VI, VII, VIII dhe IX)*, (Prishtinë: BIRN, 2013).

gjithësisht, duket se ndjekin në masë të madhe të njëjtat mënyra të referimit dhe interpretimit. Kurrikulat dhe programet shkollore në këto tri republika ballkanike, përmbajnë një numër jo të vogël të njësive që kanë të bëjnë me historinë e zhvillimeve dhe pasojave të kësaj lufte. Këto njësi mësimore, janë të shpërndara në tekstlibrat shkollore të historisë të disa niveleve, dhe të disa profileve shkollore: duke nisur nga klasa e fundit e nivelit fillor, e deri tek klasa po e fundit e nivelit të mesëm shkollor. Në totalin e tyre, numri i tekstlibrave të historisë nga të tria vendet, të cilat kanë në përmbajtjen e tyre mësimore për Luftën e Parë Botërore, është rreth pesëmbëdhjetë tekste. E thënë në mënyrë të përgjithshme, këto mësimore janë strukturuar sipas një skeme të ngritur mbi tri pika kryesore: 1) shkaqet që sollën luftën; 2) zhvillimet politiko-ushtarake të luftës; si dhe 3) pasojat dhe efektet që solli lufta. Ndërsa në anën tjetër, vetë historia e luftës, rrëfëhet nga tre prizma rrëfimi: nga prizmi global; nga prizmi rajonal; dhe nga prizmi nacional.

Nëse shikojmë në mënyrë të veçantë përmbajtjen e vetëm atyre njësive mësimore që flasin për Luftën e Parë Botërore, shohim që në aspektin faktografik, të dhënat që u ofrohen nxënësve, korrespondojnë me njëra tjetrën dhe në përgjithësi, janë pothuajse të njëjtat të dhëna që qarkullojnë në të gjitha tekstet e këtyre tri vendeve. Dallimet dhe divergjencat mes këtyre teksteve, shfaqen në qasjet e ndryshme të autorëve ndaj zhvillimeve historike, dhe në mënyrat e interpretimeve të tyre. Por që në fillim, si një emërtues i përbashkët që përshkon gati në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin nivel narracionet e të gjithë këtyre autorëve, është pikëshikimi etnocentrist dhe nacionalist,²²² nga i cili është rrëfyer dhe interpretuar

²²² Për interpretimet nacionaliste të historisë së shqiptarëve shih P. Misha, *"Invention of a Nationalism: Myth and Amnesia"*, in *Albanian Identities:*

historia e Luftës së Parë Botërore. Efektet e këtij pikëshikimi, janë dukshëm më të theksuara dhe më të qarta, sidomos tek ato njësi mësimore që flasin për ngjarjet e luftës që lidhen direkt me historinë kombëtare të shtetit prej nga janë autorët e teksteve. Në një farë mënyre, siç duket, autorët e tekstlibrave të historisë, kanë ndjekur një parim sipas të cilit ata mëtojnë të shkruajnë historinë në atë mënyrë, që assesi të mos goditen e aq më pak të lëndohen ndjenjat kombëtare dhe në përgjithësi perceptimet identitare që nxënësit kanë për kombin, vendin dhe veten e tyre.

Kështu, kur flitet për shkaqet që sollën Luftën e Parë Botërore, në tekstet e këtyre tri vendeve, vërehen dallime tek dhënia e përparësive të disa shkaqeve ndaj disa të tjerave, si dhe tek shpjegimin dhe interpretimin i tyre. Në tekstet e Kosovës, shkaqet që sollën luftën përqendrohen tek arsyet politike si: disbalanca politike mes Fuqive të Mëdha; krijimi i blloqeve ndërshtetërore; lufta ruso-japoneze e viteve 1904–1905; kriza e Marokut; kriza e aneksimit të Bosnjës nga Austro-Hungaria; dhe luftërat ballkanike.²²³

Ndryshe nga kjo, në tekstet e Maqedonisë, shkaqet e luftës janë dhënë disi më shkarazi dhe në një mënyrë më të përgjithësuar, thjeshtë duke thënë se “shkaqet e Luftës së Parë Botërore ishin të shumëllojshme.” Tutje, kjo shumëllojshmëri shkaqesh që sollën luftën, referohet si një përzierje shkaqesh ushtarako-ekonomike dhe politike,²²⁴ që sollën disbalancë të forcave politike në terren, mes blloqeve ndërshtetërore.

Myth and History, S. Schwandner-Sievers & B. J. Fischer edit., (London: Hurst & Company, 2002), pp. 33-48.

²²³ F. Rexhepi & F. Demaj, *Historia 8 – shkolla e mesme e ulët*, (Prishtinë: Libri Shkollor, 2012), pp. 145-147.

²²⁴ B. Ristovski, Sh. Rahimi, S. Mlladenovski, S. Kiselinski & T. Çepreganov, *Historia për klasën VIII*, (Shkup: ДПБИ, 2013), p. 6.

Ndërsa në anën tjetër, në tekstet e Shqipërisë, përkatësisht në librin e klasës së 8-të, janë rezervuar plot tri njësi mësimore vetëm për shkaqet dhe zhvillimet që sollën Luftën e Parë Botërore! Po ashtu, ndryshe nga tekstet e Kosovës dhe të Maqedonisë, ku si më të rëndësishme janë paraqitur shkaqet politike, në tekstin e sipërpërmendur, në qendër të shkaqeve që sollën luftën, janë vënë shkaqet ekonomike. Për më tepër, këto shkaqe janë prezantuar me një terminologji marksiste, dhe janë interpretuar po sipas prizmit marksist të historisë. Kjo vërehet më së shumti në pasazhe si këto: “Këto (sindikatat D.A.) organizonin herë pas here greva dhe demonstrata kundër pronarëve dhe shtetit...Krahas sindikatave lindën edhe partitë politike, që mbronin të drejtat e punëtorëve,...Këto parti u bashkuan dhe krijuan Internacionalen e Parë (1864), e cila u shpërnda shpejtë, e më vonë u krijua Internacionalja e Dytë (1889) që shpalli 1 Majin, Ditën Botërore të Punëtorëve...Për të përballuar presionin e punëtorëve, qeveritë përdornin forcat policore, por edhe politikën e reformave. Gjermania ishte shteti i parë që në vitet 1883 e 1889 nxori ligjet për punëtorët. Këto ligje qenë reforma që zbutnin konfliktet mes punëtorëve dhe pronarëve.”²²⁵

Pasazhet e mësipërme, të cilat shpjegojnë se si sindikatat organizonin greva e demonstrata kundër pronarëve e shtetit; se si kishte parti politike që mbronin të drejtat e punëtorëve, të cilat pastaj u bashkuan për të krijuar internacionalet e punëtorëve; dhe se si ligjet e punëtorëve në Gjermani ishin një përpjekje për të zbutur antagonizmat mes punëtorëve dhe pronarëve, përcjellin një gjuhë tipike nga terminologjia e marksiz-

²²⁵ M. Dërguti & T. Treska, *Historia* 8, (Tiranë: Botime Shkollore Albane, 2009), p. 11.

mit dhe leninizmit,²²⁶ qoftë si filozofi, qoftë si rrymë interpretative e historisë, e artikuluar në kuadër të teorisë së materializmit historik dialektik.²²⁷

Por prej nga vjen ky interpretim (neo?)marksist i historisë në tekstet e Shqipërisë? Nga trashëgimia marksiste e regjimit komunist në historiografinë shqiptare,²²⁸ apo nga bindjet dhe qëndrimet autentike dhe të përfaqësuara të autorëve të tekstit në fjalë? Kjo çështje, na kthen edhe një herë te pyetja e parë e Lyotardit: *kush përcjellë mësimin?* Zbërthimi i kësaj pyetjeje, tërheq pas vetes edhe një sërë pyetjesh të tjera: nga kush duhet shkruar tekstlibrat e historisë? Si duhet interpretuar historia për nxënësit? A duhet t'i'u imponohet një interpretim i caktuar nxënësve, apo ata duhet lënë të lirë në perceptimet dhe interpretimet e tyre? Sa e drejtë është që nxënësit të mësojnë historinë sipas interpretimeve të autorëve të teksteve? A është zgjedhje më e mirë në këtë rast sistemi me tekste alternative, apo ai me tekste të unjësuar?

Në sistemin arsimor të Republikës së Kosovës dhe asaj të Maqedonisë, tekstlibrat e historisë janë unjësuar nga ministrinë e arsimit, përmes standardizimit të teksteve. Ndërsa në Shqipëri, pas kritikash të shumta, sistemi me tekste alterantive, me shumë gjasë duket se është duke u aplikuar për herë të fundit

²²⁶ Për pikëpamjet e Leninit mbi L.P.B. shih V. I. Lenin, *Imperialism: The Highest Stage of Capitalism*, (London: Penguin Books, 2010); sidomos kapitullin "Imperialism as a Special Stage of Capitalism".

²²⁷ Shih G. A. Cohen, *Karl Marx's Theory of History: A Defence*, (New York: Oxford University Press, 2004); po ashtu shih H. Lefebvre, *Dialectical Historical*, trans. J. Sturrock, (Minnesota: University of Minnesota Press, 2009).

²²⁸ Për ndikimin e regjimit enverist në historiografinë shqiptare shih M. J. Alex Standish, "Enver Hoxha's Role in the Development of Socialist Albanian Myths", in *Albanian Identities*, op.cit., pp. 115-124.

këtë vit, përpara se të zëvendësohet nga tekste standarde për të gjitha shkollat e vendit. Megjithatë, ky dështim i presupozuar i sistemit me tekste alternative në Republikën e Shqipërisë, nuk mund të merret si argument apriori për përparësitë e sistemit me tekste standarde. Aq më tepër kur kihet parasysh që përdorimi i teksteve unike për tërë vendin, paraqet një mundësi ideale për një histori të njëlojtë dhe me interpretime monolite, që do të mund të diktohej nga pikëpamjet e forcave politike në pushtet karshi historisë.

I tërë procesi i shkrimit të tekstlibrave shkollorë,²²⁹ – e sidomos atyre të historisë – është i përcjellur nga një sërë çështjesh shumë delikate, që kryesisht janë rezultat i kompleksitetit të natyrës së vetë historisë. Ndryshe nga shkencat ekzakte, të cilat kanë një natyrë shumë më statike si për nga objektet e studimit ashtu edhe për nga rezultatet, historia është një shkencë shumë më e përthyeshme dhe më e brishtë në përmbajtje. Duke qenë se rezultatet e saj janë krejt të papërkthyeshme numerikisht dhe se ato janë të artikulueshme vetëm gjuhësisht, historia është e lidhur dhe e varur në mënyrë të pashkëputshme nga gjuha. Linjat e rrjeteve gjuhësore, janë të vetmet trase transmetimi, që historia ka në shfrytëzim për shpërfaqjen dhe përçimin e rezultateve të saj. Rrjedhmisht, gjuhësinë e historisë si historiologji, si e vetnija rrugë e njohur deri më tani për shpërfaqjen e saj, përmbledhtas ngërthen në vete, tërë gamën e problemeve për dhe rreth shkrimit të historisë. Përballë kësaj gjendje, natyrshëm pyetet se: në ç'pikë

²²⁹ Për idetë moderne të shkrimit të tekstlibrave shih F. Pingel, *UNESCO Guidebook on Textbook Research and Textbook Revision* – 2nd revised and updated edition, (Paris & Braunschweig: United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization & Georg Eckert Institut for International Textbook Research, 2010).

duhet përqendruar vëmendja e historianit gjatë shkrimit të historisë? Ideja e Wittgenstein-it për tu “fokusuar te rindërtimi i propozimeve logjike në vend të kontekstualizimit të deklaratave të autorit”,²³⁰ rrezikon të jetë sa e vjetërsuar, aq edhe e pashqitshme nga kuptimi i saj gjuhësor, për ndonjë aplikim eventual të mëtutjeshëm.

Pyetjet e mësipërme, grumbullohen në mënyrë të paakorduar në një pikë: ç’histori duhet të mësojnë nxënësit, pra, ç’histori duhet tu servohet nxënësve? Kur shkruan për përkufizimet dhe kalkulimet e ligjërimeve publike, Foucault vë në dukje që ai që vendos se për çfarë mund të flasim, ai ka vendosur edhe se çfarë mund të dimë. Dhe meqë ky vendim për atë se çfarë mund të flitet, nuk është askund më ndikues se sa në fushat e ligjërimit arsimor, Foucault përpiket të tërheq vëmendjen tonë pikërisht aty kur thotë: “Çdo sistem arsimor është një mënyrë politike për ta ruajtur ose ndryshuar përvetësimin e ligjërimeve, me dijet dhe pushtetet që bartin me vete...Në fund fare, ç’mund të jetë tjetër një sistem arsimimi, përveç një ritualizim i fjalës, një cilësim dhe ngulitje e roleve për subjektet folëse, themelim i një grupi doktrinal së paku i përhapur, shpërndarje dhe përvetësim i ligjërimit së bashku me pushtetet dhe dijet e tij?”²³¹ Meqë kurrikulat e programeve arsimore paracaktohen nga ministritë përkatëse të arsimit të këtyre tri vendeve, këto ministri dhe autorët e teksteve, janë ata që vendosin se për çfarë mund të flitet në tekstlibrat e historisë,

²³⁰ J. Havercroft, “*Skinner, Wittgenstein and historical method*”, in *Francophone Communities: Past and Present*, vol. 34, issue 3, editors: Ch. Forsdick, M. Hanrahan & M. Munro, (Edinburgh: Edinburgh University Press, 2011), pp. 371-387.

²³¹ M. Foucault, “*The Order of Discourse*”, in *Untying the Text: A Post-Structuralist Reader*, edit. R. Young, (Boston & London: Routledge & Kegan Paul, 1982), p. 64.

dhe rrjedhimisht, janë ata që vendosin se çfarë mund të dinë nxënësit.

Por ç'kritere duhet ndjekur dhe ç'qëllime duhet pasur për shkrimin e teksteve të historisë? Fakti që kriteret dhe si rrjedhojë e tyre edhe qëllimet e shkruarjes së testlibrave përcaktohen nga ministritë e arsimit, – të cilat duke qenë dikastere të qeverive të tyre që ndërkaq drejtohen nga parti dhe forca politike të caktuara, paraqesin po ashtu institucione politike, në kuptimin institucione të drejtuar politikisht, – paraqet një rrezik potencial për interferimin e politikës në shkrimin e historisë. Teksa shkruan për konceptimin modern të historisë, Hannah Arendt pohon se: “çdo përzgjedhje materiali interferon në njëfarë kuptimi me historinë dhe çdo kriter seleksionues ia nënshtron rrjedhën historike të ngjarjeve kushteve të caktuara, të krijuara prej njeriut.”²³² Por në rastin e Kosovës,²³³ Shqipërisë²³⁴ dhe Maqedonisë, cilave “kushte të caktuara iu nënshtrohet rrjedha historike e ngjarjeve” tek shkrimi i tekstlibrave të historisë? Këtu, përgjigjja për të tria këto vende, është një: kushti të cilit i nënshtrohet rrjedha historike, është kushti i kursit politik shtetëror. E thënë shkoqur, tekstlibrat e historisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, janë shkruar mbi kritere seleksionuese të cilat historinë ia nënshtrojnë interpretimeve të caktuara që janë në një linjë me kurset politike të këtyre shteteve.

²³² H. Arendt, “*The Concept of History: Ancient and Modern*”, in *Between Past and Future*, (New York: Penguin Books, 2006), pp. 41-90.

²³³ Për korrikulat e arsimit në Kosovë shih D. Nehring, *Curricula und Geschichtsbucher im Kosovo*, editors: S. Britz & E. Bećirović, (Braunschweig: Georg Eckert Institute, 2014).

²³⁴ Për korrikulat e arsimit në Shqipëri shih D. Nehring, *Curricula und Geschichtsbucher im Albanien*, editors: S. Britz & E. Bećirović, (Braunschweig: Georg Eckert Institute, 2014).

Në të gjitha këto tekste, atentati i Sarajevës cilësohet vetëm si një pretekst për fillimin e luftës, kurse vetë atentatori Gavrilo Principi, portretizohet me cilësime të ndryshme. Në tekstet e Maqedonisë, ai është thjeshtë “anëtar i organizatës ilegale ‘Bosnja e Re’”.²³⁵ Në tekstet e Shqipërisë, është një “*student sllav, pjesëtar i një shoqate të fshehtë revolucionare*”.²³⁶ Kurse në të gjitha tekstet e Kosovës, Principi përshkruhet si një anëtar i “*organizatës nacionaliste serbe Bosnja e Re*”.²³⁷

Në pasazhet e mësipërme, nuk mund të mos vërehet që epitetet që i janë dhënë Gavrilo Principit, janë në një linjë me kurset politike të vendeve përkatëse, përkatësisht, janë në përputhje me të qenit politikisht korrekt, sipas politikave të vendit ku janë shkruar këto tekste. Atentatori Gavrilo Principi ishte serb, dhe duke pasur parasysh marrëdhëniet e mira politike mes Republikës së Maqedonisë dhe Serbisë, duket e kuptueshme që ai neutralizohet duke u cilësuar thjeshtë si anëtar i një organizate ilegale. Kështu, në një farë mënyre, Principi amnistohet nga kriminaliteti i tij, kriminalitet që ndërkaq i lihet vetëm organizatës së atentatorit, dhe për më tepër duke përdorur një term shumë të gjerë siç është ai “*illegal*”, me të cilën kuptohet çdo gjë që nuk është nën jurisdiksionin e shtetit, e që mund të jetë shumçka: nga një klub sporti a lokal afarist, e deri te organizatat terroriste. Në mënyrë disi të çuditshme, Principi emërtohet në tekstet e

²³⁵ B. Ritovski, *Historia për klasën VIII*, op.cit., p. 7.

²³⁶ M. Dërguti, *Historia 8*, op.cit., p. 14.

²³⁷ J. Bajraktari, F. Rexhepi & F. Demaj, *Historia 10: Gjimnazi matematikë dhe informatikë – Gjimnazi i Shkencave Natyrore*, (Prishtinë: Libri Shkollor, 2010), p. 89; F. Rexhepi & F. Demaj, *Historia 11: Gjimnazi i gjuhëve*, (Prishtinë: Libri Shkollor, 2004), p. 82; J. Bajraktari, A. Salihu, *Historia 12: Gjimnazi i Përgjithshëm*, (Prishtinë: Libri Shkollor, 2006), p. 172.

Shqipërisë si një “student sllav, pjesëtar i një shoqate të fshehtë revolucionare”! Mbase duke u nisur nga fakti që në organizatën “Bosnja e Re” kishte edhe sllavë të tjerë përveç serbëve, si boshnjakë e kroatë, këtu Principi tregohet si një student jo serb por sllav, ndërkaq organizata nacionaliste “Bosnja e Re”, kategorizohet thjeshtë si një shoqatë e fshehtë revolucionare. Në anën tjetër në Kosovë, – vendi i fundit që u nda me luftë nga Jugosllavia, – Gavrilo Principi është portretizuar unanimisht dhe prerazi, – madje duke përdorur në të gjitha tekstet të njëjtën fjali, – si një anëtar i “*organizatës nacionaliste serbe Bosnja e Re*”. Është me rëndësi të thuhet që në asnjë tekst të këtyre vendeve, nuk shpjegohet natyra dhe qëllimet politike të organizatës “Bosnja e Re”. Ndërsa, nëse e zhvendosim atentatin e Sarajevës në domenin e terminologjisë së sotme moderne, Gavrilo Principi do të kategorizohej lehtësisht si një terrorist nacionalist.²³⁸

Nga mospërputhjet faktografike mes këtyre teksteve, – ndonëse përgjithësisht janë të pakta – është edhe data e fillimit të luftës. Ndryshe nga shumica e teksteve që si datë për fillimin e luftës e marrin 28 korrikun,²³⁹ kur Austro–Hungaria i shpalli luftë Serbisë, teksti i klasës së 12-të në Shqipëri, e merr 4 gushtin,²⁴⁰ datën kur Britania i shpalli luftë Gjermanisë, si datë

²³⁸ Për portretizimet e ndryshme të G. Principit në tekstlibrat e ish-vendeve të Jugosllavisë shih D. Dzidic, M. Ristic, etc., “*Historia për Luftën e Parë Botërore shkaktonte ndasi në mesin e fëmijëve shkollore të Ballkanit*”, (BIRN: 2014).

²³⁹ L. Ajrullai & R. Petro edit., *Atlas themelor i historisë së botës*, (Tiranë: Botimet shkollore Albës, 2005), p. 84; I. Hoti, T. Trerska & I. Memeti, *Atlas i historisë (për shkollë)*, (Tiranë: Botimet shkollore Albës, 2008), p. 41.

²⁴⁰ M. Dërguti, L. Dushku, F. Duka & S. Boçi, *Historia e shqiptarëve –12*, (Tiranë: Botime shkollore Albës, 2012), p. 87.

të fillimit të Luftës së Parë Botërore. Përtej kronologjisë së zhvillimeve historike në prag të luftës, nëse iu referohemi përmbledhjeve bibliografike të librave dhe studimeve për Luftën e Parë Botërore, shohim që pothuajse unanimisht, si datë e fillimit të luftës mirret 28 korriku i vitit 1914.²⁴¹

Si njëra nga ngjarjet më të mëdha dhe më gjithëpërfshirëse politiko–ushtarake në historinë e njerëzimit, Lufta e Parë Botërore duket ta ketë të pamundur të shpëtojë interpretimeve politike në histori. Nxënësit në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, pothuajse në mënyrë uniforme dhe sipas të njëjtave argumente, mësojnë se Lufta e Parë Botërore ishte një luftë globalisht ekspansioniste mes të dyja blloqeve, të cilat synonin të rindanin kolonitë, tregjet dhe zonat e influencës në botë mes tyre. Në këtë mes, çdo lëvizje dhe aktivitet politiko–ushtarak i popullsive të këtyre tri vendeve, paraqitet si përpjekje e popujve të vegjël për të shpëtuar nga hegjemonia e popujve të mëdhenj. Kështu, në librin e klasës së 8–të që përdoret në Maqedoni, shprehimisht thuhet se “*shtetet ballkanike morën pjesë në Luftën e Parë Botërore me qëllim që t’i realizojnë aspiratat e tyre territoriale për formimin e shteteve të mëdha në Ballkan si “Greqia e Madhe”, “Rumania e Madhe”, “Bullgaria e Madhe” dhe “Serbia e Madhe”.*”²⁴² Ky pasazh është tipik për mendësinë e viktimizimit, për një mit aq të përhapur te popujt e Ballkanit siç është miti i të qenit i pafajshëm dhe viktimë gjatë historisë. Në rastin e Maqedonisë, rrëfimi për planet nacionaliste të Greqisë, Bullgarisë dhe Serbisë së Madhe, është fare i qëllimshëm kur kihet parasysh që këto plane përfshinin në vete synime territorial ndaj asaj që sot është

²⁴¹ A. G. S. Enser, *A Subject Bibliography of The First World War: Books English 1914-1987*, (London: Gower Publishing Group, 1989).

²⁴² B. Ritovski, *Historia për klasën VIII*, op.cit., p. 11.

Republika e Maqedonisë. Madje, në tekstin e sipërpërmendur, ka një njësi mësimore të veçantë për të shpjeguar gjithë këtë, e cila është titulluar: “*Shtetet dhe popujt e Ballkanit në Luftën e Parë Botërore*”.

Përgjithësisht duke lexuar tekstlibrat e historisë së këtyre tri republikave ballkanike, të krijohet përshtypja sikur ato janë produkte të të njëjtit kantier të historisë. E kjo vlen sidomos për optikën etnocentriste dhe nacionaliste me të cilën kanë operuar autorët e këtyre teksteve. Kjo optikë, shquhet nga një mori parametrash tejhistorikë, të cilët janë të ngarkuar me premisa ideo-politike dhe socio-identitare që gravitojnë drejt një etnocentrizmi nationalist, e që kulmon në tekstet e Maqedonisë, ku paradoksalisht, historia e Luftës së Parë Botërore rrëfëhet në shkakësi nga brenda—jashtë, pra nga shteti komb, drejt zhvillimeve ndërkombëtare të shteteve të tjera. Një tjetër rezultat i kësaj optike, është edhe fakti që në tekstet e Kosovës²⁴³ dhe të Shqipërisë,²⁴⁴ historia nuk është e kufizuar brenda territoreve të këtyre dy republikave, por ajo përfshinë historinë e tërë kombit shqiptar²⁴⁵ gjatë Luftës së Parë Botërore. Tutje, duke përdorur terma të llojit shovinizëm, ekspansio-

²⁴³ Për Kosovën gjatë L.P.B. shih N. Malcolm, *Kosovo: A Short History*, (USA: Harper Perennial, 1999), pp. 239-263; po ashtu shih L. Rushiti, *Rrethanat politiko-shoqërore në Kosovë 1912-1918*, (Prishtinë: Rilindja, 1986), pp. 81-202.

²⁴⁴ Për Shqipërinë gjatë L.P.B. shih M. Çami, “*Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914-1918)*”, in *Historia e Popullit Shqiptar*, vol. III, edit: Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Instituti i Historisë, (Tiranë: Toena, 2002), pp. 74-99; po ashtu shih N. Guy, *Lindja e Shqipërisë*, (Tiranë: PEGI, 2012), pp. 122-183.

²⁴⁵ O. Jazexhi, *Rrëfimet e një kombi: Shqiptarët, turqit, muslimanët dhe të krishterët në tekstlibrat shkollorë të historisë dhe letërsisë në Kosovë – Analizë e teksteve shkollorë të ciklit fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë në Kosovë*, (Tiranë: Free Media Institute, 2013), p. 54.

nizëm, nacionalizëm i skajshëm, terrorizëm e lëvizje për çlirim, autorët e këtyre teksteve me shumë finesë, viktimizojnë popullin e tyre në njërën anë, ndërkaq akuzojnë dhe kritikojnë përherë pretendimet territoriale të popujve dhe shteteve fqinjë në anën tjetër. Pushtimet që shtetet e mëdha europiane kanë bërë në Ballkan, rrëfehen disi më shkarazi dhe pothuajse si diçka e natyrshme e gati emancipuese, në krahasim me pushtimet që shtetet ballkanike i kanë bërë njëra tjetrës, të cilat ndërkaq stigmatizohen dhe penalizohen në mënyrë kategorike si shoviniste dhe ekspansioniste.

Përfundimisht, përtej çdo kritike që mund tu bëhet tekstlibrave të historisë në Kosovë, Shqipëri dhe Maqedoni, problemi kyq në tërë këtë konstalacion të historishkruarjes, është ky: ç'histori duhet (duam?) tu mësojmë fëmijëve? Historinë si një rrëfim kronologjik që shpalos faktografinë e të kaluarës një-rëzore, apo historinë si një mësim moral(izues?) mbi humanen dhe vlerat e rrugës së emancipimit të saj? E para rrezikon të përfundojë në një kaos informativ, kurse e dyta, me varfërimin e përvojës që ka sjellur moderniteti, do të rezultonte me shumë gjasë si krejt e panjaftueshme. Këtu ka zënë fill mega-dilema që ka ndarë në dysh mendimet për atë që Nietzsche e ka quajtur “mbi dobinë dhe dëmin e historisë për jetën”: a duam të mësojmë historinë, apo duam të mësojmë nga historia? Për Edward Hallett Carr-in: “Mësimi nga historia s’është kurrë thjeshtë një rrjedhë e njëanshme. Të mësosh për të tanishmen në dritën e së kaluarës – sipas tij, – do të thotë gjithashtu të mësosh për të kaluarën në dritën e së tashmes. Puna e historisë – për të, – është të rrisë kuptimin më të thelluar të së kaluarës dhe të së tashmes përmes marrëdhënieve midis tyre.”²⁴⁶ Ndërsa për vetë

²⁴⁶ E. H. Carr, *What is History?*, (New York: Random House, 1967), p. 89.

Nietzsche—n, si një nga artikuluesit e kësaj dileme, ka tri lloj historish: lloji monumental – si një dëshmi për triumfet e të shkuarës si frymëzuese për të tashmen dhe të ardhmen; lloji antikuar – si risjellje vizuale e të kaluarës, në shërbim të kureshtjes muzeale; dhe lloji kritik – si kundërvënje ndaj ceneve të së kaluarës, me qëllimin për t’u liruar nga barra e së kaluarës.²⁴⁷ Nga këto tri lloje, ai tregon përbuzje për të dytën, në ndërkohë që përlartëson të parën dhe të tretën, në një mënyrë që sugjeron se një histori e dobishme për njeriun, do të ishte e përshkuar nga një qasje kritike ndaj të kaluarës, prej së cilës do të nxitej dhe gjallërohej veprimtaria e njeriut. Por një implementim eventual i këtyre ideve të tilla tek tekstet shkollore, duket paksa utopik dhe si shumë ideal për të qenë gjerësisht i pranueshëm, aq më tepër kur bëhet fjalë për Kosovën, Shqipërinë dhe Maqedoninë, vende kaq të varfëra dhe të ngelura mbrapa në rrugët e emancipimit shoqëror e politik të tyre.

Në fund fare, pothuajse të gjithë këmbëngulin në atë se zgjidhja më e mirë, do të ishte të mësonim historinë ashtu siç ka qenë ajo në të vërtetë. Por teksa shkruan për historishkruarjen, me një sens disi fatalist, Karl Popper pohon se “nuk mund të ekzistojë asnjë histori e të kaluarës, siç ka qenë ajo faktikisht”; se mund të ekzistojnë vetëm interpretime historike por jo përfundimtare, dhe se çdo brez ka të drejtën që të bëjë interpretimet e veta për historinë.²⁴⁸ Por një histori që interpretohet në vazhdimësi sipas opinionëve që bartin brezat me vete, do të ishte një shpërfytyrim arbitrar i historisë nga

²⁴⁷ F. Nietzsche, *On the Use and Abuse of History for Life*, trans. I. Johnston, (Virginia: Richer Resources Publications, 2010), pp. 13-21.

²⁴⁸ K. R. Popper, “Për shkrimin e historisë dhe për sensin e historisë”, in *Mendime për historinë dhe politikën*, trans. G. Karakashi, (Tiranë: Plejad, 2011), p. 68.

rrjedha e të tashmeve të pafundme. Mbase, ajo për çfarë kemi vërtetë nevojë në përpjekjet tona aq të amullta për të njohur historinë dhe për tu njohur nga historia, është të shkruarit e historisë si një vendstrehim autentik që zbulon dhe shpalos të vërtetat, dhe si një pistë e lëvizshme tejkohore dhe tejhapësinore, që së bashku me mundësitë dhe zgjedhjet e bëra në të kaluarën, do të shpërfaqte edhe mundësitë e përcjellura në të sotshmen.²⁴⁹

Bibliografi

- Ajrullai, Latif. & Rita Petro. *Atlas themelor i historisë së botës*. Tiranë: Botimet shkollore Albas, 2005.
- Arendt, Hannah. *Between Past and Future*. New York: Penguin Books, 2006.
- Bajraktari, Jusuf. & Arbër Salihu. *Historia 12: Gjinnazi i përgjithshëm*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006.
- Bajraktari, Jusuf. & Fehmi Rexhepi. & Frashër Demaj. *Historia 10: Gjinnazi matematikë dhe informatikë; Gjinnazi i shkencave natyrore*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2010.
- Benjamin, Walter. *Selected Writings, vol. IV, 1938–1940*. Translated by H. Eiland & M. Jennings. Cambridge: Bknap Press, 2003.
- Bicaj, Isa. & Isuf Ahmeti. *Historia 12: Gjinnazi shoqëror*. Prishtinë: Libri Shkollor, 2006.
- Carr, Edward Hallet. *What is History?* New York: Random House, 1967.
- Cohen, Gerald Allan. *Karl Marx's Theory of History: A Defence*. New York: Oxford University Press, 2004.
- Çami, Muin. “Shqipëria gjatë Luftës së Parë Botërore (1914–1918)”, in *Historia e Popullit Shqiptar, vol. III*. Editor: Akademia e Shkencave e Shqipërisë: Instituti i Historisë. tiranë: Toena, 2002.

²⁴⁹ Për këtë shih M. Heidegger, *Being and Time*, trans. J. Macquarrie & E. Robinson, (New York: Harper Perennial, 2008), pp. 378-381.

- Deacon, Roger. “*Michel Foucault on education: a preliminary theoretical overview*”, in South Africa Journal Education, no. 26 (2). Johannesburg: Education Association of South Africa, 2006.
- Dërguti, Menduh & Tomi Treska. *Historia 8*. Tiranë: Botime shkollore Albas, 2009.
- Dërguti, Menduh. Sonila Boçi & Ledia Dushku. *Historia 9*. Tiranë: Botime shkollore Albas, 2010.
- Dërguti, Menduh. Ferit Duka. Leida Dushku & Sonila Boçi. *Historia e shqiptarëve 12*. Tiranë: Botime shkollore Albas, 2012.
- Dugolli, Bujar & Durim Abdullahu. “*Çështje kundërthënëse dhe të ndjeshme në tekstet e historisë për shkollat fillore dhe të mesme në Kosovë*”, in Diskutime, year III, no.9, February–March 2014. Editor: Arsim Sinani. Tetovë: Qendra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike – Akademia Diplomatike Shqiptare Tetovë & Instituti për Studime Evropiane i Universitetit të Tiranës.
- Dzidic, Denis. Marija Ristic. Milka Domanovic. Josip Ivanovic. Edona Peci & Sinisa Jakov Marusic. *Historia për Luftën e Parë Botërore shkakton ndasi në mesin e fëmijëve shkollore të Ballkanit*. Sarajevo, Belgrade, Zagreb, Prishtina, Shkupi: BIRN, 2014.
- Enser, A.G.S. *A Subject Bibliography of The First World War: Books English 1914–1987*. London: Gower Publishing Group, 1989.
- Einland, Howard & Michael W. Jennings. *Walter Benjamin: A Critical Life*, Cambridge: Belknap Press, 2014.
- Foucault, Michel. *Discipline and Punish: The Birth of the Prison*. Translated by Alan Sheridan. New York: Vintage Books, 1995.
- Foucault, Michel. *The Order of Discourse*, in Untying the Text: A Post-Structuralist Reader. Editor: Robert Young. Boston & London: Routledge & Kegan Paul, 1982.
- Guy, Nicola. *Lindja e Shqipërisë: Nacionalizmi Etnik, Fuqitë e Mëdha të Luftës së Parë Botërore dhe Lindja e Pavarësisë Shqiptare*. Translated by Krenar Hajdëri. Tiranë: PEGI, 2012.
- Havercroft, Jonathan. “*Skinner, Wittgenstein and historical method*”, in Francophone Communities: Past and Present, vol. 34,

issue 3, editors: Ch. Forsdick, M. Hanrahan & M. Munro. Edinburgh: Edinburgh University Press, 2011.

– Heidegger, Martin. *Being and Time*. Translated by J. Macquarrie & E. Robinson. New York: Harper Perennial, 2008.

– Hoti, Izber. Tomi Treska & Ilir Mehmeti. *Atlas i Historisë (për shkolla)*. Tiranë: Botime shkollore Albas, 2008.

